

Konsultimi nr.08-2019-SPA/RAC

Vlerësimi i statusit ekologjik dhe vlerësimi fillestar paraprak i PHD-së në zonën e gjirit të Vlorës (Shqipëri), në kuadër të projektit pilot të PHD-së me mbështetjen e Ministrisë Italiane të Mjedisit, Tokës dhe Detit (IMELS) dhe në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit me UNEP/MAP

Draft-raporti i 2-të

Genc Myftiu
consulting on development



Tiranë, dhjetor 2019

Parathënie

Ky raport është përgatitur me qëllim mbështetjen e realizimit të një qasjeje të planifikimit hapësinor detar në zonën e Vlorës dhe hartimin e udhëzimeve për PHD-në në Shqipëri, në kuadër të PMVI-së, Protokollit të ICZM-së dhe Vendimit për PHD-në (Vendimi “Për kuadrin konceptual të PHD-së”).

Vendimet e Palëve Kontraktuese (Vendimi IG.17 / 6 “Për zbatimin e qasjes së bazuar në ekosistem për menaxhimin e veprimtarive njerëzore që mund të ndikojnë në mjedisin detar dhe bregdetar të Mesdheut” dhe Vendimi IG.20 / 4 “Për zbatimin e udhërrëfyesit të qasjes së bazuar në ekosistem”) pasqyrojnë dëshirën për të konsoliduar bashkëpunimin dhe për të kërkuar sinergji me iniciativën DKSD të BE-së, me qëllim arritjen e vizionit të përbashkët “një Mesdhe i shëndetshëm me ekosisteme detare dhe biologjike produktive dhe biologjikisht të shumëllojshme në favor të brezave të sotëm dhe të ardhshëm”.

Gjithashtu, Planifikimi Hapësinor Detar (PHD) bazohet në ndarjen e hapësirës detare me qëllim mundësimin e një zhvillimi të qëndrueshëm, duke përfshirë mbrojtjen e biodiversitetit detar dhe ruajtjen e burimeve detare, si dhe arritjen e objektivave socio-ekonomike, duke lënë pas qasjen e bazuar në një sektor të vetëm e cila fokusohet në një përdorim të caktuar të detit.

Sipas Komisionit Evropian (KE), PHD përmbush katër objektiva:

- Reduktimin e konflikteve për aksesin në hapësirën detare;
- Reduktimin e ndikimeve kumulative të veprimtarive detare në mjedis;
- Reduktimin e kostove të bashkërendimit për autoritetet publike; dhe
- Rritjen e sigurisë dhe parashikueshmërisë për investimet private.

Në Detin Adriatik, zbatimi i qasjes së bazuar në ekosistem dhe rritja e kapacitetit të menaxhimit nënrajonat përmes PHD-së synojnë rikuperimin e ekuilibrit të tij.

Tabela e përmbajtjes

A. Lista e akronimeve	6
B. Lista e tabelave	8
C. Lista e figurave	9
D. Lista e shtojcave	11
E. VEPRIMTARI PARAPRAKE TË ZHVILLUARA ME QËLLIM MBËSHTETJEN E PËRGATITJES SË PLANIT TË PHD-SË NË ZONËN E VLORËS	12
1. Seksioni 1 - Përshkrimi i përgjithshëm i zonës së studimit	16
1.1. Përshkrimi gjeografik	18
1.2. Veprimtaritë njerëzore	24
1.2.1 Veçoritë, infrastrukturat dhe veprimtaritë njerëzore kryesore të regjistruara janë si më poshtë:	24
2. SEKSIONI 2. Legjislacioni, institucionet dhe grupet e interesit	31
2.1. POLITIKA PËRKATËSE E ICZM-SË NË SHQIPËRI	53
2.2. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ICZM-NË	56
3. SEKSIONI 3. Përshkrim i përgjithshëm fizik dhe biologjik i zonës së studimit	59
3.1. KLIMA	59
3.2. MJEDISI BREGDETAR DHE DETAR	59
3.3. HIDROLOGJIA (BREGDETARE)	63
3.4. HIDROLOGJIA (DETARE)	63
3.5. GJEOLGJIA, GJEOMORFOLOGJIA DHE TEKTONIKA	63
3.6. Biologjia detare (fauna dhe flora, llojet bentike dhe pelagjike, vendase dhe ekzotike)	64
3.6.1. KOMUNITETET BENTIKE të sedimenteve të buta	67
3.6.2. KOMUNITETET BENTIKE të mureve shkëmbore nënujore	72
3.7. CILËSIA E UJIT DHE SEDIMENTEVE	76
3.7.1. TREGUESIT E BAKTEREVE FEKALE	76
3.7.2. UJI	79
3.7.3. EUTROFIKIMI	84
3.8. EKOTOKSIKOLOGJIA	88
3.8.1. SEDIMENTE	92
3.8.2. PLANKTONI	93
3.9. CILËSIA E EKOSISTEMIT	95
4. SEKSIONI 4. Zonat e ruajtjes (natyrore dhe kulturore)	97
5. Seksioni 5 - Veprimtaritë njerëzore dhe rreziqet ose ndikimet e lidhura me to	99
5.1. Popullsia dhe tendencat, shifrat dhe problemet kryesore ekonomike	100

5.2. Kriporet	102
5.3. Veprimtaritë e peshkimit	103
5.4. Aktivitetet e akuakulturës	105
5.5. Porti industrial dhe zona e naftës në pjesën veriore të Vlorës	109
5.6. Zhvillimi bregdetar dhe infrastruktura (zonimi aktual dhe planifikimi, bankinat, rrugët, aksesueshmëria, njësitë e shkrupëzimit, pompimit dhe shkarkimit, e të tjera)	110
5.7. Zhvillimi i turizmit, (ekzistuesi dhe në planifikim, strategjia,...)	114
5.8. Ndotja bregdetare	115
5.9. Trafiku detar	118
5.9.1. Informacione të përgjithshme mbi navigimin në Gjirin e Vlorës	118
5.10. Instalimet dhe veprimtaritë ushtarake	126
5.11. Veprimtari të tjera detare	126
5.12. Veprimtari të tjera, si nxjerrja e rërës (bregdeti dhe deti), mbushja e detit, hedhjet e mbeturinave në det, prodhimi i energjisë, mullinjte e erës, tubacionet dhe kabllot, etj.)	127
6. Seksioni 6 – Shënime paraprake mbi ndryshimet, ndikimet dhe rreziqet	128
7. Seksioni 7 - STATUSI i EO të Konventës së Barcelonës	132
7.1. Habitati detar EO1	132
7.1.1. KOMUNITETET BENTIKE të sedimenteve të buta	134
7.1.2. KOMUNITETET BENTIKE të mureve shkëmbore nënujore	136
7.2. EO2 speciet jo vendase (speciet e huaja)	138
7.3. EO3 peshkimi	139
7.4. EO5 eutrofikimi	141
7.5. EO7 Hidrografia	142
7.6. EO9 Ndotësit	143
7.7. EO10 - mbetjet detare	145
8. Propozimi për një draft mbi planifikimin Hapësinor detar për Gjirin e Vlorës, Shqipëri	145
9. SHTOJCA (në dosjen e shtojcave)	150



Figura 45:PHD e gjirit të Vlorës 8.3. Propozimi për një Komitet për zbatimin e PHD-së në Shqipëri 149

A. Lista e akronimeve

AFDW	Pesha në të Thatë dhe pa Përmbajtje Karboni
CBD	Konventa për Diversitetin Biologjik
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
EcAp	Qasja e bazuar në ekosistem
KE	Komisioni Evropian
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
EO	Objektivat Ekologjike
FGM	Fondi Global i Mjedisit
SIG	Sistemi i Informacionit Gjeografik
MIZB	Menaxhimi i Integruar i Zonave Bregdetare
PMVI	Programi i Monitorimit dhe Vlerësimit të Integruar
IMELS	Ministria Italiane e Mjedisit, Tokës dhe Detit
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
IMAP	Programi i Monitorimit dhe Vlerësimit të Integruar
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
ZMD	Zonë e Mbrojtur Detare
DKSD	Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare
PHD	Planifikimi Hapësinor Detar
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020
PSSA-të	Zonat Detare me Ndjeshmëri të Lartë
AdZM-të	Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZVM/DB	Protokolli për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura dhe Diversiteti Biologjik
SPAMI	Zonat Veçanërisht të Mbrojtura me Rëndësi për Mesdheun



Mediterranean Action Plan
Barcelona Convention



The Mediterranean
Biodiversity
Centre



MINISTERO DELL'AMBIENTE
E DELLA TUTELA DEL TERRITORIO E DEL MARE



SPA/RAC

Qendra Rajonale e Veprimtarive për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura

PSZMDB

Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare

UNDP

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNEP/MAP

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin / Plani i Veprimit për Mesdheun

B. Lista e tabelave

Tabela 1 – Veçoritë kryesore, veprimtaritë dhe rreziqet në zonën e Vlorës

Tabela 2: Angazhimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtare.

Tabela 3: Angazhimi i Shqipërisë në instrumentet rajonale dhe evropiane.

Tabela 4: Angazhimi i Shqipërisë në Konventën e Barcelonës.

Tabela 5: Legjislacioni “Për miratimin e zonave të mbrojtura në Vlorë sipas kategorive të IUCN-së”.

Tabela 6: Llojet e habitateve detare të identifikuar në ZMD-në Karaburun-Sazan (Burimi: Plani i menaxhimit për Parkun Kombëtar Karaburun-Sazan, dhjetor 2014, UNDP/WWF).

Tabela 7: Zona e ekosistemeve sipërfaqësore (Burimi: UNDP, datë).

Tabela 8: Të dhënat statistikore të parametrave fiziko-kimike dhe lëndëve ushqyese.

Në tabelat 9 (1, 2 dhe 3) paraqiten rezultatet e analizës së merkurit, plumbit dhe kadmiumit në organizmat që janë përdorur si bioindikatorë të ndotjes nga metalet e rënda, gjatë periudhës 1990-1993 dhe 2002-2007.

Tabela 10: Vlerësimi i ndikimeve të veprimtarive të akuakulturës në mjedis (Burimi: Randone M., 2016).

Tabela 11: Petrolifera Italo Albanese Sh.A. (PIA).

Tabela 12. Trafiku i trageteve në portin e Vlorës për periudhën 2014-2019.

Tabela 13: Trafiku i anijeve cisternë të naftës në portin e Vlorës-1, për periudhën 2014-2019.

Tabela 14: Trafiku i anijeve dhe jahteve turistike në gjirin e Vlorës për periudhën 2017-2019.

Tabela 15: Trafiku i anijeve të peshkimit për periudhën 2014-2018.

Tabela 16: përmbledhja e trafikut në Gjirin e Vlorës në muaj për vitet 2014-2018.

Tabela 17: Veprimtaritë që lidhen me mjedisin detar dhe rreziqet përkatëse për mjedisin detar dhe bregdetar.

Tabela 18: Llojet e habitateve detare të identifikuar në PKD-në Karaburun-Sazan.

C. Lista e figurave

Figura 1: Harta e zonës së Vlorës duke përfshirë njësitë administrative.

Figura 2: Parku Kombëtar dhe Zona e Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan.

Figura 3: Harta morfo-batimetrike e gjirit të Vlorës me rrënoja anijesh (të diktuar në zonën e studimit (yjet e zeza). Intervali i linjave të kontureve batometrike është 50 m, harta u vizatua në UTM34, zona veriore.

Figura 4: Fotografi të marra nga të dhënat e hidrolokatorëve anësorë, ku tregohen të gjitha rrënojat e anijeve në zonën e studimit. Vendndodhjet paraqiten në figurën 1). A: Anija-spital “Po” (e mbytur gjatë Luftës së Dytë Botërore). B: Rrënoja të një anijeje të pidentifikuar. C: Kryqëzori i rëndë “Regina Margherita” (Lufta e Dytë Botërore). C: Rrënoja të një anijeje të pidentifikuar (nëndetëse). D: Rrënoja të një anijeje të pidentifikuar në pjesën perëndimore të gjirit të Vlorës.

Figura 5. Harta e komuniteteve bentike në gjirin e Vlorës (Maiorano et al., 2011).

Figura 6: Stacionet e kampionimit të bentosit gjatë punëve të mëparshme shkencore në gjirin e Vlorës (Maiorano et al., 2011).

Figurat 7-17: Shembuj të komuniteteve bentike të mureve shkëmbore nënujore të Karaburun-Sazanit, brenda dhe jashtë gjirit (fotot nga Dr. S. Modugno, Misioni i UNDP, mars 2019).

Figura 18-21: Livadhe Posidonia të dëmtuara në gjirin e Vlorës, pranë zonave të akuakulturës (fotot nga Dr. S. Modugno, Misioni i UNDP-së, mars 2019).

Figura 22: Dinamikat e bakteve koliforme totale në vitet 2015 dhe 2016 (A. Bakai et al, 2017).

Figura 23: Dinamikat e parametrave të cilësisë së ujit (koliformet dhe temperatura e ujit) gjatë periudhës mars – shtator 2015 (A. Bakai et al., 2017).

Figura 24: Dinamikat e parametrave të cilësisë së ujit (koliformet dhe temperatura e ujit) gjatë periudhës mars – shtator 2016 (A. Bakai et al., 2017).

Figura 25: Përqindja e stacioneve të kampionimit ku streptococci fekal ishte i pranishëm në vitet 2015 dhe 2016. (A. Bakai et al., 2017).

Figura 26: Hartat e stacioneve të kampionimit në gjirin e Vlorës (S. Kane et al., 2016).

Figura 27: a) pH, b) temperatura, c) oksigjeni i tretur, d) përmbajtja e kërkesës biologjike për oksigjen në ujërat e portit tregtar dhe të peshkimit dhe të zonave të tjera në gjirin e Vlorës.

Figura 28: a) përcjellshmëria, b) kripësia, c) TSS, c) përmbajtja e TDS-së në ujërat e portit tregtar dhe të peshkimit dhe të zonave të tjera në gjirin e Vlorës.

Figura 29: Përmbajtja e lëndëve ushqyese në portin tregtar dhe të peshkimit dhe në zonat e tjera të gjirit të Vlorës.

Figura 30: Stacionet e kampionimit, stacione biologjike ku janë kryer kampionime gjatë CISM1 (pranverë 2007) dhe CISM2 (dimër 2008); ciklet, stacionet biologjike ku janë kryer kampionime gjatë CISM_1 (pranverë 2007); profilet pesëkëndësh dhe CTD.

Figura 31: profilet vertikale të temperaturës (a, c) dhe kripësisë (b, d) përkatësisht në pranverë dhe në dimër.

Figura 32: Shpërndarja hapësinore e klorofilit a (mg m²³) në sipërfaqe dhe në shtresën e poshtme, në pranverë (a, b) dhe në dimër (c, d) (O. Mangoni et al, 2011).

Figura 33: Shpërndarja hapësinore e prodhimtarisë parësore mesatare të integruar (mg C m²³ d²¹), (a) në pranverë dhe (b) në dimër (O. Mangoni et al, 2011).

Figura 34: Harta e stacionit të kampionimit të sedimenteve (I. sino et al, 2011-2013, tezë doktorature).

Figura 35: Shpërndarja e stacioneve të kampionimit (treguar me numra nga 1 deri në 7) në zonën e studiuar (Moscatello dhe Belmonte, 2006).

Figura 36: Harta e Zonës së Ruajtjes së Gjirit në Vlorë.

Figura 37: Vendndodhja e propozuar për ankorimin e bovave në gjirin e Vlorës.

Figura 38: Paraqitje grafike e prodhimit të krapit dhe levrekut evropian, përkatësisht në Sarandë dhe Himarë, nga viti 2015 deri në vitin 2017 (në të majtë) dhe paraqitje grafike e prodhimit të përgjithshëm të këtyre dy llojeve nga viti 2015 deri në vitin 2017 (në të djathtë).

Figura 39: Paraqitje grafike e prodhimit të kocit dhe levrekut evropian, përkatësisht në gjirin e Vlorës, nga viti 2014 deri në vitin 2017 (në të majtë) dhe paraqitje grafike e prodhimit të përgjithshëm të këtyre dy specieveve nga viti 2014 deri në vitin 2017 (në të djathtë).

Figura 40: Harta e zonave bregdetare (Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar, 2030).

Figura 41: Harta hidrografike e turizmit të biznesit.

Figura 42: Vendbanimet, infrastrukturat, veçoritë historike dhe kulturore në zonën e Vlorës.

Figura 43: Trafiku detar në gjirin e Vlorës në vitin 2019.

Figura 44: Impianti i Trajtimit të Ujërave të Përdorura në Vlorë.

Figura 45 : PHD e gjirit të Vlorës

D. Lista e shtojcave

SHTOJCAT (në dosjen e shtojcave)

Shtojca 1 Programi i zbatimit të projektit

.....

Shtojca 2 Seminari prezantues i datës 27 nëntor

.....

Shtojca 3 Hartat

.....

Shtojca 4 Formati “shapefile”

.....

Shtojca 5 Referenca

.....

Shtojca 6 Tabela e listës taksonomike të llojeve bentike në gjirin e Vlorës

E. VEPRIMTARI PARAPRAKE TË ZHVILLUARA ME QËLLIM MBËSHTETJEN E PËRGATITJES SË PLANIT TË PHD-SË NË ZONËN E VLORËS

Takimi *prezantues me AKZM-në u zhvillua më 6 nëntor 2019 në praninë e* Anis Zarrouk, Drejtues i Projekteve SPA/RAC GEF Adriatik dhe Zënive Aksidentale, Zamir Dedej, Drejtor i AKZM-së dhe Nexhip Hysolakaj, Kryetar i ZMD-së Karaburun-Sazan. Fokusi i takimit ishte (i) informimi i MTM-së rreth objektivave të studimit dhe PHD-së si dhe (ii) garantimi i bashkëpunimit të të gjithë aktorëve kombëtarë dhe vendorë në mbështetje të veprimtarive të projektit

Më 20 nëntor u hartua *një pyetësor (shihni shtojcën 1) në lidhje me të dhënat dhe informacionet kryesore për zbatimin e PHD-së në gjirin e Vlorës, i cili iu shpërnda të gjitha grupeve të brendshme dhe kombëtare të interesit (shihni listën e grupeve të interesit në shtojcën 2);*

Me anë të një shënimi hyrës shpjegohej se si pjesëmarrësit mund të kontribuojnë në mënyrë konkrete në procesin në zhvillim të zbatimit të PHD-së në gjirin e Vlorës. Pyetëtori synon zhvillimin e një sistemi qeverisjeje ndërsektoriale dhe shumë-nivelëshe, bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse dhe në menaxhimin e integruar të burimeve natyrore, parandalimin e rreziqeve dhe zgjidhjen e konflikteve midis përdorimeve dhe përdoruesve të zonës detare të Vlorës. Rezultatet e pyetësorit do të përdoren për të kontribuar në analizën e problemeve kryesore që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e PHD-së, si dhe në zhvillimin e një metodologjie të përbashkët për realizimin e saj në zonën e synuar.

Seminari prezantues i datës 27 nëntor ishte një mundësi e mirë për të prezantuar objektivat e projektit dhe për shënuar komentet e pjesëmarrësve, megjithëse një sërë aktorësh kombëtarë mungonin për shkak të tërmetit të datës 26 nëntor. Rezultati kryesor i seminarit ishte konsensusi mes të gjithë pjesëmarrësve (duke përfshirë OJQ-të aktive vendase dhe stafin e universitetit) mbi nevojën për PHD në Vlorë, në përputhje me parimet e SPA/RAC.

Një tjetër hap i rëndësishëm që filloi nga dita e parë e projektit ishte hedhja e të dhënave në harta dhe formate “shapefile”. Shtojca 3 përfshin hartat dhe shtojca 4 përfshin formatet “shapefile”, si dhe listat përkatëse të hartave dhe këtyre formateve.

I gjithë ekipi (ekspertët ndërkombëtarë dhe vendas) ishte i pranishëm në Shqipëri nga data 24 deri më 28 nëntor, për seminarin e Vlorës të datës 27 nëntor, dhe patën mundësinë të diskutonin një paketë të plotë të dhënash të grumbulluara si dhe të hartonin përmbajtjen e të dy raporteve: ***Detyra 2: Raporti i studimit dhe detyra 3: Raporti i udhëzimeve të PHD-së***

Informacionet dhe pikëpamjet e mbledhura gjatë takimit prezantues të 6 nëntorit, seminarit të 27 nëntorit dhe vizitave në terren mbështetën specifikimet dhe fokusin e planit të punës.

Në vijim paraqitet drafti i parë i **“Raportit të vlerësimit fillestar paraprak të PHD-së në zonën e Vlorës në Shqipëri”**

Takime të mëtejshme u zhvilluan ndërmjet të gjithë ekspertëve të projektit për të qartësuar çështjet e dakordësimit në lidhje me këtë detyrë shumë-disiplinore. Të gjithë ekspertëve iu kërkua të mbledhin të dhëna, studime dhe harta si dhe të diskutojnë në lidhje me to. Në përfundim, u miratua një qasje e përbashkët si dhe rolet përkatëse të secilit ekspert qoftë në lidhje me mbledhjen e të dhënave apo edhe me kontaktimin e grupeve të interesit. Duke qenë se projekti është

shumëdisiplinor (duhet të mblidhen dhe të përfshihen të dhëna të marra nga disa nivele), ekipi **organizoi disa vizita në terren në qarkun e Vlorës**, menjëherë pas takimit fillestar, për të takuar të gjitha grupet përkatëse të interesit me qëllim shqyrtimin e të dhënave/hartave në dispozicion dhe të ndikimeve të fundit në zonën e projektit nga zhvillimet në gjirin e Vlorës. Ishte e rëndësishme të vazhdoheshin diskutimet shkencore me grupet lokale të interesit, si autoritetet vendore të planifikimit, agjencitë rajonale të zhvillimit, përdoruesit e burimeve, CBO-të/OJQ-të aktive në këtë fushë.

Informacioni dhe pikëpamjet e mbledhura gjatë takimit prezantues dhe vizitës së parë në terren mbështetën specifikimet dhe fokusin e planit të punës, në përputhje me termat e referencës dhe tri detyrat kryesore të caktuara, të cilat kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe kryesisht zhvillohen njëkohësisht:

Detyra 1: Mbledhja dhe hartëzimi i të dhënave

Konsulenti grumbulloi dhe analizoi të gjitha studimet e disponueshme, të publikuara ose jo, si dhe projektet lidhur me biodiversitetin detar dhe bregdetar, habitatet detare dhe bregdetare, peshkimin, akuakulturën, hidrografinë, ndotësit e mëparshëm dhe aktualë, mbetjet detare, veprimtaritë detare aktuale dhe të ardhshme, trafikun detar aktual dhe të ardhshëm, duke përfshirë portet. Më pas, u vazhdua më tej me programin e detajuar të specifikuar në termat e referencës, në seksionin 5.2, paragrafi A,B,C,D, nga faqja 11 deri në 16. Shumica e dokumenteve ekzistuese u arrit të gjendej, duke përfshirë edhe ato të publikuarat, të cilat u aksesuan nëpërmjet kontakteve të ekspertëve.

Të dhënat e mbledhura ndihmuan në përgatitjen e hartave dhe formateve “shapefile”. Nivelet e pikave të ankorimit, qyteti/fshati, infrastruktura detare, batimetria (linja dhe shumëkëndësh), hidrografia dhe rrjeti rrugor u përcaktuan dhe u dixhitalizuan duke përdorur harta topografike në shkallë 1:25000.

Shtresat lidhur me turizmin e biznesit, itineraret e anijeve, kampingjet, zhytjet, platformat e naftës, varkat e ekskursioneve dhe trafikun detar, u përcaktuan në bashkëpunim me ekspertët e ekipit të projektit.

Identifikimi i akuakulturës u krye duke përdorur imazhet e “Google Earth”. Skedarët Kml që dixhitalizohen nga “Google Earth” u konvertuan në shumëkëndësh në format “shapefile”.

Harta e zonave për zhvillimin e turizmit (raster) të siguruara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit u plotësua me të dhëna gjeo-referimi dhe zona me prioritet për zhvillimin e turizmit u dixhitalizua si shumëkëndësh në format “shapefile”.

Projekti CISM (projekti i asistencës teknike për ngritjen dhe menaxhimin e një qendre ndërkombëtare për shkencat detare në Shqipëri) ka shërbyer si burim informacioni për të gjetur një hartë raster të biocenozës. Harta u plotësua me të dhëna gjeo-referimi dhe habitatet detare u dixhitalizuan për zonën e gjirit të Vlorës.

“Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare” u përdor si burim informacioni për përcaktimin dhe dixhitalizimin e informacionit në lidhje me zonat e peshkimit dhe zonat ku ndalohet peshkimi, shfrytëzimi i tabanit, përdorimi i dragave hidraulike, përdorimi i veglave me tërheqje apo shfrytëzimi i livadheve Posidonia.

“Shapefile” me pika i trashëgimisë kulturore dhe monumenteve natyrore u gjenerua duke përdorur harta të ndryshme (raster) të siguruara nga ekspertët e ekipit.

Të gjitha shtresat u projektuan në sistemin referencë “WGS 1984UTM Zone 34N”.

Softueri i përdorur për të gjeneruar formatet “shapefile” dhe për integrimin në sistemin GIS është ArcGIS 10.1.

Detyra 2: Raporti i studimit

Kjo veprimtari konsistonte në analizën e të dhënave së bashku me vazhdimin e mbledhjes së tyre dhe përgatitjes së hartave. Draft-raporti i studimit me titull “Vlerësimi fillestar paraprak i PHD-së në zonën e Vlorës në Shqipëri” është hartuar sipas “listës së blerjeve” në faqen 16 të TR-ve dhe është dorëzuar tek SPA/ RAC. Shumica e punës është fokusuar në analizën e të dhënave dhe integrimin e tyre në hartat e SIG. Pas komenteve që do të mblidhen në takimin vlerësues, Konsulenti do të nisë rishikimin e draft-raportit të 2-të të studimit për të përgatitur raportin final të studimit me titull “Vlerësimi fillestar paraprak i PHD-së në gjirin e Vlorës në Shqipëri” brenda 10 ditëve nga takimi vlerësues

Detyra 3: Raporti i udhëzimeve të PHD-së

Versioni paraprak i “Raportit të udhëzimeve të PHD-së për Vlorën” është hartuar dhe dorëzuar gjithashtu së bashku me raportin e studimit “Vlerësimi fillestar i PHD-së për zonën e Vlorës në Shqipëri”, duke qenë se kanë lidhje me njëra-tjetrën, pra “Raporti i udhëzimeve të PHD-së” mbështetet nga “Raporti i studimit”. Siç tregohet në TR, udhëzimet e raportit të PHD-së për gjirin e Vlorës përfshijnë sa më poshtë:

- Të dhënat e mbledhura në bazat e të dhënave, hartat e shtresave dhe analizat përkatëse.
- Një listë të institucioneve të ndryshme kombëtare dhe grupeve të interesit të përfshira në ruajtjen dhe menaxhimin detar dhe bregdetar, përfshirjen e mundshme të tyre në procesin e PHD-së dhe, kur është e mundur dhe janë identifikuar, nevojat për përmirësimin e kapacitetit të tyre për planifikimin dhe menaxhimin e hapësirës detare.
- Identifikimin e nevojave dhe mënyrave të përmirësimit të kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional për ruajtjen e mjedisit detar dhe planifikimin hapësinor detar. Çështje kritike mund të jenë ato në lidhje me zbatimin e ligjit.
- Propozimin e udhëzimeve të PHD-së për zonën e Vlorës me qëllim plotësimin e mangësive, korrigjimin e gabimeve të bëra deri në atë moment dhe përgatitjen për një PHD të qëndrueshme për Vlorën me një plan veprimi, ndërhyrje dhe kosto përkatëse të specifikuara qartë.

Drafti i dytë dhe ai përfundimtar i “Raportit të udhëzimeve të PHD-së” do të hartohen në të njëjtën ditë si drafti i parë, i dytë dhe përfundimtar i raportit të studimit “Vlerësimi fillestar paraprak i PHD-së për zonën e Vlorës në Shqipëri”. Komentet e mbledhura nga klienti dhe grupet e interesit, si dhe të dhënat e reja do të konsolidojnë hartat e shtresave tematike, do të përgatisin versionin përfundimtar të raportit të udhëzimeve të PHD-së. Një pjesë e kësaj detyre është edhe procesi i konsultimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me të gjitha grupet përkatëse të interesit (si MTM, Ministria e Infrastrukturës, AKM, Instituti Shqiptari i Transportit si dhe portet kryesore etj.) për sa i përket (i) informacioneve shtesë dhe (ii) mbledhjes së komenteve dhe ideve për PHD-në në Vlorë.

Kjo është arsyeja se pse Konsulenti ka organizuar tashmë ***disa konsultime të përbashkëta për të gjitha veprimtaritë dhe produktet e projektit*** si më poshtë:

Takime të vazhdueshme me grupet përkatëse të interesit

Konsulenti është në dijeni se Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit është grupi kryesor i interesit për miratimin e produkteve, por lista e grupeve të interesit do të ndryshojë në varësi të ministrive të tjera dhe qeverisjes vendore duke u fokusuar te aktorët kombëtare dhe lokalë të qarkut të Vlorës. Për këtë arsye, ekspertët vendas kanë organizuar vizita të shpeshta me qëllim saktësimin dhe vërtetimin e të dhënave si dhe shkëmbimin e komenteve dhe ideve.

Takimet me përdoruesit vendas (peshkatarë etj.) gjatë mbledhjes së të dhënave

Konsulenti zhvilloi takime me “përdorues” të detit dhe bregdetit, si peshkatarët dhe personeli i autoriteteve portuale, për të kuptuar më mirë zhvillimet aktuale dhe të ardhshme në zonën e projektit për sa i përket burimeve ekzistuese dhe potenciale të ndotjes dhe sasisë së tyre. Gjithashtu, ndërmarrjet e trajtimit të ujërave përfshirë atyre të përdorura organizuan një takim për të diskutuar qëndrimin e tyre në lidhje me shkarkimin e ujërave të përdorura dhe hedhjen e mbetjeve të ngurta në det, gjë që mund të rezultojë në pasoja në mjedisin detar

Konsultimi me personelin e SPA/RAC lidhur me studimet e mëparshme dhe hartat e SIG

Konsulenti vendosi një marrëdhënie konstante me stafin e SPA/RAC me qëllim mbledhjen e të gjitha raporteve të mëparshme dhe hartave të SIG që do të shërbejnë si bazë për studimin si edhe për mbajtjen e komunikimit gjatë veprimtarive të projektit. Në rastin e problemeve që lidheshin me mbledhjen e të dhënave ose identifikimin e çështjeve madhore me rëndësi për objektivat e studimit, u konsultua edhe SPA/RAC.

“SEMINARI I RAJONIT TË ADRIATIKUT PËR PSSA-të” i SPA/RAC i zhvilluar në Tiranë më 10-13 dhjetor, ishte një mundësi shumë e mirë për intensifikimin e këtij komunikimi dhe për diskutimin e çështjeve të planifikimit hapësinor detar me rëndësi të madhe për këtë studim. Vlen për t’u theksuar kryerja e aplikimit për PSSA-në e ZMD-së së Vlorës, mbështetur nga veprimtaritë e seminareve me pjesëmarrjen e personelit të AKZM-së dhe të Konsulentit.

Konsultimi me kuadrin ligjor përkatës të grupeve të interesit

Konsulenti kreu një rishikim të kuadrit ligjor dhe do të organizojë një takim me grupet lokale të interesit për të shqyrtuar statusin e zbatimit të ligjit lidhur me të gjitha çështjet që do të jenë objekti dhe fokusi i studimit në lidhje me mbrojtjen e habitateve dhe reduktimin e shkarkimit të ndotësve.

Takimi vlerësues për draft-raportin e studimit të 2-të

Nuk është organizuar ende

1. Seksioni 1 - Përshkrimi i përgjithshëm i zonës së studimit

- Qarku i Vlorës është një nga 12 qarqet e Shqipërisë dhe është i ndarë në shtatë bashki (Vlorë, Delvinë, Finiq, Himarë, Konispol, Sarandë dhe Selenicë). Bashkitë ndahen më tej në njësi administrative dhe fshatra, me një sipërfaqe totale prej 2706 km². Qarku i Vlorës është qarku i 7-të më i madh në Shqipëri. Deri në janar 2019 totali i popullsisë së saj ishte 189 311 banorë, me një rritje shumë të lehtë krahasuar me vitin e mëparshëm. Në nivel qarku, Institucioni i Prefektit është autoriteti qendror dhe Institucioni i Këshillit të Qarkut është autoriteti rajonal. Bashkia është niveli i parë i qeverisjes vendore, ndërsa qarku është niveli i dytë. Ekzistojnë disa çështje të rëndësishme që duhen marrë në konsideratë gjatë analizimit të grupeve të interesit të cilat kanë veprimtari dhe interesa në lidhje me hapësirën detare në gjirin e Vlorës.
- Lëvizja e popullsisë (emigrimi dhe migrimi i brendshëm) është një fenomen shumëdimensional. Ajo manifestohet me braktisjen e zonave për shkak të emigrimit jashtë vendit (zona e Orikut), zaptimin e tokave, përhapjen e çorganizuar dhe ndërtimin abuziv për shkak të migrimit të brendshëm dhe mungesës së kontrollit (komuna e Noveselës); rritjen e ndotjes dhe mbetjeve njerëzore, etj.
- Bashkia e Vlorës ka një vijë bregdetare që shtrihet si përgjatë Detit Adriatik ashtu dhe përgjatë Detit Jon. Vlora renditet qyteti i tretë dhe porti i dytë në Shqipëri për nga madhësia. Në tabelën më poshtë jepet një përshkrim sipas nënsektorëve të zonës së studimit të Vlorës.




Figura 1: Harta e zonës së Vlorës duke përfshirë njësitë administrative.

1.1. Përshkrimi gjeografik

Gjiri i Vlorës gjendet në qarkun e Vlorës (Shqipëri) dhe ka një gjatësi të vijës bregdetare rreth 36 km. Bregu lindor i gadishullit të Karaburunit nis nga Pasha Limani deri në kepin e Gallovecit që kalon në kepin e Kallogerit, Rraguzës, Sevasinit, Shën Vasilit, Gjatës, Dim Kushtës dhe Shën Janit.

Veçoritë kryesore fizike të gjirit të Vlorës, nga qyteti i Vlorës (në lindje) deri në kepin e Gallovecit (në perëndim), mund të ndahen në tre kategori:

- ana lindore e gjirit, me orientim V-L, me një gjatësi të vijës bregdetare prej 14 km dhe një rrugë bregdetare që ndan detin nga një mal me lartësi në rritje nga veriu (736 m në një distancë prej 2,5 km nga bregu) në jug (1136 m në një distancë prej 5 km);
- seksioni jugor, me një gjatësi prej 6 km dhe orientim PJP-LVL, ka një rrugë bregdetare që ndan detin nga laguna e Orikumit. Gjiri jugor quhet gjiri i Dukatit;
- ana perëndimore e gjirit, me orientim PJP-LVL, përbën gjithashtu anën lindore të gadishullit të Karaburunit që është relativisht më e ulët se ajo perëndimore dhe ka një bregdet me shtrirje më të madhe e me plazhe me zall: një në kepin e Kallogerit, katër në gjirin e Rraguzës, tre midis kepit të Rraguzës dhe Sevasinit, dy midis kepit të Sevasinit dhe të Shën Vasilit, një përpara kepit të Gjatës, një pas kepit të Dim Kushtës dhe një më i madh me ndërtesa ushtarake dhe një bankinë pas kepit të Shën Janit. Në këtë plazh me zall mund të shihet ndikimi i gropave të mëdha të minuara. Nga gjiri i Veriut deri në kepin e Gjuhëzës, bregu përbëhet nga shkëmbinj të ulët me shkurre të vogla të formësuara nga era. Ai ka një shtrirje prej 6 km. Një shteg bregdetar siguron akses në ekstremin verior ku ndodhet një bazë ushtarake. Shpatet janë më pak të pjerrët sesa në pjesën lindore të gadishullit, duke u rritur drejt veriut deri në 733 m (maja e Hilqes) dhe drejt jugut deri në 826 m (mali i Koretës);

Modeli gjeologjik, në anën lindore të gjirit është vazhdim i formacioneve të periudhave të ndryshme, nga epoka Jurasike tek ajo e Neogjenit (Akuitaniane, Helvetiane, Tortoniane dhe e Pliocenit). Pjesa jugore përbëhet kryesisht nga formacione të Pliocenit dhe sedimente të reja. Bregu lindor është formuar gjatë epokës së Kretakut të sipërm, e cila në thelb përbëhet nga gurë gëlqerorë.

Toka në pjesën lindore të Karaburunit ka një numër më të madh zonash të shpyllëzuara nga zjarret përgjatë një peizazhi shkurnajash, me disa pisha dhe qiparisë të formësuar nga era. Ajo ka një natyrë më pak të egër se sa pjesa perëndimore e Karaburunit, por megjithatë bimësia arrin shumë pranë nivelit të detit. Disa kanione të vogla të lumenjve të tharë arrijnë deri në det pothuajse vertikalisht.

Laguna e Orikumit ndodhet pranë një zone të kufizuar ushtarake. Ajo ka një sipërfaqe prej gati 130 ha, një thellësi maksimale prej 3 m dhe komunikon gjithmonë me detin nëpërmjet një kanali me gjatësi 50 m. Në pjesën jugore të lagunës, uji i freskët është i kufizuar. Sipas analizave, laguna nuk rezulton të jetë e ndotur nga nitratat dhe pesticidet.

Kufijtë jugorë dhe jugperëndimorë të lagunës përbëhen nga grumbuj shkurnajash të llojit: *Pistacia loansiscus*, *Myrtus communis*, *Phyllirea* sp., ndërsa ata J-JL nga grumbuj të llojit *Pragmitetum communis*, *Salicornietum fruticosae*, *S. radicans*, *Juncetum maritime*, *J. acuti*, *Limonietum* sp. Popullatat e fitoplanktonit në lagunë janë të mëdha dhe të ngjashme me ato të Butrintit, dhe përbëhen kryesisht nga alga njëqelizore si *Cheatoceros* sp., *Cyclotellasp.* dhe *peridinales*

Prorocentrum sp. etj. Popullatat e zoobentosit përbëhen nga gaforret *Carcinus aestuari* dhe molusqet *Cerithium vulgatum*, *Murex trunculus*, *Muricopsis inermis*, *Bulla striata*, *Venerupis pullastra*, *Cardium edule*, etj. Në këtë lagunë, peshkimi nuk bën pjesë në veprimtaritë kryesore. Kryesisht ngjalat *Anguilla anguilla*, *Venerupis pullastra* dhe *Sparus auratus* peshkohen në një sasi prej 15 kv/vit.

Gjiri i Vlorës është një zonë ujore pothuajse e mbyllur që grumbullon ndotësit me origjinë nga deti i hapur. Erërat e moderuara nga perëndimi dhe veri-perëndimi çojnë faktorët e ndotjes në fund të gjirit që shërben si vend hedhjeje mbeturinash. Përveç kësaj, gjiret e vogla përgjatë vijës bregdetare shërbejnë si grumbullues ndotjeje për arsyet e sipërpërmendura. Për këtë arsye, ngritja e një rrjeti vëzhgimi dhe monitorimi është shumë e dobishme për parandalimin e ndotjes, veçanërisht të depërtimit të rrjedhjeve të naftës brenda gjirit. Thellësia në gji arrin deri në 54 metra në juglindje të gjirit të Raguzës. Vija izobatike prej 50 m arrin deri në 0,5 kablllo gjatësi afër kepit të Kalasë dhe nis të drejtohet për nga deti duke arritur deri në 6,5 kablllo gjatësi në molin e portit të Vlorës. Që prej Luftës së Dytë Botërore e në vazhdim, janë gjetur rreth 7 rrënoja anijesh të cilat përbëjnë site historike me biodiversitet. Ato janë: “Rosandra 3”, “Regina Margherita”, “Intrepido”, “Rovigno”, “Lucian”, “Stampella”, “Andromeda”, “Po”. Këto relikte historike janë objekt i grabitjeve të vazhdueshme nga gjuetarët e metaleve dhe thesareve, të cilët shkaktojnë ndotje gjatë veprimtarisë së tyre. Është e rëndësishme të theksohet se këto trashëgimi kulturore dhe turistike duhet të ruhen dhe/ose të mbrohen për të lejuar një përdorim më të ndërgjegjshëm të vlerave të tyre turistike dhe historike.

Mjedisi detar i gjirit të Vlorës zbulon një vijë bregdetare që është kryesisht shkëmbore dhe me shtresa të vogla zalli, me përjashtim të pjesës jugore e cila është ranore dhe qendrës së gjirit që është e mbushur me rërë dhe baltë. Thellësia maksimale në pjesën qendrore të gjirit arrin deri në 55 m. Kjo nënshtresë përbëhet nga një popullatë e konsiderueshme algash dhe fanerogamesh (kryesisht *Posidonia oceanica*, *Zostera* sp. and *Cymodocea nodosa*). Livadhet e mëdha me *Posidonia* sp., zona ideale për foletë dhe streha të shkëlqyera, si dhe ato me *Cymodocea* sp. Gjenden në zonat më të cekëta të pjesës lindore të Karaburunit. Si *Posidonia* ashtu dhe *Cymodocea* sp. në Detin Mesdhe mbrohen me ligj që prej vitit 1988.

ZMD-ja e parë në Shqipëri u shpall më 28 prill 2010. Gadishulli i Karaburunit, i cili rrethon zonën detare dhe bregdetare të ishullit të Sazanit, i shpallur Park Kombëtar Detar, mbulon një sipërfaqe prej 12,750 ha.

Gadishulli i Karaburunit shtrihet përgjatë pjesës perëndimore të gjirit të Vlorës. Ai ka një sipërfaqe prej 62 km² dhe ndan bregdetin shqiptar të Detit Adriatik nga ai i Deti Jon. Një kanal i ngushtë detar, i quajtur Mezokanali (kanal i mesëm), ndan Karaburunin nga ishulli i Sazanit. Ishulli i Sazanit është 4,8 km i gjatë, 2 km i gjerë dhe ka një sipërfaqe prej 5,7 km².

Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur tiparet e përgjithshme të këtyre zonave kryesore gjeografike dhe veçoritë e tyre për sa i përket përbërjes së habitateve tokësore dhe detare. Përshkrimi përfshin edhe një prezantim të habitateve tokësore për një njohje më të thelluar të zonave përreth, ku mund të kryhen edhe veprimtari zhytjeje, si dhe për të siguruar një pasqyrë të përgjithshme të infrastrukturës përfshirë atë të aksesueshmërisë.



Figura 2: Parku Kombëtar dhe Zona e Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan.

Zona e Rrëzës së Kanali përfshin një vijë bregdetare prej rreth 30 km dhe shtrihet nga gjiri i Bristanit deri në plazhin e Dhërmiut. Ajo bën pjesë në rrethin e Vlorës. Përveçse nga deti, hyrja e vetme për në bregdet është nga veriu (nëpërmjet bazës ushtarake të Pasha Limanit në gjirin e Bristanit) dhe nga jugu (nëpërmjet Dhërmiut). Peizazhi është mbresëlënës, me shkëmbinj gëlqerorë që arrijnë brenda në ujë. Në pjesën e pasme gjendet një vargmal shumë pranë bregdetit që përbëhet nga maja e Flamurit (826 m lartësi, 1,4 km nga bregu), e Sinan Dukës (817 m, 1,5 km), e Kollovockës (1227 m, 4 km), e Shëndëlliut (1499 m, 3.5 km) dhe ajo e Çikës (2043 m, 5 km) pranë Palasës. Nga mali i Çikës, masive të mëdhenj gurësh të rrëzuar, që formojnë një formacion të brendshëm në formë delte, shtrihen nëpër disa lugina të cilat përmythen vetëm gjatë reshjeve me shumë intensitet. Shumë kanione (të thatë) arrijnë deri në det. Ndonjëherë, shpati është i thiktë dhe vazhdon deri në thellësi mjaft të mëdha. Gjatë lundrimeve me varkë mund të shihet një numër i madh shpellash që përshkohen nga ujëra të ëmbla. Përgjithësisht, në fund të kanioneve ka gjire të vogla me plazhe të vogla ranore dhe me zall. Plazhi i parë i vogël në veri të Dhërmiut gjendet në gjirin e Valamirit, dhe në të ndodhet një ndërtesë të vjetër për përpunimin e taninës së drurit të lisit. Plazhet më të mëdha janë ato të Gramës dhe të Llovizit.

Kjo pjesë e bregut përbëhet kryesisht nga gurë gëlqerorë të Kretakut të sipërm dhe, në disa vende, të Eocenit të sipërm (mergel, konglomerate) si dhe të Oligocenit (gurë gëlqerore biogjenikë). Parku Kombëtar piktoresk i Llogarasë në malin e Çikës është i mbuluar me pyje pishash dhe ofron peizazhin detar më të virgjër të Adriatikut. Bimësia përgjatë bregdetit nuk është shumë e dendur (zona është kryesisht e shpyllëzuar) dhe është përgjithësisht e ulët, me përjashtim të disa zonave, si pjesa fundore e lumenjve sezonalë ose rreth burimeve ku mund të ketë shkurre (me lisa dhe qiparisë). Duket se kjo zonë është djegur disa herë. Bregu karakterizohet nga kanione gjarpëruese, shpesh me dalje në shpella dhe përgjithësisht me burime ujërash të ëmbla nëntokësore apo që derdhen në pellgje të vogla. Më tutje në drejtim të jugut shpatet përgjatë bregut janë më pak të thepisura dhe të mbuluara nga lisa. Në një gjiri të vogël gjenden rrënojat e një banese të lashtë, ku mund të shihen mbetje të lendeve të lisit të përdorura për taninat apo si ushqim për derrat.

Kanionet, shpesh gjarpëruese, kanë dalje në shpella të cilat përshkohen përgjithësisht nga burime ujërash të ëmbla që kalojnë nën ujë apo që derdhen në pellgje të vogla. Në një nga shpellat gjendet një afresk i gdhendur që daton në periudhën e hershme kristiane, në të cilin portretizohet një vajzë e re e mbërthyer nga Dionisi. Një tjetër shpellë në formë kubeje quhet Shpella e Pëllumbave. Ajo ka marrë këtë emër pasi shërben si strehë për zogjtë e egër. Disa gjire të vogla kanë plazhe ranore. Më i veçanti prej tyre është gjiri i Gramës. Pjesa e poshtme e shkëmbinjve jugorë të këtij gjiri të veçantë mbulohet nga dorëshkrime (ex voto), disa prej të cilave datojnë në periudhën e skllavërisë gjatë epokës helenike. Në të njëjtën zonë, pas shkëmbinjve bregdetarë gjendet edhe një gurorë antike.

Kanionet dhe shpellat, të cilat janë shpesh të paaksesueshme, përbëjnë një habitat ideal për fokat mesdhetare, të cilat janë raportuar në zonë në vitin 1982. Në këto habitate të veçanta gjejmë edhe faunë të ujërave të ëmbla (peshq të ujërave të njelmët, karkaleca, bilbila uji, pilivesa, flutura, mushkonja, lakuriqë nate). Në shpellat përgjatë kanioneve ka burime të shumta ujërash të ëmbla. Shkëmbinjte e lartë vertikale mendohet të jenë një habitat i përkryer për zogjtë pelagjikë.

Mjedisi nënujor i bregdetit të gjatë ranor në veri të Dhërmiut karakterizohet nga një taban me rërë të bardhë me *Posidonia* sp. dhe *Cymodocea* sp. si dhe një thellësi mesatare prej 10-20 m. Në drejtim të veriut, në shkëmbinjte e fortë e të thepisur gjenden kryesisht alga *Cystoseira*, ndërsa në muret e kanioneve më të izoluar ka një florë dhe faunë shumë të ngjashme me ato në perëndim të Karaburunit me alga *Cystoseira* sp. dhe formacione koralore, shpesh me gjerësi mbi një metër, të përbëra prej algash koralore të purpurta (lloji më interesant i algave të purpurta të korëzuara *Lithophilium tortuosum*) që shërbejnë si ushqim për *Patella* sp. . Në zonat e errëta, muret shkëmbore mbulohen nga një numër i madh sfungjerësh të kuq e portokalli të korëzuar, si *Crambia* sp.. Brezi infralitoral përbëhet kryesisht nga *Cystoseira* sp. Dhe *Padina* sp., *Acetabularia* sp., *Wrangelia* sp., nga anemone të gjelbra dhe korale *Balanophyllia europaea* që në zonat e rrahura shërbejnë si ushqim

për iriqët e detit (të cilët gërmojnë në shkëmbinj të e butë) dhe në zonat më të qeta e të thella për peshqit *Sarpa salpa*, *Peyssonnelia* sp., *Halimeda* sp. dhe *Udotea* sp. Thellësia rritet shumë shpejt dhe *Posidonia* sp. dhe *Cymodocea* sp. fillojnë të rriten në zonat e mbrojtura me thellësi 10-20 m. Tabani i detit dëshmon përgjithësisht veprimin gërryes të valëve në kanione (shenja gërryerje dhe gradient në madhësinë e zallit në fund të shkëmbinjve). Peshqit që gjenden në këto kanione janë *Mullus surmuletus*, *Diplodus* sp. *Corisjuli*, *Serranus cabrilla*, *Anthias anthias*.

Për rrjedhojë, mjedisi bregdetar dhe fauna nënujore janë tepër të shumëllojshme dhe relativisht të pasura, veçanërisht përgjatë zonës së Kanalit, e cila është një zonë e mirë për peshkim me shtizë, linja grepush dhe trata fundore në thellësi më të mëdha. Peshkimi me trata për zënien e *Merluccius merluccius*, *Trachurus trachurus*, *Parapenaeus longirostris*, *Mullus surmuletus* dhe *Exocoetus volitans* bëhet në thellësi prej rreth 230 m. Ndërsa, për llojet "Dentex sp.", peshqit e familjes Scombridae, kerni dhe karavidhet, peshkimi realizohet kryesisht me linja grepush. Në zonë janë raportuar veprimtari të peshkimit me shtizë dhe peshkimit të paligjshëm me dinamit. Kerni i madh është një lloj tepër i vlerësuar, veçanërisht nga të huajt. Megjithatë, për shkak të kontrollit të pamjaftueshëm të peshkimit gjatë viteve të fundit, këto popullata sa vijnë e reduktohen ashtu si dhe peshqit e tjerë të zonave shkëmbore.

Në afërsi të gjirit të Gramës dhe Palasës janë gjetur rrënoja arkeologjike (amfora dhe spiranca që datojnë në shekullin 2 para Krishtit dhe në periudhën e Mesjetës). Në gjirin e Gramës ka edhe gurore antike. Këto rrënoja historike mund të shërbejnë edhe si atraksion për eksploruesit e botës nënujore.

Gadishulli i Karaburunit, një zgjatim shkëmbor me gjatësi 16 km dhe gjerësi 4 km, është pjesë e rrethit të Vlorës. Brigjet veriore dhe perëndimore kanë një shtrirje prej 14 km dhe kalojnë nga kepi i Gallovecit në atë të Gjuhëzës, duke përfshirë një bazë ushtarake të tjetërsuar, me orientim VVP-JJL nga ky kep në drejtim të gjirit të Bristanit (gjiri i Orsos në hartën ruse 5384), ku ndodhet një ndërtesë ushtarake e braktisur dhe në afërsi të saj një anije tregtare gjysmë e mbytur. Në anën perëndimore të gadishullit shpatet janë shumë të thepisura dhe vijnë duke u rritur, deri në 825 m në drejtim të qendrës (në majën e Flamurit), deri në 733 m në veri (maja e Hilqes) dhe deri në 839 m në jug (maja e Koretës). Bregu perëndimor i Karaburunit, i karakterizuar nga kanione të thella (me rrjedha sezonale) që ndonjëherë përfundojnë në plazhe me zall ose ranore (tri të tilla), karakterizohet nga shkëmbinj të lartë vertikale që arrijnë në thellësi të mëdha nën ujë. Në gjirin e Bristanit ndodhet një ndërtesë e braktisur ushtarake, një bankinë e vogël dhe disa bunkerë në shkëmbinj të tij të thepisur, të cilët ndërpriten nga kanione që kalojnë në brendësi të bregdetit. Në afërsi, ndodhen rrënojat e një anijeje tregtare. Këta shkëmbinj karakterizohen nga gërryerje të mëdha dhe (kryesisht nën ujë) mund të shihet një numër i madh shpellash, aty ku shpesh kalojnë burimet e ujërave të ëmbla. Numri i kanioneve detare është më i vogël se sa në zonën e Kanalit. Pjesa kryesore e gadishullit përbëhet nga gurë gëlqerorë të epokës së Kretakut të sipërm (dolomitikë, me rudiste ose globotrunkana) dhe disa formacione të Eocenit të sipërm (mergel dhe konglomerate) ose Akuitiane (gurë gëlqerorë që bashkohen me konglomeratet dhe tokat argjilore). Toka përbëhet kryesisht nga shkurre dhe lisa, ndërsa mjedisi detar në pjesën perëndimore nga nënshtesa shkëmbore që janë zgjatime të shkëmbinjve të thepisur bregdetarë. Zona supralitorale karakterizohet nga cianobaktere që qëndrojnë në errësirë, në shkëmbinj të thepisur dhe shërbejnë si ushqim për guaskat *Littorina*, ndërsa ajo mediolitorale nga algat gëlqerore të llojit *Lithophilium* sp. (lloji më interesant i algave të purpura me talus *Lithophilium tortuosum*) të cilat formojnë një platformë me gjerësi mbi një metër e që shërbejnë si ushqim për *Patella* sp.. Zona infralitorale përbëhet kryesisht nga *Cystoseira* sp. dhe *Padina* sp. *Acetabillaria* sp. Në zonat e rrahura shërbejnë si ushqim për iriqët e detit dhe në zonat më të qeta e të thella për peshqit *Sarpa salpa*, *Peyssonnelia* sp., *Halimeda* sp. Dhe *Udotea* sp.. Nga zhytjet në fund të zonës perëndimore të Karaburunit, është vënë re se brezat me *Posidonia oceanica* gjenden në zona të mbrojtura me thellësi 15-20 m në formacionet shkëmbore përgjatë shpatit ose në thellësi më të mëdha deri në 30-

40 m. Si *Posidonia* ashtu dhe *Cymodocea* sp. në Detin Mesdhe mbrohen me ligj që prej vitit 1988. Shpellat me thellësi rreth 40 m janë të pasura me alga të purpurta kërcore të llojit *Faucheia* sp. dhe shpesh me sfungjerë me ngjyra të ndezura. Gjithashtu, ka edhe prani të ekinodermëve të përfaqësuar nga holoturianët, iriqët e detit, yjet e detit dhe ofiurianët. Mjedisi bregdetar dhe fauna nënujore janë tepër të shumëllojshme dhe relativisht të pasura, veçanërisht në perëndim të Karaburunit. Peshkimi me trata për zënien e *Merluccius merluccius*, *Trachurus trachurus*, *Parapenaeus longirostris*, *Mullus surmuletus* bëhet në thellësi rreth 230 m. Gjatë misionit tonë janë vënë re veprimtari peshkimi me shishe me shtizë.

Kerni i madh është një lloj tepër i vlerësuar, veçanërisht nga të huajt. Megjithatë, për shkak të kontrollit të pamjaftueshëm të peshkimit gjatë viteve të fundit si rezultat i hapjes për publikun të kësaj zone të kufizuar, këto popullata sa vijnë e reduktohen ashtu si dhe peshqit e tjerë të zonave shkëmbore. Gjatë zhytjes sonë në ekstremin veriperëndimor të Karaburunit pamë llojet e mëposhtme të peshqve (shumica e tyre ishin në sezon çiftimi dhe kishin ngjyra të ndezura): *Diplodus sargus*, *D. Vulgaris*, *D. Annularis*, *Serranus cabrilla*, *Spicara moena*, *Coris* sp., *Thalassoma pavo*, tufa me *Boops boops*, *Anthias anthias* nëpër gropat nënujore, *Phycis phycis*, kern të mëdhenj *Epinephelus* sp. si dhe ngjala të mëdha dyngjyrëshe dhe sulmuese.

Kanionet dhe shpellat, të cilat janë shpesh të paaksesueshme, përbëjnë një habitat ideal për fokat mesdhetare, të cilat janë raportuar në zonë në vitin 1982 dhe më vonë në vitin 2019 (për t'u verifikuar). Disa nga këto shpella janë shpallur monumente (shpella e Haxhi Aliut me lartësi deri në 50 m). Ato kanë stalaktite nëpër muret e tyre dhe janë të populluara nga fauna të ujërave të ëmbla (bilbila uji, mushkonja, lakuriqë nate), p.sh. shpella në gjirin verior. Në shpellat përgjatë kanioneve ka burime të shumta ujërash të ëmbla. Shkëmbinjtë e lartë vertikale përbëjnë habitatin ideal për foletë e zogjve pelagjikë. Rrënojat e anijeve përgjatë bregdetit të Karaburunit shërbejnë gjithashtu si atraksion për eksploruesit e botës nënujore.

Ishulli i Sazanit ndodhet rreth 10 km nga vija bregdetare. Ai është në trajtë elipsi me drejtim VVP-JJL dhe ka një gjatësi prej rreth 4,8 km dhe një gjerësi maksimale prej 2 km. Lartësia arrin deri në 345 m mbi Grykën e Djallit. Ana perëndimore karakterizohet nga shkëmbinj të lartë vertikale me kanione të thella që kanë dalje kryesisht në shpella nënujore, siç vihet re në Karaburun. Kanionet më të rëndësishme janë në ato në kepin e Pëllumbave dhe në Grykën e Ferrit. Në pjesën lindore vija bregdetare është më e ulët, ka orientim JP dhe përbëhet nga shtresa të pjerrëta gurësh gëlqerorë të zhytur në det (të ngjashëm me ato në gjirin e Kakomesë).

Pjesa perëndimore e ishullit përbëhet nga gurë të Kretakut të sipërm (masive gurësh gëlqerorë ose rudiste dhe globotrunkana), ndërsa pjesa lindore përbëhet nga shkëmbinj të Burdigalianit (gurë gëlqerorë litografikë). Mjedisi tokësor i ishullit (sidomos në pjesën perëndimore) është i mbuluar me shkurre dhe bimësi barishtore. Në zonën lindore, ndodhen ende disa pjesë të pyllit të mëparshëm (*Cupressus* sp., lisa). Supozohet se në ishull mund të ketë derra dhe lepuj të egër. Përveç ndërtesave ushtarake, drurëve frutorë (drurët e portokallit *Citrus* sp. dhe kryesisht *Oleus* sp.), bunkerëve në pjesën lindore dhe zonave të pyjëzuara të djegura së fundmi, pjesa më e madhe e ishullit të Sazanit është ruajtur dhe në të mund të gjenden ende grumbuj të bimësisë origjinale shqiptare (shkurre dhe pyje të paprekura mesdhetare) që rritet deri në fund të vijës bregdetare.

Në anën perëndimore gjendet një nënshtresë shkëmbore e cila është zgjatim i ishullit dhe disa breza me *Posidonia oceanica* në zonat e mbrojtura ku thellësia rritet ngadalë, e ngjashme me ato që janë vënë re përgjatë Karaburunit. Në anën lindore mund të shihet një plazh i gjatë me zall në gjirin e Shën Nikollës dhe një më i vogël në gjirin e Japrakut. Më në afërsi të bregut, në zonat më të cekëta, gjenden shtretër me livadhe *Posidonia*. Përgjatë bregdetit, në thellësi 10-15 m, gjenden shumë municione nga Lufta e Dytë Botërore si dhe nga trazirat e vitit 1997. Për shkak të statusit të tij ushtarak, mjedisi bregdetar nënujor i ishullit nuk është eksploruar ende nga zhytësit. Nga zhytjet në kuadër të misionëve të UNDP-së (Shqipëri) në vitet 2018-2019, është vënë re një faunë dhe florë relativisht e shumëllojshme dhe e pasur, kryesisht e ngjashme me atë të Karaburunit.

1.2. Veprimtaritë njerëzore

1.2.1 Veçoritë, infrastrukturat dhe veprimtaritë njerëzore kryesore të regjistruara janë si më poshtë:

- Veprimtari peshkimi me trata në pjesën përballë Vlorës, në fund të Karaburunit, përgjatë ishullit të Sazanit dhe përgjatë bregdetit deri në deltën e lumit të Vjosës. Disa nga speciet e zëna, në një thellësi nga 80 deri në 250 m, janë *Merluccius merluccius*, *Trachurus trachurus*, *Parapenaeus longirostris*. *Mullus surmuletus*.
Këshilli Kombëtar i Ujërave është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore. Ky është një organ ndërmintor që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Kompetencat e tij janë: miraton planet dhe projektet, ndërrajonale dhe kombëtare, në fushën e bujqësisë, urbanistikës, zhvillimit industrial e territorial, kur ato lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e ujërave; merr masat e duhura për zbatimin e çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, konvente për burimet ujore, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë; jep leje dhe autorizime për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm; përpara fillimit të një procedure koncesionare për përdorimin e burimeve ujore, çdo autoritet kontraktues miratohet, në parim, nga Këshilli Kombëtar i Ujërave. Ai miraton në parim kërkesën për dhënie koncesioni për burimet ujore. Pas lidhjes së kontratës koncesionare, pajis koncesionarin me lejen për përdorimin e burimit ujor, të nënshkruar nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Ujit. Kur këto burime ujore kanë rëndësi kombëtare, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave, marrëveshja e koncesionit hyn në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi; pas miratimit të rregullores së Këshillit të Baseneve lumore; duke miratuar rregulloren e Këshillit të Basenit Ujor.

Agjenciae Menaxhimit të Burimeve Ujore është person juridik shtetëror, i organizuar në nivel qendror dhe në nivel baseni ujqor nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujqore. Ajo ka kompetencat vijuese: harton dhe zbaton politika, strategji, plane, programe dhe projekte, që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujqore, ruajtjen sasiorë dhe cilësore, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre; zbaton dispozitat e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare për burimet ujqore dhe ato ndërkufitare, palë e të cilave është edhe Republika e Shqipërisë; ushtron funksionet e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit; i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit dhënien me koncesion të burimeve ujqore; i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit dhënien e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit dhe shkarkimeve, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm; harton inventarin kombëtar të burimeve ujqore, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor; harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujqore; harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit për ujërat ndërkufitare; është përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike të burimeve ujqore; nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujqore; nxit studime e kërkime për zhvillimin e të rejave teknike që lidhen me përdorimin, zbulimin, shfrytëzimin, ruajtjen, trajtimin, mbrojtjen, administrimin dhe përdorimin efikas të burimeve ujqore; në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore, përcakton fushat e kërkimit dhe të studimit për burimet ujqore, si dhe fondet përkatëse për to; bashkërendon dhe kontrollon punën e organeve vendore të menaxhimit të burimeve ujqore; kundërshton në gjykatë vendimet e Këshillit të Basenit Ujqor.

Këshilli i Basenit Ujqor është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujqore në basenin përkatës, në nivel vendor. Ai ka detyrat vijuese: siguron ruajtjen dhe zhvillimin sa më racional të burimeve ujqore brenda kufijve të basenit përkatës ujqor; siguron shpërndarjen e drejtë të burimeve ujqore brenda kufirit të basenit përkatës ujqor, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre; siguron mbrojtjen e burimeve ujqore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë dhe sasinë e tyre; identifikon trupat ujqorë përkatës që kanë nevojë për mbrojtje.

Zyrat e Administrimit të baseneve ujqore është struktura në varësi e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, e cila ngrihet dhe funksionon në çdo basen ujqor. Ato kanë detyrat vijuese: përpilon projektin e planit për burimet ujqore për basenin përkatës dhe e paraqet për miratim në këshillin e basenit ujqor; harton inventarin e burimeve ujqore në sasi dhe cilësi, si dhe bën periodikisht përditësimin e tij; nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujqore; përgatit raporte, jep opinione për burimet ujqore dhe i paraqet ato për ndjekje të mëtejshme në këshillin e basenit ujqor; përgatit materialet për mbledhjet e këshillit të basenit ujqor; përgatit materialet për mbledhjet e këshillit të basenit ujqor. Ai ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe këshillit të basenit ujqor.

Ujërat sipërfaqësore klasifikohen sipas statusit të tyre kimik dhe ekologjik. Ujërat nëntokësore klasifikohen sipas statusit sasior dhe kimik. Ky klasifikim, për çdo basen ujqor miratohet me VKM dhe pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Ujërave.

Zonat e mbrojtura, në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, përcaktohen me qëllim mbrojtjen e ujërave dhe ekosistemeve ujqore dhe përfshijnë masa të veçanta mbrojtëse. Zonat e mbrojtura përfshijnë: zonat higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujqore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm; zonat e mbrojtura, të përcaktuara sipas ligjit “Për zonat e mbrojtura” zonat për peshkim dhe rritjen e butakëve, sipas legjislacionit për peshkimin; zonat për banjat termale, për trajtimin kurativ dhe rekreacion; zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat në rrezik nga nitratet e nitritet; zonat e synuara për mbrojtjen e bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve, ku ruajtja apo

përmirësimi i statusit të ujit është një element i rëndësishëm i mbrojtjes së tyre. Disa basene ose rrjedha ujore lumore përcaktohen si “zona të veçanta ruajtjeje”.

Zonat e mbrojtura sipas këtij ligji përcaktohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me MTM-në. Shpallja e këtyre zonave bëhet me VKM. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Zyrat e Administrimit të Basenit Ujor, Këshillat e Basenit Ujor dhe hartojnë, menaxhojnë dhe përditësojnë inventarin e zonave të mbrojtura, si pjesë përbërëse e planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura. Plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur përfshihet në planin e menaxhimit të basenit ujor përkatës.

Burimet ujore përdoren për: qëllime shtëpiake, komunale, bujqësore, përfshijnë ujitjen dhe ujin për blegtorinë; akuakulturë, transport ujor, industrial, prodhim hidroenergjik; tregti; turizëm, argëtim, përfshirë lundrimin për argëtim; qëllime të tjera, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujërave.

Të gjitha veprimtaritë, që kryhen profesionalisht në basenet ujorë ose kërkojnë përdorimin e ujit, janë objekt i lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve.

Autoritetet, që hartojnë planet dhe studimet e rregullimit të territorit, marrin në konsideratë planet e menaxhimit të burimeve ujore.

Ligji nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det dhe në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit dhe të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.

Mjedisi detar i Republikës së Shqipërisë është prone shtetërore e patjetërsueshme. Ai përdoret dhe shfrytëzohet për veprimtari ekonomike, tregtare, shkencore, shoqërore, sportive, turistike e ushtarake. Përdorimi dhe shfrytëzimi i tij bëhen nga organet shtetërore, nga personat juridike e fizike, vendas ose të huaj, vetëm në kushtet e parashikuara me ligj. Kontrolli i mjedisit detar dhe i veprimtarive që zhvillohen në të ushtrohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Mjedisit, nga kapitaneritë e porteve, nga organet shtetërore që kanë licencuar veprimtaritë, si dhe nga organe të tjera të përcaktuara me ligj. Për kryerjen e detyrave të tij, Inspektorati bashkërendon punën me kapitaneritë e porteve, me Inspektoratin e Peshkimit, me Policinë e Shtetit, si dhe me Rojat Bregdetare të Republikës

së Shqipërisë. Në mjedisin detar ndalohej të kryhen veprimtaritë vijuese: hedhja e lëndëve dhe e mbetjeve të rrezikshme helmuese e plasëse; hedhja e substancave dhe e lëndëve të përcaktuara në Aneksin I, që i bashkëlidhet këtij ligji; derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura; hedhja e lëndëve dhe e materialeve të ngurta, të çfarëdo natyre dhe lloji, me përjashtim të mjeteve e pajisjeve të peshkimit dhe të lëndëve e mjeteve të nevojshme për ndërtimin e porteve; hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lënde nga anijet, platformat, instalimet dhe nga bregdeti; transportimi i lëndëve dhe i mbetjeve të rrezikshme; fundosja e anijeve, e ngarkesave dhe e mallrave të çdo lloji e tipi; fundosja dhe braktisja e çdo lloj instalimi, që ka shërbyer për veprimtari të ndryshme; ndërtimi dhe vënia në funksionim e pajisjeve që lëshojnë rrezatim jonizues; djegia e lëndëve dhe e materialeve të çdo lloji; hyrja në porte me ballaste të papastra e mjeteve detare të çfarëdo lloji, tipi e tonazhi;

VKM nr. 797, datë 29.9.2010 “Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 2006/7/KE “Për ujërat e larjes”. Rregullorja zbatohet për ujërat e larjes, d.m.th., çdo element i ujit sipërfaqësor ku autoriteti kompetent pret të ketë një numër të madh njerëzish për t’u larë dhe ku nuk ka vendosur ndalim të përhershëm për t’u larë apo rekomandim të përhershëm për të mos u larë.

Inspektorati Sanitar Shtetëror kryen inspektim vizual (dy herë në muaj) të ujërave të larjes për të dalluar ndotje, përfshirë plastikë, gomë e mbetje të tjera dhe ndërmarrin masat e duhura për të eliminuar shkaqet e ndotjes dhe për të përmirësuar cilësinë e ujërave të larjes.

Më poshtë jepen kompetencat e institucioneve të ndryshme:

Ministria e Shëndetësisë - funksioni i drejtimit, promovimit, këshillimit dhe koordinimit të veprimtarive lidhur me zbatimin e rregullores për cilësinë e ujërave të larjes; përditësimi dhe integrimi i standardeve teknike, në bazë të arritjeve të reja shkencore dhe teknike ose për të përmirësuar cilësinë e ujërave të larjes; përpunimi i të dhënave të monitorimit;

Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe pushteti vendor: identifikimi i ujërave të larjes dhe pikave të monitorimit. Ujërat e larjes të identifikuar regjistrohen në regjistra të veçantë; përditësimi i profilit të ujërave të larjes; rrethimi, para fillimit të sezonit të larjes, i ujërave që nuk janë të destinuara për larje dhe ujërat e larjes të ndaluara përgjithmonë për larje; informimi i publikut.

Inspektorati Shtetëror Sanitar: përcaktimi dhe përditësimi i profilit të ujërave të larjes; përcaktimi i një kalendari monitorimi përpara fillimit të çdo sezoni të larjes; monitorimi; klasifikimi i ujërave të larjes;

Pushteti vendor: e drejta për të zgjatur ose shkurtuar sezonin e larjes, sipas nevojave apo rregullave lokale; vendosja në zonat e interesuara, në një vend të dukshëm, sa më në afërsi të secilit ujë të larjes, të shenjave që tregojnë ndalimin e larjes; sinjalizimi në një vend të dukshëm, sa më në afërsi të secilit ujë të larjes, i parashikimeve të ndotjeve me kohëzgjatje të shkurtër.

MTM: marrja e masave për të eliminuar shkaqet e ndotjes dhe për të përmirësuar cilësinë e ujërave të larjes.

Parametrat mikrobiologjikë të monitoruar janë Enterokoki intestinal dhe Escherichia coli. Parametra të tjerë fiziko-kimikë përfshijnë: pH-in; ngjyrën; vajrat minerale mg/litër; lëndët sipërfaqësore aktive që veprojnë me blu metilen mg/l (Lauril sulfat); fenolet mg/l (treguesi i fenolit) C6 H5 OH; transparenca, oksigjeni i tretur (% e ngopjes O₂); mbetjet bituminoze dhe materiale pluskuese, si: dru, artikuj plastikë, shishe, enë qelqi, plastike, gome ose çdo lëndë tjetër; plehurat ose ashklat; amoniakun (mg/litër NH₄); nitrogenin Kjeldahl mg/litër N.

Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i ndryshuar

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të përdorur. Objekt i zbatimit të tij janë:

- ujërat e ndotura urbane;
- ujëra të ndotura industriale;
- ujërat nga kullimi i tokave bujqësore;
- ujërat e ndotura të çdo lloji.

Ministria e Mjedisit, agjencitë rajonale dhe Inspektorati i Mjedisit, krahas organeve të ngarkuara me ligj për administrimin e rezervave ujore, ndihmojnë funksionimin e procesit të trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura dhe kontrollojnë zbatimin e tij në të gjitha nivelet.

Ky ligj përcakton detyrimet për personat fizikë dhe juridikë, që shkarkojnë ujëra të ndotura, si dhe për personat e përfshirë në trajtimin e ujërave të ndotura. Ndalohen veprimtaritë e mëposhtme:

shkarkimi në tokë ose në ujëra sipërfaqësore i ujërave të ndotura përtej limiteve të përcaktuara në lejen mjedisore;

trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura jashtë vendeve të papërcaktuara për këtë qëllim;

trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura nga personat fizikë e juridikë, të palicensuar për këto veprimtari;

trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura me teknika dhe teknologji të papërshtatshme dhe të pamiratuara me një akt normativ;

përzjerja me ujëra sipërfaqësore i shkarkimeve e lëngëta të landfillleve të mbetjeve të ngurta, si dhe të dampave;

përdorimi i ujërave të ndotura për çfarëdolloj qëllimi ose veprimtarie.

Direktiva për trajtimin e ujërave të ndotura urbane ende nuk është transpozuar në legjislacionin shqiptar, por janë miratuar aktet e mëposhtme:

VKM nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”

VKM nr. 246, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 2008/105/KE “Për standardet e cilësisë mjedisor në fushën e politikave ujore”.

VKM nr. 267, datë 7.5.2014 “Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 2013/39/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 12 gusht 2013, duke ndryshuar Direktivën 2000/60/KE dhe 2008/105/KE në lidhje me substancat prioritare në fushën e politikave të ujërave.

VKM nr. 480, datë 25.7.2012 “Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave “Për reagimin ndaj ndotjeve detare në Republikën e Shqipërisë”

Ngarkohen Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e tjera shtetërore, si dhe organet që kanë interesat e tyre në det për zbatimin e këtij plani kombëtar.

Në vitin 2009, qeveria shqiptare ngriti një **Qendër Ndërinstitucionale Operacionale Detare**, për t'iu përgjigjur rekomandimit të Organizatës Ndërkombëtare Detare (brenda kuadrit të UNCLOS). Ky institucion ndërmintor duhet të garantojë mbikëqyrjen e hapësirës detare shqiptare, për të kryer organizimin, planifikimin, koordinimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

QNOD-ja është një institucion kombëtar që garanton sovranitetin dhe të drejtat sovrane të shtetit shqiptar në hapësirën detare nëpërmjet menaxhimit të integruar të burimeve kombëtare të institucioneve përgjegjëse dhe që kanë interes në det.

QNOD-ja koordinon dhe udhëheq (ndër të tjera):

- Operacione Kostuale për kontrollin e kufirit detar;
- Operacionet kundër ndotjes;
- Operacionet për zbatimin e rregulloreve të peshkimit;
- Operacione për të ruajtur ekuilibrin ekologjik dhe mjedisin detar;
- Operacionet për mbrojtjen dhe administrimin e mirë të pasurisë së peshkimit (biomatja etiologjike);
- Operacionet për sigurinë në det.

Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”

Ky ligj ka transpozuar pjesërisht Rregulloren e Këshillit nr. 1224/2009/KEE; Direktivën 2000/60/KE; Rregulloren e Këshillit nr. 2371/2002/KE “Për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peshkimit”; Rregulloren e Këshillit nr. 1967/2006/KE; Rregulloren e Këshillit nr.1005/2008/KE; Rregulloren e Këshillit (KE) nr.199/2008; Rregulloren e Këshillit nr.104/2000/KE; Vendimin e Komisionit nr.1999/478/KE; Vendimin e Komisionit nr.2005/629/KE; Rregulloren zbatuese të Komisionit nr. 404/2011/BE; Këshillin nr. 1224/2009/KEE.

Ky ligj rregullon menaxhimin e veprimtarive të peshkimit dhe siguron mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë. Qëllimet:

- sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe atyre detare;
- përcaktimin e rregullave për menaxhimin e sektorit të peshkimit;
- përcaktimin e masave të ruajtjes për mbrojtjen e burimeve biologjike detare dhe ujërave të brendshme;
- nxitjen e kërkimit shkencor dhe teknologjik dhe grumbullimit të të dhënave në peshkimi;
- sigurimin e funksionimit dhe menaxhimit të porteve e të qendrave të peshkimit;
- një politikë strukturore, me qëllim ristrukturimin e sektorit të peshkimit, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, forcimin e konkurrencës e zhvillimit ekonomikisht të vlefshëm të subjekteve të peshkimit, rigjallërimin e zonave që varen nga peshkimi, si dhe përmirësimin e furnizimit të tregut dhe rritjen e vlerës së prodhimit;
- ngritjen e një sistemi kontrolli për peshkimin.

Këtij ligji u nënshtrohen:

- Shtetasit shqiptar dhe të huaj që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari peshkimi në hapësirën detare dhe ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

- Mjetet lundruese shqiptare dhe ato të huaja që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari peshkimi në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë.
- Veprimtaritë e anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, të cilat veprojnë në ujërat e vendeve të tjera dhe në det të hapur.
- Të gjitha veprimtaritë e peshkimit që zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Mbikëqyrja, menaxhimi e rregullimi i peshkimit dhe i veprimtarive që kanë lidhje dhe me to, bëhet nga ministria përgjegjëse për bujqësinë, e cila bashkëpunon me të gjitha ministritë që lidhen me veprimtarinë e peshkimit. Organet konsultative në lidhje me veprimtarinë e peshkimit janë:

Komisioni Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën dhe Komiteti për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik.

Zonat e mbrojtura të peshkimit janë miratuar me VKM. Në hapësira të tilla, ndalohen veprimtaritë e mëposhtme:

- të ushtrohet veprimtari peshkimi;
- të merret apo të shfrytëzohet fauna ose flora;
- të shfrytëzohet rëra ose zhavorri, të shkarkohen ujërat apo çdo material tjetër ndotës, si dhe të ndërhyhet apo të shkatërrohet mjedisi;
- të ndërtohen struktura në tokë apo në ujë;
- të ndërmerren apo të kryhen veprimtari të tjera që mund të kenë një ndikim negativ mbi ekosistemin e zonës së mbrojtur.

Për të mbrojtur riprodhimin natyror të peshqve të ujërave detare dhe peshqve ujërave të brendshme dhe të vegjëlve të tyre, si dhe të organizmave të tjerë ujorë, ministri urdhëron një ndalim peshkimi për periudha kohore të caktuara. Gjithashtu, ministri mund të përcaktojë numrin e anijeve të peshkimit, fuqinë motorike të tyre, pajisjet e peshkimit që mund ose nuk mund të përdoren në zona të caktuara peshkimi, numrin e lejeve në një zonë të caktuar, etj.

Ndalimet në peshkim dhe në zonat e veçanta:

- Zënia, mbledhja dhe/ose tregtia e peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë me eksplozivë, substanca kimike ose në çdo mënyrë tjetër që vret, intoksikon ose i helmon ato.
- mbajtja në breg e eksplozivëve ose substancave kimike që vrasin, helmojnë apo intoksikojnë peshkun dhe organizmat e tjerë ujorë.
- Përdorimi dhe mbajtja në bord e substancave toksike, narkotike dhe gërryese; pajisjeve që gjenerojnë shkarkime elektrike; eksplozivët; substancat që nëse bashkohen së bashku, mund të shpërthejnë; mjeteve me tërheqje, kryqeve të Shën Andreas apo pajisjeve të ngjashme me to, që përdorohen për mbledhjen e koralit të kuq dhe llojeve të tjera të koralëve apo organizmave të tjerë të ngjashëm me koralet; çekiçeve pneumatikë ose pajisjeve të tjera me goditje për grumbullimin, sidomos të molusqeve dykapakorë të futur në shkëmb; rrjetave fundore mbledhëse me madhësi hapjeje më të vogël se 40 mm për peshkarexha.
- peshkimi në zonën e portit, rrugët e hyrjes, si dhe vendet e ankorimit.
- Peshkimi me trata koçe, draga, kurthe, koshilok, trata zalli, trata krahu bregdetare dhe rrjeta të ngjashme në fundet me bimësi, sidomos të Posidonia oceanica dhe fanerogameve të tjera detare.

Akte të tjera të ndaluara përfshijnë:

Peshkimi, mbajtja në bord, transitimi, zbarkimi i qëllimtë dhe hedhja në treg ose për konsum, në çdo periudhe, zone dhe me çfarëdolloj mjeti a pajisjeje i këtyre organizmave ujorë:

- Korali i lumit- *Salmo letnica*, lumi;
- Koralet (Corallium spp.);
- Troftë - *Salmotrutta magrostigma*; *Salmo marmoratus*;
- Blini turigjatë *Acipenser sturio*
- *Acipenser naccarii*;
- peshkaqenët - *Cetorhinus maximus*,
- Carcharæodon carcharias;
- lopa e detit - *Mobular mobula*;
- Gurshpuesi (dateri) - *Lithophaga lithophaga*;
- sfungjerët;
- gjitarët e detit (balenat, delfinët dhe fokat);
- Breshkat e detit (*Carretta carretta*, *Chelonia mydas* and *Dermochelys coreacea*);
- breshkat e ujërave të ëmbla (*Emys orbicularis*, *Mauremys caspica*);
- shpendët e detit.

Anijet e peshkimit, të pajisura me leje peshkimi tregtar ndalohen të përdorin pajisje që nuk janë markuar në vendet e caktuara, përtej distancës 12 milje detare nga deti territorial. Ndalohet të pajisen me leje për peshkimin fundor anijet e peshkimit me fuqi motorike më të vogël se 224 KW dhe më të madhe se 746 KW. Peshkimi jashtë ujërave të brendshme të territorit të Republikës së Shqipërisë kryhet me autorizim të veçantë nga ministri.

Inspektorati i peshkimit është autoriteti përgjegjës për monitorimin/inspektimin e veprimtarive të peshkimit dhe sforcos së peshkimit. Monitorimi/inspektimi kryhet në det, në porte, gjatë transportit, gjatë procesit të përpunimit dhe në tregun e shitjes së peshkut dhe të nënprodukteve të tij. Ky funksion kryhet në bashkëpunim me policinë e Shtetit, organet tatimore dhe doganore, policinë bashkiake, Rojën Bregdetare, kapiteneritë e porteve, QNOD-në, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, si dhe çdo autoritet tjetër përgjegjës.

Ligji nr. 103/2016 “Për akuakulturën”

Ky ligj është përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 1380/2013; Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1999/2008 dhe Rregulloren (BE) nr. 508/2014.

Prona shtetërore ose ajo në pronësi të pushtetit vendor, si dhe uji sipërfaqësor i jepet me qira personave juridikë e fizikë të interesuar për të ushtruar veprimtarinë e akuakulturës. Një sistem lejesh është në fuqi për veprimtaritë e akuakulturës dhe nënshkruhet një kontratë për ushtrimin e këtyre veprimtarive.

Zonat e përcaktuara për akuakulturën miratohen nëpërmjet një sistemi planifikimi që synon integrimin e veprimtarisë së akuakulturës në zonën ujore, bregdetare dhe tokësore me përdoruesit e tjerë, për të shmangur konfliktet në përdorimin e këtyre zonave.

Zbatohet për të lehtësuar dhe zhvilluar veprimtarinë e akuakulturës në zonën ujore, bregdetare dhe tokësore, duke përfshirë procesin e dhënies së lejeve dhe procedurat e funksionimit.

Tre kategoritë e zonimit përcaktohen:

- zona të përshtatshme për veprimtarinë e akuakulturës;
- zona të papërshtatshme për veprimtarinë e akuakulturës;
- zonat për veprimtari të akuakulturës me rregulla të veçanta dhe/ose kufizime.

Ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar

Ky ligj është në përputhshmëri të pjeshme me nenin 2, nenin 3 dhe me shtojcën e Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE “Për udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve” dhe me nenin 2 dhe 3 të Rregullores (BE) nr. 692/2011, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, datë 6 korrik 2011, “Për statistikën Evropiane në Turizëm” dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 95/57/KE.

Qëllimi i këtij ligji është të promovojë Shqipërinë si një destinacion turistik tërheqës për vizitorët e vendas dhe të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse të sotëm dhe të brezave të ardhshëm.

Objekt i këtij ligji janë: Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike në RSH; rregullimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit të organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore në përcaktimin e politikave dhe zhvillimit të strategjive në fushën e turizmit; rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe investitorëve potencialë, bazuar në interesin publik për zhvillimin e turizmit.

Turizmi dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me të mbështeten në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social-kulturor.

Organet përgjegjëse në fushën e turizmit janë:

- Ministria përgjegjëse për turizmin;
- Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat për Turizmin;
- Agjencia Kombëtare e Turizmit;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit;
- degët territoriale të turizmit;
- Inspektorati që mbulon fushën e turizmit;
- njësitë e qeverisjes vendore;
- Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike.

Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit është ngritur në çdo prefekturë nën drejtimin e prefektit për të bashkërenditur punën ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe njësite të qeverisjes vendore, për çështjet e turizmit. Këto komitete përbëhen nga përfaqësues të njësite të qeverisjes vendore, përfaqësues të qarkut, përfaqësues të shoqatave lokale në fushën e turizmit, institucioneve arsimore dhe edukuese për turizmin dhe përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Agjencia Kombëtare e Turizmit

Agjencia Kombëtare e turizmit ka këto funksione dhe kompetenca: zbaton politikat e marketingut në fushën e turizmit, duke promovuar turizmin shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB)

AKB-ja është përgjegjëse për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare përmes zbatimit të politikës së integruar të menaxhimit të zonës bregdetare, vendosjen e standardeve kombëtare për zonën bregdetare të përdorur për turizmin, monitorimit të përputhshmërisë ligjore të veprimtarive të turizmit detar, etj. Objektivat operacionale të NCA-së janë:

- Ruajtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare;
- Zbatimi i politikave dhe strategjive për menaxhimin e integruar të zonave bregdetare;
- Bashkërendimi i programeve të lidhura me zonën;
- Nxitja e investimeve në zonën bregdetare.

AKB-ja garanton zbatimin e politikave dhe strategjive kombëtare në zonën bregdetare, të projektuara për menaxhim të integruar të zonës bregdetare dhe koordinon zbatimin e tyre. Një nga detyrat kryesore të kësaj agjencie është krijimi i një sistemi rregullash dhe standardesh për menaxhimin e hapësirave publike përgjatë vijës bregdetare. AKB-ja ka për qëllim të përdorë më së miri institucionet publike ose subjektet private në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike

Ky komitet është ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin. Ajo certifikon veprimtaritë turistike, jep dhe shfuqizon certifikatat përkatëse.

Inspektorati i turizmit kontrollon zbatimin e kriterëve dhe kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore, sipas këtij ligji, mbajnë inventarin e burimeve kryesore turistike dhe inventarin e sipërmarrjeve turistike në nivel vendor.

Planifikimi i zhvillimit të turizmit është pjesë integrale dhe hartohet në përputhje me planin kombëtar të territorit, me strategjinë e turizmit dhe me legjisllacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe me dispozitat e legjisllacionit për administrimin dhe mbrojtjen e tokës.

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

Ky ligj ka transpozuar plotësisht Direktivën 2008/98/KE “për mbetjet”... Synon të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur të mbetjeve nëpërmjet: a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre; c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme të përdorimi i burimeve. Ajo prezantoi konceptin e hierarkisë së mbetjeve, përgjegjësitë e zgjeruara të krijuesit, programet e parandalimit të mbetjeve, fundi i statusit mbetje, nënproduktet, etj. Vendos të njëjtat objektiva dhe afate si Direktiva Kuadër “Për mbetjet”, në lidhje me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve plastike dhe përgatitjen për ripërdorim dhe riciklim. Ligji u ndryshua për të ndaluar plotësisht importin e mbetjeve të çdo lloji në Shqipëri. Transiti i mbetjeve të rrezikshme në territorin e Shqipërisë është gjithashtu i ndaluar. Lejohet vetëm eksporti pas autorizimit. Ligji vendos kërkesa për ripërdorim/riciklimin/rikuperimin e gomave të përdorura, ku shumica e tyre janë të ndaluara të mbahen në landfille në tërësi, që nga janari 2013

ndërsa ato që do të bluhën që nga data 1 janar 2016. Ligji ka pasur zbatim të dobët dhe asnjë nga objektivat nuk është përmbushur, edhe pse afatet kanë kaluar.

VKM nr. 1104, datë 28.12.2015 “Për miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat, në det”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 2000/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 nëntor 2000, “Për objektet e palëvizhme portuale për mbetjet e krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat”. Qëllimi është mbrojtja e mjedisit detar nga anijet, gjatë përdorimit të porteve të Republikës së Shqipërisë. Kjo VKM zbatohet për të gjitha llojet e anijeve brenda një porti shqiptar. Përpara hyrjes në portet shqiptare, anijet duhet të japin informacion lidhur me llojin dhe sasinë e mbetjeve dhe tepricave që do të dorëzohen dhe/ose mbahen në bord dhe përqindjen që ato zënë në raport me kapacitetin maksimal të magazinimit. Mbetjeve plastike i kushtohet një kolonë e veçantë në tabelën e informacionit. Përpara se të largohen nga porti, anijeve u lëshohet një Certifikatë e Dorëzimit të Mbetjeve, që tregon çdo lloj specifik mbetjesh të riciklueshme, duke përfshirë mbetjet plastike si një zë i veçantë, sasi të që i dorëzohen operatorit të mbetjeve dhe/ose instalimeve marrëse, si dhe sasi të mbajtura në bord. Ata u paguajnë një tarifë operatorëve për menaxhimin e mbetjeve të dorëzuara, gjithashtu duke mbuluar menaxhimin e mbetjeve plastike.

VKM nr. 178, datë 6.3.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”

Ajo transponon plotësisht Direktivën 2000/76/KE “Për incinerimin e mbetjeve”.

VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfilllet e mbetjeve”

Ajo transponon plotësisht Direktivën 1999/31/KE “Për landfillin e mbetjeve” dhe Vendimin e Këshillit 2003/33/KE që përcakton kriteret dhe procedurat për pranimin e mbetjeve në landfille.

VKM nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 94/62/KE “Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet”.

VKM nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 2006/66/KE “Për bateritë dhe akumulatorët”.

VKM nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e automjeteve në fund të jetës”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 2000/53/KE “Për automjetet e dala jashtë përdorimit”.

VKM nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 75/439/KEE “Për asgjësimin e vajrave të përdorura”

VKM nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e automjeteve në fund të jetës”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën “Për Automjetet në fund të jetës” 2000/53/KE.

VKM nr. 957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 2002/96/KE “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” (MPEE).

VKM nr. 608, datë 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”

VKM nr. 127, datë 11.2.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 86/278/KEE “Për llumrat e ujërave të zeza”.

VKM nr. 387, datë 6.5.2015 “Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura”

Kjo VKM ka transpozuar plotësisht Direktivën 96/59/KE “Për asgjësimin PCB/PCT-ve”;

VKM nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”

VKM nr. 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”

2.1. POLITIKA PËRKHATËSE E ICZM-SË NË SHQIPËRI

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI-II) është miratuar me VKM nr. 348, datë 11.5.2016. Ajo thekson nevojën për:

- krijimin e një rrjeti ekologjik natyror 2000 për Shqipërinë dhe Komunitetin Europian;
- ristrukturimin dhe fuqizimin organizativ të strukturave për menaxhimin e zonave të mbrojtura;
- garantimin e zbatimit me efikasitet të planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe planeve të veprimit për specie dhe habitatat.

SKZHI-II, ndër të tjera, përcakton si objektiv strategjik “Thellimi dhe forcimi i mbrojtjes së natyrës” nëpërmjet:

- Një rritjeje të synuar me 17% të sipërfaqeve të Zonave të Mbrojtura të territorit përmes përmirësimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura;
- Krijimin e rrjetit ekologjik “Natura 2000”; dhe
- Sigurimit të statusit të konservimit të 5% të specieve dhe habitateve të kanosura/rrezikuara.

Politikat strategjike për mbrojtjen e Biodiversitetit

Dokumenti i politikave strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DSPPB) miratohet me VKM nr.31, datë 20.1.2016. Ky dokument identifikon qartësisht qëllimet e tij:

Deri në vitin 2020, të sigurohet përafrimi dhe zbatimi i plotë i acquis-it të BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës;

Deri në vitin 2015, të ketë një dokument strategjik për biodiversitetin (DPSMB) të rishikuar dhe të miratuar – në përputhje me objektivin Aichi 12;

Deri në vitin 2020, të krijohet një objektiv i ruajtjes prej 17% të zonave ujore tokësore dhe në brendësi dhe 5% e zonave detare dhe bregdetare. Krijimi i Rrjetit Kombëtar ekologjik i Shqipërisë, si një pjesë integrale e Rrjetit Ekologjik Pan-Evropian (PEEN) – në përputhje me objektivin e Aichi-t 11;

Të restaurohen të paktën 15% e zonave të degraduara përmes veprimtarive konservuese dhe restauruese – në përputhje me objektivat e biodiversitetit Aichi-t – ky veprim do të arrihet përmes zbatimit të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe përmes zbatimit të planeve të veprimit për llojet në veçanti dhe habitatat;

Bujqësi dhe pylltari më të qëndrueshme – në përputhje me objektivat e Aichi-t;

Zbatimi i protokollit të Nagoya-s për aksesin dhe ndarjen e përfitimit të burimet gjenetike dhe përfitimet që lindin nga përdorimi i tyre – në përputhje me objektivin e Aichi-t

Plani strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (drafti)

Plani strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (PSZMDB) është përgatitur në prill të vitit 2013 me mbështetjen e UNDP-së në kuadër të projektit “Përmirësimi i mbulimit dhe menaxhimi i efektshëm i zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare”. Ky dokument përmban një analizë të situatës në lidhje me nevojën, mundësitë dhe kufizimet për zhvillimin dhe zbatimin e PSZMDB-së, kriteret që mund të përdoren për identifikimin e zonave që mund të bëhen pjesë e rrjetit të ZMDB-ve dhe një inventar të ZMDB-ve ekzistuese dhe atyre të propozuara, së bashku me kriteret specifike që justifikojnë përfshirjen e tyre në rrjetin e PSZMDB-ve, si dhe një grup rezultatesh kryesore e veprimesh të lidhura me to, të nevojshme për zhvillimin dhe dorëzimin e PSZMDB-së. Drafti nuk është miratuar ende zyrtarisht, por shërben si dokument udhëzues për menaxhimin e zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare.

Strategjia për Zhvillim të ZM-ve – Programi strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020

Ky dokument është përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM). *Vizioni* i këtij dokumenti është “transformimi i zonave të mbrojtura në territore për ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, duke promovuar një sërë vlerash të tjera (turizëm/rekreacion, kulturë, gastronomi, estetikë, shëndetësor, shpirtëror, etj.), duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke ndikuar pozitivisht në komunitetet lokale”. Dokumenti nuk është miratuar zyrtarisht, por shërben si një dokument udhëzues për punën e AKZM-së.

Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2018 – 2022

Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2018-2022 (SKZHQT) është një instrument politikash që kërkon mbrojtjen, ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe kulturore dhe në veçanti, zhvillimin e zonave të mbrojtura natyrore, siteve me vlera kulturore dhe historike dhe të peizazhit natyror. *Vizioni* është: “Të njihet Shqipëria si një destinacion atraktiv, autentik, mikpritës turizmi në rajonin mesdhetar dhe në Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike për zhvillimin e produkteve të cilësisë lartë dhe të shumëllojshme, e arritshme lehtësisht nga tregjet ndërkombëtare.”.

Objektivat kryesore të politikave në fushën e turizmit janë: Rritja e kontributit të turizmit në të ardhurat e përgjithshme të vendit; zhvillimi i balancuar i ofertës turistike dhe shërbimeve; rritja e punësimit në sektorin e turizmit; përmirësimi i nivelit të jetesës dhe zbutjen e varfërisë në vend; zonat turistike në të gjithë vendin; rritja e shpenzimeve për turizmin (investimet publike); rritja e të ardhurave nga veprimtaritë dhe shërbimet turistike; dhe sigurimi i mbrojtjes ligjore dhe institucionale e të drejtave të udhëtarëve dhe vizitorëve.

Strategjia e Peshkimit 2016-2021

Kjo strategji paraqet një vizion të përgjithshëm strategjik për zhvillimin afatmesëm të sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës në Shqipëri. Ajo përcakton objektivat dhe prioritetet e Shqipërisë që janë në përputhje me ato të Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE-së. Strategjia përmban objektivat specifikë të zhvillimit (OSZH) dhe masat përkatëse të propozuara lidhur me peshkimin artizanal me mjete të lehta dhe monitorimin, kontrollin dhe vëzhgimin e veprimtarive të peshkimit (MKV).

OSZH 6: Mjedis detar i mirëmenaxhuar që mbështet peshkimin e qëndrueshëm artizanal

Zhvillimi i planeve të menaxhimit bregdetar për peshkimin dhe mbrojtjen e mjedisit. (me nisma më të gjera të ICZM-së, aty ku ekziston)

Krijimi i një rrjeti dhe i grupeve të menaxhimit bregdetar për të zhvilluar dhe zbatuar Planet e Menaxhimit Bregdetar.

Identifikimi i zonave kritike të peshkimit dhe habitateve natyrore që kërkojnë mbrojtje shtesë

OSZH 9: Një regjim menaxhimi dhe zbatimi që kontrollon aksesin në burimet e peshkimit në një mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme

Masat për zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës të MKV-së për trupat ujorë bregdetare/të brendshme, si pjesë e një qasjeje më të gjerë bashkëmenaxhimi, kombinuar me ngritjen/trajnimin e kapaciteteve në teknikat MKV

Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020

Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor (CSSRAD) u miratua me VKM nr. 709, datë 29.10.2014. Ajo është hartuar sipas strategjisë “Evropa 2020” për një rritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe përfshirëse dhe të objektivit të përgjithshëm strategjik të Shqipërisë për t’u anëtarësuar në BE. Ajo është përgatitur në përputhje me qasjen për planifikim strategjik në BE për Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) 2014-2020, duke u përqëndruar në të njëjtën kohë në nevojat specifike për zhvillimin e bujqësisë, të agropërpunimit dhe zonave rurale në Shqipëri. Këto

nevoja dhe sfida janë bazuar dhe analizuar përmes disa studimeve sektoriale dhe analizave si pjesë e procesit të përgatitjes së strategjisë.

Objektivi i tij kryesor është përcaktimi i një kuadri strategjik për trajtimin e sfidave me të cilat përballen sektori i bujqësisë dhe agropërpunimit, si edhe zhvillimi i zonave rurale në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale, duke propozuar instrumente politikash të ngjashme me instrumentet e PPB-së, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përgatitjes së sektorëve, instrumenteve të politikave dhe përshtatjes institucionale për anëtarësimin në BE, për të arritur një përmirësim të qëndrueshëm të konkurrencës së Shqipërisë.

Agroturizmi do të jetë një ndër mjetet jo vetëm të promovimit turistik, zhvillimit ekonomik, por edhe të rritjes së qëndrueshmërisë së turizmit dhe ruajtjes dhe promovimit të identitetit kulturor edhe lokal.

Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025

Kjo strategji është miratuar me VKM nr. 175, datë 19.1.2011. Zbatimi i strategjisë përfshin një plan masash për të mundësuar ndarjen e mbetjeve në burim. Në të gjitha zonat urbane kërkohet instalimi i një sistemi me 3 kosha mbetjesh:

- një për të mbledhur mbetjet e thata, ku futen materialet e paketimit (paketimet plastike, etj.) dhe artikuj të tjerë me mbetje plastike
- një për të mbledhur mbetjet e lagështa, d.m.th. mbetjet organike/bio , dhe
- një për të mbledhur mbetjet e përziera, të cilat nuk bëjnë pjesë në asnjë nga dy grupet e para.

Mbetjet e thata të riciklueshme duhet të transferohen në stacionet e transferimit për klasifikim të mëtejshëm dhe më të detajuar. Më pas çdo rrymë të veçantë mbetjesh duhet të merret nga industria përkatëse e riciklimit. Kështu, mbetjet e thata, të cilat llogariten me rreth 48% të mbetjeve aktuale që dalin në Shqipëri, do t'i shkojnë industrisë për ripërdorim/riciklim/rikuperim dhe për rrjedhojë, do të devijohen nga landfilli. Janë përgatitur dhe priten të miratohen draftet e dokumenteve për Strategjinë dhe planin kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve 2018-2033.

Strategjia sektoriale për transportin dhe plani i veprimit 2016-2020

Kjo strategji u miratua me VKM nr. 811, datë 16.11.2016. Qëllimi i përgjithshëm i këtij dokumenti është të zhvillojë një transport kombëtar multimodal, të përmirësojë qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij në një kontekst më të gjerë për transportin rajonal, evropian dhe ndërkombëtar. Dokumenti është në përputhje me objektivat për zhvillimin socio-ekonomik dhe integrimin në BE të vendit. Plani i veprimit bazohet në shtyllat e mëposhtme: rritja blu, lidhja e rajonit (rrjetet e transportit dhe energjisë); cilësia e mjedisit, turizmi i qëndrueshëm. Arritja e një modeli turistik të integruar e të kombinuar të dimensioneve bregdetare (plazh dhe diell), kulturore (arkeologjia, trashëgimia) dhe natyrore (eko-turizmi) mbështetet gjerësisht në një rrjet rrugor efikas, që mund të lidhet me çdo cep të vendit. Disa destinacione kanë rëndësi të veçantë dhe kanë nevojë për lidhje rrugore me cilësi të lartë: Destinacionet Bregdetare, Sitet e Trashëgimisë Botërore dhe Eko-Turizmi. MIE (aktualisht ministria përgjegjëse për Transportin dhe Infrastrukturën) është institucioni përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

2.2. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ICZM-NË

Këshilli Kombëtar i Territorit

Ky Këshill kryesohet nga kryeministri siç përcaktohet në dispozitat e ligjit “Për planifikimin e territorit”.

Këshilli Kombëtar i Ujit

Ky Këshill kryesohet nga kryeministri siç përcaktohet në dispozitat e ligjit “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

MIE-ja është përgjegjëse për zhvillimin e planifikimit të territorit dhe për projektet me rëndësi kombëtare. Armët e saj zbatuese janë Agjencia Kombëtare e Rregullimit të Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Zhvillimit të Territorit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

MTM-ja është përgjegjëse për:

- politikat për mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujit, natyrës dhe biodiversitetit, mbrojtjen e peizazheve natyrore, faunës së egër, speciet e rrezikuara dhe zonat e mbrojtura, si dhe
- hartimi dhe zbatimi i politikave të qëndrueshme të turizmit.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB)

Është një institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Është përgjegjëse për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare përmes zbatimit të politikës menaxhimit të integruar të zonës bregdetare, vendosjes së standardeve kombëtare për zonën bregdetare të përdorur për turizmin, monitorimit të përputhshmërisë ligjore të veprimtarive të turizmit detar etj.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Është një institucion në varësi të MTM-së i organizuar në nivel qendror (AKZM) dhe vendor (AdZM). Ajo është përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe ka për detyrë administrimin dhe kontrollin e tyre në të gjithë territorin e vendit.

Agjencia rajonale e Zonave të Mbrojtura (AdZM-të)

Këto janë institucione, në varësi të AKZM-së, dhe të vendosura në rajonet përkatëse. Ato përbëjnë një rrjet lokal institucional të specializuar që kryen detyrat e mbrojtjes dhe zhvillimit të zonave të mbrojtura mjedisore brenda këtij rajoni.

Komitetet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura

Për të ndjekur zbatimin e planit të menaxhimit në zonat e mbrojtura ngrihen komitetet e menaxhimit të zonave të mbrojtura, duke përfshirë zonat bregdetare dhe detare.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Është një institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Ajo është e organizuar si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor.

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (IMOC)

Ky institucion ndërmistror duhet të garantojë mbikëqyrjen e hapësirës detare shqiptare, për të kryer organizimin, planifikimin, koordinimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Drejtoria e Përgjithshme Detare/Kapiteneria e Portit

Ky është një organ me specialistë të transportit detar që punojnë 24/7 për kontrollin e trafikut detar, parandalimin e ndotjes, informacionin përpara mbërritjes, paralajmërime navigacioni, mbledhjen e të dhënave nga anijet dhe marinarë tjerë në det, me kapacitet për t'u koordinuar me zyra të tjera homologe në Shqipëri dhe Itali dhe Greqi. Edhe pse kjo strukturë mund të ketë një kontribut të konsiderueshëm në reagimin ndaj ndotjes nga nafta, veprimtaria e tyre është shumë e kufizuar për shkak të mungesës në infrastrukturë, pajisje dhe trajnimit të duhur. Por një pjesë e këtyre institucioneve, nëse mbështeten me kuadrin ligjor, personelin dhe pajisjet mund të japin një kontribut të madh në këtë drejtim. Aktualisht, ky institucion kontrollon dërgimin nga anijet të mbetjeve të naftës dhe operacioneve të tjera nga ngarkesat sipas Direktivës 2000/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 27 nëntorit 2000 “Për objektet e palëvizhme portuale për mbetjet e krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat”. Për çështje të tjera mjedisore, ky institucion ka pak ose aspak veprimtari.

Flota e vogël e Rojes Bregdetare

“Flotilja e rojeve Bregdetare” (FRB) është vendosur në “Bisht Pallë” në Durrës dhe në bazën “Pashaliman”, Vlorë me kapacitetin për patrullim, monitorim, kryerjen e operacioneve të SAR-it, operacionet kundër ndotjes dhe detyra të tjera specifike.

Policia Kufitare dhe Zyra e Emigracionit

Të stacionuara në portin e Vlorës, me kapacitet për të kontrolluar vijën bregdetare dhe territorin e jugut të Shqipërisë dhe për të kryer operacione kundër migracionit të paligjshëm dhe operacione të tjera të jashtëligjshme. Roli i tyre kufizohet vetëm në monitorimin dhe raportimin në rast të ndonjë ndotjeje nga nafta në det, por nuk ka shumë ekspertizë në reagimin ndaj ndotjes nga nafta. Gjithashtu, ky institucion duhet të pajiset me kuadrin e veçantë ligjor dhe trajnimit të duhur.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit

Është një institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Ai është i organizuar si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor dhe është përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit për mjedisin, pylltarinë, ujin dhe turizmin.

Inspektoriati i Peshkimit

Inspektoriati i peshkimit është autoriteti përgjegjës për monitorimin/inspektimin e veprimtarive të peshkimit dhe sforcos së peshkimit.

Instituti i Shëndetit Publik

Është një institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ai monitoron cilësinë e ujërave të larjes dhe përcakton zonat që përputhen me normat e cilësisë së ujërave të larjes, në lidhje me Escherichia coli dhe intestinal Enterococi.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Është një institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i organizuar si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor. Ai kontrollon dhe zbaton pajtueshmërinë me rregulloret higjieno-sanitare.

Bashkitë


Bashkitë janë të përfshira në miratimin e zhvillimeve të një shkalle të vogël me rëndësi rajonale. Ato bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me administratën e zonave përkatëse të mbrojtura; janë përgjegjëse për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve, përgatisin planifikimin e mbetjeve dhe të tokës në territor në nivel vendor; kanë përgjegjësi në bazë të ligjit për akuakulturën, etj.

Pronarë privatë në territoret e Zonave të Mbrojtura

Individët, prona e të cilëve është e përfshirë në territorin e zonës së mbrojtur me mjedisin, mund të marrin pjesë në planifikimin, ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore të zonës, dhe ta administrojnë dhe ta përdorin atë, në përputhje me kërkesat e planit të menaxhimit.

OJQ-të që punojnë në fushën e mjedisit

Kur llobojnë për planifikimin dhe çështjet mjedisore, ato përfaqësojnë interesin publik. Në Shqipëri ka një sërë organizatash mjedisore aktive.



*

3. SEKSIONI 3. Përshkrim i përgjithshëm fizik dhe biologjik i zonës së studimit

3.1. KLIMA

Klima - Reshjet

Reshjet mesatare vjetore për të gjithë territorin janë 1485 mm dhe prurja mesatare vjetore 891 mm, ose afërsisht 40 km³, të cilat shkarkohen në det nga lumenjtë. Regjimi uhor është tipik mesdhetar; rreth 82-85% e prurjeve vjetore vërehen gjatë sezonit të lagësht (tetor-maj) dhe vetëm 6-9% gjatë sezonit së thatë (korrik-shtator.).

Klima - Erërat

Regjimi i erërave në Vlorë ndryshon në detin Jon dhe në detin Adriatik.

Në detin Jon, erërat mbizotëruese gjatë dimrit fryjnë kryesisht nga veriu ose veri-lindja, quhen “Bora” dhe mund të arrijnë një fuqi të madhe. Në periudha kalimtare, erërat ndryshojnë dendur dhe shpesh mbizotëron era jugore e quajtur “Shirok”. Era “Sirocco” që fryn nga jugu në këtë rajon, gjatë pranverës dhe verës mund të jetë e thatë ose e lagur. Në verë, zakonisht fryn një erë e lehtë nga jug-perëndimi dhe veriperëndimi.

Në përgjithësi, në Adriatik, erërat mbizotëruese fryjnë nga veriu dhe verilindja (30-36%) dhe juglindja (18-24%). Erërat veriore në dimër janë shpesh të forta, duke arritur deri në 40 m/s dhe quhen “Murlan” ose “Bora”, duke krijuar dallgë të forta e të rrezikshme për vijën bregdetare dhe për anijet. Në dimër, erërat fryjnë më shpesh nga jugu. Gjatë verës, regjimi i erërave është i përzier, por erërat që vijnë nga juglindja (rreth 25-30%) janë mbizotëruese. Në verë, erërat në det të hapur fryjnë zakonisht nga veri-perëndimi (rreth 20-40%).

Në vjeshtë, drejtimi i erës është shumë i paqëndrueshëm.

3.2. MJEDISI BREGDETAR DHE DETAR

Përshkrimi i vijës bregdetare

Në përgjithësi, pjesa veriore e vijës bregdetare e zonës së studimit ka një profil të ulët dhe është ranore, ndërsa pjesa jugore është shkëmbore, me rrëpira të larta dhe me breg shkëmbor me guralecë dhe plazhe zalli. Vija bregdetare e gjirit të Vlorës-zona e grykës së lumit Vjosa ka ndryshuar vazhdimisht rrjedhën nga sedimentimet lymështore që grumbullohen nga uji i lumit Vjosa dhe dallgët e stuhive në detin Adriatik. Gadishulli i Karaburunit njihet për shkëmbinjtë e tij të lartë, shpellat bregdetare dhe nënujore, si dhe plazhet e vogla me gurë zalli, si ai i gjirit të Gramës dhe konsiderohet i rrezikshëm gjatë stuhive me erëra të forta dhe me dallgë që mund të arrijë deri në 4 m lartësi.

Topografia nënujore dhe batimetria

Thellësia maksimale e gjirit të Vlorës është 55 m, me një mesatare prej 25 m. Thellësia në det të hapur e gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit po arrin me shpejtësi 100 deri në 800 m në një distancë të shkurtër nga bregu. Kanali midis Karaburunit dhe Sazanit është shumë i ngushtë duke pasur parasysh rëndësinë e trafikut detar dhe ka një thellësi maksimale prej 50 m.

U krye një studim me një sistem vëzhgimi thellësi-matës me rreze të gjerë dhe u paraqit një “model” i peizazhit nënujor, si dhe rrënojat e anijeve (për t’u përmendur autorët) Lumi Vjosë është burimi kryesor i sedimenteve për shelfin kontinental. Shpërndarja e sedimenteve (lumi Vjosa) i

nënshtrohet një modeli qarkullimi kompleks dhe lokal, që përcaktohet nga forma karakteristike rajonale e gjirit, për shkak të aktiviteteve tektonike.

Kërkimet kanë identifikuar rrënojat e anijes-spital “Po”, që gjendet në zonën juglindore të gjirit (Figurat 2A dhe 3). Gjithashtu, kërkimet kanë zbuluar vendndodhjen e rrënojave të anijes “Daisy Queen”, si dhe një anije të madhe dhe të rëndësishme, pranë kepit të Gjuhëzës, si dhe rrënoja të tjera, akoma të pidentifikuara, të dyja brenda gjirit dhe pranë këtij kepi. Në mënyrë efektive, midis ishullit të Sazanit dhe Kepit të Gjuhëzës shtrihej një fushë e minuar, në hapësirën e vogël të gjirit për kalimin e anijeve.




Figura 3: Harta morfo-batimetrike e gjirit të Vlorës me vendndodhjet e rrënojave të anijeve (të zbuluara në zonën e studimit) (j. Intervali i ngritjeve të kontureve batimetrike është 50 m, harta u zbuluar në zonën veriore UTM34.




Figura 4: Fotografji të marra nga të dhënat e hidrolokatorëve anësorë, ku tregohen të gjitha rrënojat e anijeve në zonën e studimit. Vendndodhjet paraqiten në figurën 1). A: Anija-spital “Po” (e mbytur gjatë Luftës së Dytë Botërore). B: Rrënoja të një anijeje të pidentifikuar. C: Kryqëzori i rëndë ‘Regina Margherita’ (Lufta e Parë Botërore). C: Rrënoja të një anijeje të pidentifikuar (nëndetëse). D: Rrënoja të një anijeje të pidentifikuar në pjesën perëndimore të gjirit të Vlorës.

Disa nga “anomalitë” e zbuluara shfaqen si shenja në shtratin e detit që mund t’i atribuohen qartë veprimtarive të njeriut, si p.sh.:

- Morfologjitë lineare që ngjajnë me gjurmë në shtratin e detit: disa janë shkaktuar nga rrjetat e peshkimit me tratë, të përdorura gjatë shfrytëzimit intensiv të popullatave të peshkut në Gji. Shumë gjurmë të markuara janë rezultat i pastrimit të minave.
- Në pjesën jugore të gjirit, pranë bazës ushtarake shqiptare, tabani është i pikëzuar me tipare rrethore (Figura 4). Kjo është pamja tipike kur terreni preket nga shpërthimet, kështu minat, e shpërthyerat në fundin e detit, kanë gjasë t’i kenë shkaktuar ato.

3.3. HIDROLOGJIA (BREGDETARE)

Ujërat e ëmbla dhe prurja e sedimenteve në zonë

I vetmi lumë që sjell përherë sedimente në det është lumi i Vjosës që ndodhet në veri të gjirit. Gryka e lumit ndryshon me shpejtësi në dimër dhe përgjatë viteve, zona tregon një proces të fortë erozioni, duke arritur lokalisht 10 m në vit. Prurje të tjera të ujërave të ëmbla vijnë nga kullimi i ujërave të shiut dhe nga shkarkimi i ujërave të zeza (mungojnë të dhëna).

3.4. HIDROLOGJIA (DETARE)

Batica dhe dallgët

Procesi i baticës është i çrregullt dhe ka një periudhë prej 12 orësh. Ai karakterizohet nga luhatje me amplituda të vogla. Kështu, në 50% të rasteve, amplituda mesatare ditore është më shumë se 25 cm dhe vetëm në 1% të rasteve, vlera e tij është më e madhe se 49 cm (Selenica, 2018). Dallgët më të larta në zonën bregdetare janë 3 deri në 4 m. Së bashku, gjatë stuhive me erë të fortë, të shoqëruara me presion të ulët barometrik dhe nivele të larta uji, lartësia maksimale e arritur në breg mund të jetë 5 m, duke krijuar ndërhyrje detare, sidomos në zonat e ultësirës, si laguna e Nartës.

Rrymat

Rrymat mbizotëruese në bregdetin e Shqipërisë vijnë nga jugu, si një rrjedhë e detit Jon, që hyn në Adriatik nga ana lindore e ngushticës së Otrantos, duke gjeneruar rryma bregdetare nga jugu në veri me kundërryma në brigjet kryesore. Shpejtësia e rrjedhës në Detin Jon, që lëviz drejt veriut përgjatë bregdetit grek, është më e madhe se ajo në Adriatik, por zakonisht nuk i kalon 0.5-0.7 milje detare. Kur fryjnë erërat e forta juglindore dhe veçanërisht pas erërave perëndimore, shpejtësia e rrjedhës rritet në mënyrë të konsiderueshme.

3.5. GJEOLGJIA, GJEOMORFOLOGJIA DHE TEKTONIKA

Gjeologjia e vijës bregdetare

Zona bregdetare e Gjirit të Vlorës përbëhet kryesisht nga formacione me gurë gëlqerorë të Kretakut të Sipërm në Triasik, nga gadishulli i Karaburunit deri në një pjesë të qytetit të Vlorës, me një peizazh të thepisur që bie mbi det dhe me një rrip të ngushtë bregdetar. Në veri, vargmalet vazhdojnë me kodrat e formuara nga depozitimet e periudhës së Neogjenit, duke formuar ligatinën e Nartës dhe ultësirën bregdetare.

Tektonik

Në përputhje me gjetjet gjeotektonike (Lacombe et al., 2009), Shqipëria është një nga zonat më aktive nga pikëpamja sizmike në Evropë, gjeotektonikisht shumë afër me Apeninet e Italisë fqinje, jashtëzakonisht aktive kohët e fundit. Kështu, zona e gjerë e Vlorës gjendet në një ndërveprim me të ashtuquajturit faktorë endogjene (gjeo-tektonikë, veprimtari sizmike), ekzogjene (erozioni, zhveshja, përmytjet, zhvendosja lumore dhe transportimi material, përmytje ujore, lloji i lagunave, etj.) dhe faktorë antro-pogjeografikë (urbanizimi, zhvendosja, industria, mënyra prodhimi). Një tërmet me epiqendrën e tij në Durrës, në veri të zonës së studimit, ndodhi më 25 nëntor 2019 me një magnitudë prej 6,4 me pasgoditje të shumta, një prej 5, 6 dhe një prej 5,1 që janë ndjerë në gjirin e Vlorës dhe në Tiranë. E thënë gjeomorfologjikisht, zona e transferimit “Vlorë-Elbasan” ndan ultësirën perëndimore, si ultësira kryesore shqiptare, nga e ashtuquajtura zonë Jonike (Albanidet e Jashtme) në drejtimin juglindor. Ultësira aluvionale në bregdetin Adriatik

është shtresëzuar dobët, me kënetë dhe laguna që zgjerohen vazhdimisht nga Orikumi (jugu i Vlorës) deri në Shkodër në veri. Ajo është zhvilluar gjatë proceseve të grumbullimit të sedimenteve në depresionet tektonike nënujore Peri-Adriatike. Në përgjithësi, pjesa më e madhe e sedimenteve, si dhe ato në vetë rajonin e Vlorës, vijnë nga zona Jonike, meqë Albanidet e brendshme ndahen prej saj, nga e ashtuquajtura zona e Krujës (një goditje tektonike) ndërmjet zonave të Krasta-Cukali-t dhe zonës Jonike (Fig. 2). Nën proceset intensive të erozionit, baseni Peri-Adriatik u mbush me materiale nga lumenjtë kryesorë shqiptar (Drini, Buna, Vjosa, Shkumbini, ujëmbledhësi i Seman/Osumit-Devollit dhe kështu me radhë) të maleve përreth duke u derdhur në Detin Adriatik.

Zona i nënshtrohet tërmeteve të dhunshme, si ato që ndodhën në Durrës në vitet 1267, 1273 dhe 2019, dhe ato më të fundit në nëntor të vitit 2019 që u ndjenë në Tiranë dhe Shkodër. Më i fundit në Tiranë, ndodhi në vitin 1988. Dy të rëndësishëm kishin epiqendër në Vlorë, një në vitin 1851 dhe tjetri në 1930. Është e mundur, duke pasur parasysh morfologjinë nënujore të pjerrësisë së shpatit të gadishullit të Karaburunit, që një tërmet i tillë në të ardhmen mund të pasohet nga një cunami, i cili mund godasë bregdetin e Shqipërisë dhe të Italisë.

3.6. Biologjia detare (fauna dhe flora, llojet bentike dhe pelagjike, vendase dhe ekzotike)

Sistemi i përbërë mjedisor i bregdetit Shqiptar është ruajtur përgjithësisht në gjendjen e tij natyrale dhe të pacenuar deri para disa vitesh, dhe mund të përfaqësojë një nga pikat e fundit të nxehta të biodiversiteti në ekosistemet detare në Mesdhe. (Anonim, 2002). Gjatë viteve të fundit, janë kryer procese natyrore komplekse dhe veprimtari të pakontrolluara njerëzore në këtë fushë (kryesisht në lidhje me zhvillimet urbane dhe të turizmit) dhe janë duke ekspozuar bregdetin shqiptar, dhe në veçanti gjirin e Vlorës, ndaj një ndikimi të fuqishëm në rritje, siç u përmblohd më lart dhe është raportuar në shumë studime të mëparshme specifike. Mbi këtë bazë, pritet një humbje e habitateve përkatëse bregdetare dhe një ulje e ndjeshme e vlerës ekologjike të zonës bregdetare dhe habitateve detare. Kjo humbje e është veçanërisht e rëndë në ekosistemet detare bregdetare, ku veprimtaritë e njeriut kanë qenë historikisht të përqendruara (Airoldi dhe Beck, 2007; Martin et al., 2005). Këto procese janë duke vepruar në disa zona, siç përshkruhet në raportet e pakta për bregdetin shqiptar (Anonim, 2002) dhe janë të mirë dokumentuara përgjatë vijave të tjera bregdetare evropiane (Airoldi dhe Beck, 2007), megjithëse ka ende mangësi të mëdha në njohuritë tona për humbjen e habitatit në vijat bregdetare të buta. Kjo është veçanërisht shqetësuese, pasi këto zona bregdetare përmbajnë disa nga ekosistemet më produktive dhe të larmishme, por edhe më të degraduara në botë (Edgar et al., 2000; Suchanek, 1994).

Për këtë arsye, njohuritë mbi habitatet bregdetare dhe informacionet e detajuara mbi strukturën e komuniteteve bentike janë pika thelbësore për përcaktimin e një baze referimi për kërkimet e ardhshme dhe për të drejtuar një ruajtje dhe menaxhim të brigjeve Shqiptare.

Parku Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan” I shpallur si Zonë e Mbrojtur Detare në vitin 2010, aktualisht është i vetmi Park Detar Kombëtar në Shqipëri. Në vitin 2016, në bazë të kritereve të protokollit SPA/BD, ajo u përfshi në Listën e SPAMI-t. Parku mbulon një zonë detare që shtrihet 1,9 km përgjatë vijës bregdetare të Gadishullit Karaburun dhe ishullit Sazan, pranë Gjirit të Vlorës. Parku detar është shumë 16 kilometra i gjatë, me gjerësi që varion nga 3 deri në 4,5 kilometra dhe mbulon në total 12,428 ha sipërfaqe. Vetë Gadishulli Karaburun është një Rezervë Natyrore e Menaxhuar ndërsa Ishulli Sazan është zonë ushtarake shqiptare. Zona e gjirit të Vlorës strehon një sërë habitatesh natyrore dhe shfaq një biodiversitet veçanërisht të pasur në shkallë vendi.

Në zonën e mbrojtur janë identifikuar të paktën 36 specie detare që bëjnë pjesë në listën ndërkombëtare të specieve të rrezikuara ose të mbrojtura. Për shembull, Ishulli i Sazanit është ishulli më i madh dhe strehon një pasuri të madhe ekologjike në termat e florës dhe faunës dhe një larmi peizazhesh. Midis 8% deri në 12% e florës së Shqipërisë mund të gjendet në ishull (Plani për Menaxhimin e Ishullit të Sazanit, Shqipëri, janar 2015, CdL). Ai ka gjithashtu një histori të madhe dhe trashëgimi kulturore, e cila e bën atë një aset të madh për zhvillimin e veprimtarive të turizmit të qëndrueshëm. Zona bregdetare e ZMD-së Karaburun-Sazan, në përgjithësi, më shumë shkëmbore, ndërsa ligatinat dhe dunat bregdetare janë të mbuluara kryesisht nga halofite dhe grupe vegjetale të ujërave të ëmbla. Plani i menaxhimit të ZMD-së “Karaburun-Sazan” identifikon zonat vijuese bregdetare, të përcaktuara nga thellësia e tyre dhe distanca e tyre nga bregu, të cilat strehojnë lloje të ndryshme të habitateve. (Table 1, Figura 4). Shpellat, kanionet dhe gjiret e vogla mund t'i gjeni në ato zona bregdetare.

Tabela 6: Llojet e habitateve detare të identifikuara në ZMD-në Karaburun-Sazan (Burimi: Plani i menaxhimit për Parkun Kombëtar Karaburun-Sazan, dhjetor 2014, UNDP/WWF).

Zonat litorale bregdetare	Nënndarja e zonave	Biocenoza (B)
Mediolitoral	Shtretër dhe gurë të fortë mediolitoralë	B. e formacioneve më të ulëta mediolitorale
		B. e shpellave mediolitorale
Infralitorale	Livadhet Posidonia oceanica	B. e Livadheve Posidonia oceanica
	Shtretër dhe gurë të fortë infralitoralë	B. e algave infralitorale
Circalitorale	Shtretër dhe gurë të fortë circalitoralë	B. koraligjenë
		B. e shpellave gjysmë të errëta

▪ Livadhet Posidonia oceanica

Kjo specie endemike e Detit Mesdhe ndodhet në listën e specieve të rrezikuara ose të cenuara të Shtojcës II të Konventës së Barcelonës. Livadhet *Posidonia oceanica* strehojnë një biodiversitet të madh të makro-faunës bentike (sfungjerë, molusqe ose krustace) dhe ka një rol të rëndësishëm për ciklin e jetës së shumë specieve detare. Livadhet Posidonia janë gjithashtu një strehë për peshqit, duke siguruar ushqim dhe mbrojtje nga grabitqarët e tyre. Po ashtu, gjethet e vdekura të tyre parandalojnë fenomenin e erozionit në plazhe duke krijuar gropa të mëdha ku futet rëra. Për këtë arsye, shtretërit Posidonia garantojnë funksione të shumta ekologjike dhe mund të kualifikohen si habitate shumë produktive për sa i përket shërbimeve të ekosistemit. Livadhet Posidonia ndodhen kryesisht në lindje të Gadishullit, brenda gjirit, ku janë më të mbrojtura nga dallgët. Në Gjirin i Vlorës, ato mund të vuajnë nga presionet antropogjene të shumta të shkaktuara nga zhvillimi i qytetit, ndotja dhe erozioni bregdetar për shkak të ndërtimit dhe depozitimeve të sedimenteve në ujë. Speciet invazive, si p.sh *Halophila stipulacea* kontribuojnë gjithashtu në degradimin e shtretërve Posidonia Hartat tregojnë se një pjesë e madhe e këtyre livadheve ndodhen jashtë perimetrit të ZMD-së. Për këtë arsye, do të ishte thelbësore që për ZMD-të të kishte një zonë veprimi më të gjerë sesa kufizimet strikte të zonës së mbrojtur, sidomos nëpërmjet edukimit, për të marrë pjesë edhe në ruajtjen e ekosistemeve të jashtme.

▪ Formacione koralogjene dhe parakoralogjene

Formacionet koralogjene dhe para-koralogjene janë gjithashtu një ekosistem i rëndësishëm i ZMD-së. Ato janë kryesisht të pranishme përgjatë vijës bregdetare të Ishullit të Sazanit dhe veçanërisht në zonën circalitorale, e cila përkon me zonën e pllakës kontinentale që shtrihet nën ekspozimin e herëpashershëm të baticës së zonës. Ajo mund të zhvillohet edhe në zonën infralitorale nëse drita është e mjaftueshme për të lejuar rritjen e algave coralline. Formacionet koralogjene dhe parakoralogjene mund të konsiderohen si “taban i fortë me origjinë biogjenike, që kryesisht prodhohet nga akumulimi i algave gëlqerore të korëzuara” (RAC/SPA, 2003). Ky lloj habitati shfaq biodiversitet të madh dhe përfaqëson mjedise mjaft tërheqëse për zhytjet me maska. Zhytësit mund të admirojnë një shumëllojshmëri vërtet të madhe të llojeve të peshqve, molusqeve, krustaceve dhe sfungjerëve. Formacionet koraligjene dhe para-koraligjene mund të ofrojnë shërbime të rëndësishme për shërbimet kulturore. Ato ofrojnë edhe shërbime ndihmëse duke dhënë përkujdesje dhe vend për lëshimin e vezëve për peshqit, nga të cilat mund të përfitojnë palët e interesuara të peshkimit. Megjithatë, këtyre habitateve i duhet të përballen me lloje të ndryshme presionesh: veprimtari njerëzore si mbipeshkim ose ndotje, specie invazive dhe ndryshime klimatike.

▪ Shkëmbinjtë nënujorë dhe ujërat e hapura

Peizazhi nënujor është gjithashtu i një cilësie të veçantë me shkëmbinj, shpella nënujore me florën e faunën përkatëse, dhe në disa vende, mbetje arkeologjike dhe anije të mbytura. Këto ekosisteme janë thelbësore për zhvillimin e biomasës së peshqve dhe biodiversitetit detar. Habitatet bregdetare shqiptare, për shembull, vizitohen shpesh nga gjitarët e rrallë detarë si foka mesdhetare, për të cilat shpellat e zonës përbëjnë një habitat ideal (Plani i menaxhimit për Parkun Kombëtar Karaburun-Sazan, dhjetor 2014, UNDP/WWF). Delfini i zakonshëm dhe delfini turishkurtër janë vërejtur gjithashtu në këtë zonë.

▪ Përmbledhje:

Për këtë arsye, sipërfaqet e paraqitura në këtë tabelë do të merren në konsideratë:

Tabela 7: Zona e ekosistemeve sipërfaqësore (Burimi: UNDP, datë).

Ekosistemet	Sipërfaqja në hektarë (ha)
Posidonia	149,03
Formacione koralogjene	276,18
Shkëmbinj nënujorë	498,88
Zona e ujërave të hapura	11 601,73
Totali i zonës	12 570,82

3.6.1. KOMUNITETET BENTIKE të sedimenteve të buta

Zona **më veriore** e kësaj biocenoze karakterizohej nga prania e një facie të veçantë gastropodi *Turritella communis* të shtrirë në veri të Sazanit (Figura 1). Një shtresë e gjerë balte argjilore e *P. oceanica* është regjistruar përgjatë brigjeve **lindore** dhe **jugore** të Gjirit, ku ajo zëvendësoi livadhet e mëparshme *P. Oceanica* gjatë viteve të fundit me një sipërfaqe prej 9,47 km² (rreth 8% të zonës së hartëzuar). Shtrati i gjerë i algave të gjelbra joindigjene *Caulerpa racemosa* var. *cylindracea* mbulonte pjesë të shtresave të pjesëve me baltë brenda Gjirit të Vlorës. Sipërfaqet e **mbetura të ngushta** të mbuluara me livadhet *P.oceanica* (sipërfaqe totale prej 9,47 km²; rreth 5% e zonës së hartëzuar) janë kufizuar në bregdetin juglindor të Gjirit, nga Plazhi i Vjetër deri te Kepi i Lumit dhe pranë Orikumit, midis 4 dhe 14 m në thellësi, si dhe në zonën e vogël të Kepit të Gjuhëzës përgjatë Gadishullit Karaburun. Përveç kësaj, një shtrat i madh Posidonia është regjistruar afër Ishullit Sazan. (Figura 1).

Shtrati *Cymodocea nodosa* është i pranishëm si facie në **tabanin e cekët ranor** afër plazhit të Vlorës (Figure 1). Mund të njihet qartë si facie e veçantë e zonës infralitorale mesdhetare të njohur si “Biocenoza e rërave me baltë sipërfaqësore në zonat strehuese (SVMC; sensu Pere`s, 1967; Pere` dhe Picard, 1964) me leshterikë të tipit *C. nodosa*.”.

Në përfundim, tabani detritik me baltë (DE; sensu Pere`s, 1967) u identifikua gjithashtu si një brez i ngushtë përgjatë **bregdetit të qytetit të Vlorës**, pak më i thellë se brezi i kolonizimit të *Caulerpa*-s. Këto komunitete të fundit u identifikuan vetëm nëpërmjet videove nënujore, ROV-ve dhe zhytjeve me maskë.

Harta hipotetike e biocenzës bentike të Gjirit të Vlorës tregon një total prej 151 taksonesh të identifikuar në tabanin e butë të Gjirit të Vlorës dhe 54 specie të regjistruara për herë të parë në ujërat shqiptare, duke rritur gjithashtu rëndësinë e studimeve të reja në shkallë kombëtare (shqiptare). Përveç kësaj, për speciet e gjetura që nuk ishin përfshirë në listën e kontrollit të Italisë për detin Adriatik (Relini, 2008), e cila përfaqëson një kontribut në shkallë rajonale që plotëson disa nga mangësitë e njohurive për makrobetosin në juglindje të detit Adriatik.




Figura 5. Harta e komuniteteve bentike në gjirin e Vlorës (Maiorano et al., 2011).

Bashkësia e specieve dhe struktura e komunitetit në tabanin e butë të Gjirit të Vlorës duken se janë prekur rëndë nga sforcimi përkatës radioaktiv, si nga veprimtaritë natyrore dhe nga ato antropogjene, dhe në veçanti nga ato që lidhen me transferimet terrigjene të vazhdueshme dhe masive. Bashkësitë e specieve karakterizoheshin nga disa specie përgjithësisht tolerante vendase të përshtatura me paqëndrueshmërinë mjedisore dhe biocenoza e identifikuar duket se po mbulohet gjithmonë e më shumë nga sedemintet e tepërta. Për rrjedhojë, për shkak të procesit të madh të sedimentimit, humbjet e habitateve duken se kanë ndodhur në vitet e fundit dhe po shkaktojnë zëvendësime të biocenoza vendase, siç është dokumentuar më parë nëpër Mesdhe nga Delta Rhone (Meinesz, Lefevre dhe Astier, 1991) deri në Lagunën e Venecias (Rismondo, Guidetti, dhe Curiel, 1997) dhe detet Taranto (Matarrese et al., 2004).

Kontributet e integruara në analizat cilësore dhe sasiore me anë të pajisjeve të ndryshme metodologjike mund të evidentojnë prezencën e komuniteteve bentike të shpërndara në mënyrë të ndryshme në tabanin e butë të Gjirit të Vlorës. Biocenoza e **baltës terragjene VTC** është e shpërndarë në gjirin e Vlorës duke filluar nga 20 m në 50 m thellësi maksimale dhe karakterizohet nga një dominim i specieve që jetojnë në batak, si kastravec i detit *Labidoplax digitata*, gastropodi *Turritella communis* dhe anelidët *Maldane glebiifex* dhe *Sternaspi sscutata* që mund të justifikojnë biodiversitetin e ulët në këtë biocenoza.

Të gjitha speciet janë raportuar në tabelat e paraqitura në shtojca.

Në **brezin më të cekët bregdetar**, një shtresë baltore *Posidonia* duket se ka zëvendësuar livadhin e mëparshëm *Posidonia*, i cili tani është i kufizuar me copëza të mbetura të ngushta bari deti përgjatë anës lindore të Gjirit të Vlorës. Sedimentimi në rritje për shkak të shkarkimeve të pakontrolluara dhe mbetjeve të materialeve inerte, së bashku me transportin e ngurtë intensiv nga bregdeti, ka sjellë pasoja shumë negative në *Posidonia*, pasi gjethet e tyre u mbuluan nga sedimentet dhe u dëmtuan rëndë, me një degradim të shpejtë pasues të të gjithë livadhit. Gjithashtu, në zona të tjera të Gjirit të Vlorës kjo gjendje vuajtjeje për *Posidonia*-n u theksua edhe gjatë eksplorimeve nënujore.

Megjithëse nuk ka një inventar të organizuar e gjithëpërfshirës të shpërndarjes dhe shtrirjes së barit të detit në Shqipëri, është zbuluar tashmë një degradim i shpejtë, lokal dhe një strukturë e copëzuar përgjatë bregdetit, veçanërisht në ato zona të prekura rëndë nga ndikimet e mëdha njerëzore dhe veprimtaritë e turizmit të pakontrolluar (Beqiraj et al., 2008; Pittito et al., 2009).

Edhe pse në të gjitha studimet u zbuluan treguesit më të lartë të biodiversitetit në brendësi të livadheve me *Posidonia*, në Gjirin e Vlorës ishte dokumentuar më parë një zonë me bar deti të fragmentuar me një pasuri relativisht të dobët të specieve dhe me faunë bentike të pasur (bregdeti lindor i gadishullit të Karaburunit), krahasuar me ato zona të shpërndara përgjatë bregdetit jugor shqiptar, ku kanë ndodhur më pak ndikime dhe më pak lëvizje modifikuese ujore dhe sedimentare. (Beqiraj et al., 2008; Pittito et al., 2009) Krahasimi midis livadhit të *Posidonia*-s dhe shtresës me baltë tregon se biodiversiteti ishte shumë më i ulët në komunitetet e shtresave me baltë, i cili më së shumti përfaqësohet nga anelidët *Glycera unicornis*, *Pseudoleio capitella fauveli*, dhe yjet e brishtë të detit *Amphiura chiajei* dhe *A. filiformis*, si dhe kishte disa mikroushqyes filtrues, siç janë briozoarët dhe sfungjerët.

Shndërrimi i habitateve ndodh edhe kur habitatet strukturalisht më komplekse shndërrohen në habitate më pak komplekse, të cilat kanë diversitet dhe produktivitet më të ulët (e.g., Beck et al., 2001; Heck and Crowder, 1991). Përveç kësaj, në këto kushte të degraduara, vendosja e **specieve të huaja oportuniste** (Galil, 2000; Occhipinti-Ambrogi, 2000) është e zakonshme dhe kjo ka ndodhur edhe në zonën e Vlorës, me specie të tilla si alga e gjelbër *Caulerpa racemosa* var. *cylindracea*, e cila mbulon pjesë të shtresës me baltë brenda Gjirit të Vlorës. Depozitimi i baltës

shkakton një gjendje paqëndrueshmërie të vazhdueshme në pjesën e poshtme, e cila nuk lejon vendosjen e biocenozave të mirëstrukturuara, por duket se mbështet vetëm speciet me një tolerancë të gjerë ekologjike (Currie dhe Parry, 1999; Leppa contróléekoski et al., 1999; Nicolaidou, Pancucci dhe Zenetos, 1989). **Të gjitha këto arsye tregojnë një rrënim të vazhdueshme në biocenozën bentike të Gjirit të Vlorës, veçanërisht kur krahasohet me gjetjet e studimeve të pakta të mëparshme.** Zhdukja e copëzave të barit të detit brenda një shtrati më të madh me *P. oceanica* dhe zëvendësimi i tij me një shtresë të gjerë balte janë një shembull i qartë i fragmentimit dhe degradimit të habitateve që, së bashku me uljen pasuese të biodiversitetit, përfaqëson një paralajmërim serioz për politikën e ardhshme të ruajtjes. Në fakt, degradimi i habitateve është një çështje serioze që ka implikime në ekosistem dhe shpesh shkakton humbje përfundimtare të habitateve natyrore (Airoldi dhe Beck, 2007).

Si ndikimet natyrore dhe ato njerëzore operojnë në ekosistemet bregdetare të brishta të Gjirit të Vlorës, ku dy forcues radioaktiv të fortë njihen si më përgjegjëse për degradimin e habitatit:

- prurjet e mëdha sedimentare që vijnë nga lumi i Vjosës;
- ndotja nga kanalizimet urbane të qytetit të Vlorës dhe rrethinat;
- nga zonat e thella të cilat vazhdimisht kontribuojnë në degradimin e cilësisë së ujit dhe rrënimin përkatës të ekosistemit.

Këto ndikime janë rritur gjatë viteve të fundit dhe në të ardhmen pritet një nivel më i lartë zhvillimi, gjë e cila mund të shkaktojë zhdukje në vlerën globale të shërbimeve të ekosistemit, e cila përlllogaritet të jetë 10 herë më e lartë se çdo ekosistem tokësor (Costanza et al., 1997). Kështu, shëndeti dhe ekuilibri i komuniteteve bentike të buta të Gjirit të Vlorës, si edhe evolucioni i tyre i ardhshëm janë në rrezik nga planet e ardhshme të veprimtarive njerëzore dhe nga sistemi i mundshëm i kontrollit për proceset natyrore më të prekura, si p.sh. transporti i sedimenteve të ngurta natyrore. Veprimtaritë e mëtejshme të pakontrolluara të ndërtimit përgjatë bregdetit mund të ndryshojnë sërish lëvizjet e ujit dhe sedimentimin me pasoja të pariparueshme në ekosistemet e përshkruara.

Në këtë kontekst, nevojitet një politikë serioze menaxhimi dhe nuk duhet të tolerohet asnjë vonesë. Këto analiza mund të përfaqësojnë një pikë nisjeje për kërkime të mëtejshme të rëndësishme në zonë, si dhe një sugjerim për politikën e parë të ruajtjes për zonën e parë detare të mbrojtur të propozuar në Shqipëri (Gadishulli Karaburun - Ishulli Sazan , bregdeti perëndimor).




Figura 6: Stacionet e kampionimit të bentosit gjatë punëve të mëparshme shkencore në gjirin e Vlorës (Maiorano et al., 2011).

3.6.2. KOMUNITETET BENTIKE të mureve shkëmbore nënujore

Tabani i Parkut Kombëtar Detar të Karaburun-Sazanit është kryesisht i përbërë nga substrate, habitate shkëmbore (shkëmbinj sublitoralë dhe shkëmbinj nënujorë koraligjenë), shpella dhe shtretër me bar deti (*Posidonia oceanica*, *Zostera noltii*) të cilët strehojnë disa lloje specimesh me interes ekologjik. Veçantia e shkëmbinjve sublitoralë të **bregut perëndimor** të Karaburunit është kolonizimi i rëndësishëm nga alga e tipit Sargassum dhe Cystoseira. Numri i tyre i lartë është një tregues i cilësisë së mirë të ujit dhe kontribuon në biodiversitetin e vërejtur në ujërat sublitoralë.

Prezenca e kolonive të briozoarëve të ngritura (*Reteporella* sp., *Myriapora truncata*, *Pentapora fascialis*, *Smittina cervicornis*, *Cellaria* sp.) në substratet e forta ka interes të veçantë.

Biokonstruktorët që mbulojnë zonat para-koralogjene dhe shkëmbinj të koraligjenë ndërthuren me sfungjerë dhe briozoarë të ngritur, të cilët janë veçanërisht të mirëzhvilluar në disa zona. Diversiteti i sfungjerëve është relativisht i lartë, veçanërisht kur rritet thellësia. Një e dhënë e rëndësishme e konfirmuar: nuk u vërejt asnjë gorgonie gjatë zhytjeve të zhvilluara, ndërsa krustacët ishin të pranishme, por jo në numra të mëdhenj. Megjithatë, për të gjitha zonat, diversiteti dhe pasuria e peshqve ishte shumë të ulët.

Përveç kësaj, prova të **mbikullotjes** së iriqëve të detit janë gjetur në shumicën e zonave shkëmbore në nivele mbi -20 metra. Kjo për shkak të ndotjes organike që favorizon zhvillimin e *Paracentrotus lividus* ose të mbipeshkimit të grabitqarëve teleosteanë.

Speciet invazive *Caulerpa cylindracea* dhe *Womersleyella setacea* kanë kolonizuar fundet shkëmbore mbi -30 metra dhe përbëjnë një shtresë të trashë.

Diversiteti i ulët biologjik dhe cilësia e degraduar e mjedisit në zonën e gjirit të Vlorës, duke përfshirë ZMD-në Karaburun-Sazan është theksuar gjithashtu në disa studime të mëparshme, pas ekspeditës detare WAITT (Beqiraj– komunikatë personale), Beqiraj et al. 2008, Beqiraj et al. 2012, Frascetti et al. 2011, Kasemi&Beqiraj 2006, Kasemi et al. 2008, Maiorano et al. 2011.

Ngritja e Parkut Detar Kombëtar të Karaburun-Sazanit përfshin disa habitate dhe specie që duhet të mbrohen nëpërmjet zbatimit të masave të menaxhimit, por pas referencave të përmendura më lart, situata aktuale e degraduar në këtë zonë është pasojë e veprimtarive të pakontrolluara, duke përfshirë peshkimin e paligjshëm, mbipeshkimin, ndotjen detare dhe bregdetare, erozionin në breg, akuakulturën, zhvillimet e pakontrolluara urbane dhe turistike, ndryshimet e regjimeve hidrologjike dhe sedimentologjike në Gjirin e Vlorës, ndikimet nga lumi i Vjosës, etj.

Përgjatë të gjithë kësaj pjese të **bregut perëndimor** të Gadishullit të Karaburunit janë të pranishme korëzime koraligjene që janë të ndërprera dhe krijojnë disa kavitete të vogla prej disa centimetrash. Komuniteti i shkëmbinjve nënujorë është i dominuar nga alga e purpurt *Peyssonnelia* sp. dhe sfungjerët, por u vërejtën dhe specie të tjera të grupeve të ndryshme në mënyrë sporadike: Scleractinians (*Madracis pharensis*), briozoaret e korëzuara (*Schizomavella mamillata*), briozoaret e ngritur (*Smittina cervicornis*, *Reteporella* sp.), ascidianët (*Aplidium* sp., *Halocynthiapapillosa*) si dhe janë të pranishëm dhe ekinodermë: kastravec i detit (*Holothuriatubulosa*), iriqët e detit (*Centrostephanus longispinus*) dhe yjet e detit (*Echinaster sepositus*, *Peltaster placenta*, *Coscinasteria tenuispina*). Sfungjerët janë të shumtë dhe përfaqësohen kryesisht nga *Clathrina clathrus*, *Chondrosia reniformis*, *Ircinia* sp., *Agela soroides*, *Cliona viridis*, *Phorbas tenacior*.

Ka gjithashtu një bollëk me alga të murrme (*Dictyota* sp., *Zanardinia typus*), ala të kuqe (*Mesophyllum* sp., *Lithophyllum* sp., *Peyssonelia* sp.), dhe alga të gjelbra (*Palmophyllum crassum*, *Caulerpa cylindracea*).

Ndryshimet në mjedisin detar dhe bashkësitë koraligjene lejojnë algat fotofilikë që të dominojnë në shkëmbinjtë sublitoralë. Ky habitat karakterizohet nga një diversitet i madh algash (alga e gjelbër: *Codium bursa*, *Caulerpa cylindracea*; alga e murrme: *Dictyota* sp., *Cystoseira corniculata*, *Cystoseira compressa*, *C. foeniculacea*, *Sargassum* sp., dhe shumë të tjera) dhe disa copëza me bar deti (*Posidonia oceanica*) kur tabani ndryshon nga shkëmbor në ranor.

Veçantia e shkëmbinjve sublitoralë është përqindja e lartë e sipërfaqes së tyre të kolonizuar nga alga e murrme e tipit *Cystoseira* dhe *Sargassum*. Algat e murrme shumëvjeçare po dominojnë substratet e forta të **bregut perëndimor** të Sazanit dhe Karaburunit. Tre *Cystoseira*-t e vëzhguara gjatë fushatës së mëparshme të monitorimit ishin: *Cystoseira compressa*, *Cystoseira corniculata* and *Cystoseira foeniculacea*. Komunitetet e *Cystoseira*-s dhe livadhet me (*Posidonia oceanica*) strehojnë një biodiversitet të madh në ujërat sublitorale.

Gjiri i Kepit strehon shumë ascidianë (*Rhopalaea neapolitana*), gastropodë (*Bursatella leachii*), krimba detarë (*Hermodice carunculata*) dhe ekinodremë: kastravec i detit (*Holothuriopsis*), ylli i detit (*Marthasterias glacialis* dhe *Echinaster sepositus*), dhe iriqët e detit (*Sphaerechinus granularis*). Gastropodët *Bursatella leachii* vërejtën të izoluar ose në grupe individuale, si në substratin e butë ashtu dhe në mbetjet-makro ose shkëmbinjtë e izoluar. Në këtë pjesë të gjirit u gjet një tjetër gastropod: *Tylodina perversa*. Në këtë gjiri të vogël është e mundur që të shihen shumë pak peshq, kryesisht kernë (*Serranus scabrilla*), krimba deti (*Hermodice carunculata*) dhe ekinodermë (*Holothuria* sp.). Në këtë zonë dhe në zona të tjera zhytjeje në gjiri janë gjetur mbetje të shumta arkeologjike, si dhe makro-mbetje.

Këtu *Posidonia* është vërtet e rrallë dhe livadhi ka pak kapacitete për ripërtëritje spontane. Ai duhet të hartëzohet në mënyrë të saktë dhe të shqyrtohet në mënyrë që të krahasohet me të dhënat e mëparshme.

Për shqyrtim

Ekosistemi i mbyllur brenda gjirit të Vlorës paraqitet si një mozaik kompleks me habitate, shumë prej të cilëve ndikohen si nga presioni njerëzor, si nga veprimtaritë e njeriut. Përgjatë bregdeteve të Zonës së Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan ekzistojnë mjedise me vlerë të lartë natyrore, site të rëndësishme të arkeologjisë nënujore dhe rrënoja të shumta të Luftërave Botërore. Zona e Mbrojtur Detare ka qenë aktive që prej vitit 2010, por nuk ka punime të detajuara që përshkruajnë plotësisht florën, faunën nënujore dhe karakteristikat kimiko-fizike.

Me kalimin e kohës kanë përfunduar disa punë kërkimore, të cilat kanë qenë shumë të dobishme për të pasur një panoramë të përgjithshme të mjedisit.

Planet e monitorimit dhe vlerësimit janë të domosdoshme për të ditur se çfarë po menaxhohet e mbrohet dhe si zhvillohen tani burimet në bazë të presionit në rritje të turizmit.

Përfitimet që rrjedhin nga menaxhimi modern i zonave të mbrojtura detare, si për shembull, të ardhurat ekonomike dhe promovimi, si ai turistik dhe ai i specifik, mund të arrihen pasi të jetë vendosur menaxhimi i Zonës së Mbrojtur Detare, i cili bazohet në monitorimin dhe promovimin shkencor të veprimtarive turistike dhe në metodat e edukimit eko-miqësor.

Zona e Mbrojtur Detare e Karaburun-Sazanit është një thesar i vërtetë nënujor, me vlerë natyrore të barabartë me bukurinë e tokave përreth: menaxhimi më i mirë i zonës dhe i ZMD-së, do të bëjë të mundur krijimin e një sistemi të qëndrueshëm ekonomik dhe shkencor, i cili shpresojmë të shtojë Zonat e ardhshme të Mbrojtura Detare, të cilat janë identifikuar tashmë përgjatë bregdetit të bukur shqiptar.

Figurat 7-17: Shembuj të komuniteteve bentike të mureve shkëmbore nënujore të Karaburun-Sazanit, brenda dhe jashtë gjirit (fotot nga Dr. S. Modugno, Misioni i UNDP, mars 2019).






Figura 18-21: Livadhe Posidonia të dëmtuara në gjirin e Vlorës, pranë zonave të akuakulturës (fotot nga Dr. S. Modugno, Misioni i UNDP-së, mars 2019).



3.7. CILËSIA E UJIT DHE SEDIMENTEVE

Gjiri i Vlorës është një nga zonat më tërheqëse bregdetare të Shqipërisë, e përcaktuar si një zonë me prioritet të lartë për turizmin. Ai paraqet kushte shumë të përshtatshme për të akomoduar anije të llojeve të ndryshme. Aktivitetet njerëzore rreth Gjirit të Vlorës dhe zonave portuale shkaktojnë ndotje të konsiderueshme të ujit. Ujërat e ndotura industriale dhe rrjedhat e ujërave urbane janë burimet tradicionale të ndotjes së kësaj zone, si dhe prania e një impianti industrial si TEC-i dhe Petrolifera. Dy portet kryesore, Porti Tregtar dhe Portet e Peshkimit që janë të pozicionuara në gji, i nënshtrohen ndotësve të ndryshëm dhe të mundshëm, d.m.th kundërndotësit e varkave dhe anijeve, pastrimi i trupit të varkës, naftë apo derdhje të tjera dhe shkarkime nga varka, shkarkime të ujërave të ndotura nga bashkia dhe nga objekte industriale etj.

3.7.1. TREGUESIT E BAKTEREVE FEKALE

Qarku i Vlorës, si një nga plazhet më të vizituara në Shqipëri dhe në të njëjtën kohë, si një nga vendet e identifikuar si një pikë e nxehtë për ndotjen. Të dhënat dhe rezultatet përfundimtare të fushatës së mëparshme monitoruese për cilësinë e ujërave të detit, si dhe për të vlerësuar rolin e ndryshimeve sezonale të parametrave mjedisorë, janë tregues për dinamikën e baktereve fekale. Numri dhe lloji i popullatave bakteriale në një komunitet ujor përcaktohen pjesërisht nga karakteristikat fizike dhe kimike të trupit ujor. Një nga faktorët mjedisorë që ka një ndikim të fortë mbi organizmat është temperatura. Gjatë periudhës së hetimit, temperatura varioonte nga 11,6°C në mars deri në 23,7°C në kohën e verës. Ndryshimet e temperaturave ishin rezultat i kushteve klimatike dhe sezonale. **Bakteret koliforme përdoren gjerësisht si tregues të ndotjes fekale të ujërave të ëmbla dhe detare.**

Në shumë studime të mëparshme u përdorën dy parametra për ndotjen e fekaleve: përqendrimi i baktereve totale koliforme dhe prania e *Streptococcus fecalis*. Në figurën më poshtë paraqiten ndryshimet sezonale të përqendrimeve totale koliforme, të matura me metodën MPN. Gjatë vitit 2015, numri më i lartë i baktereve totale koliforme është regjistruar në qershor dhe korrik.




Figura 22: Dinamikat e baktereve koliforme totale në vitet 2015 dhe 2016 (A. Bakai et al, 2017).

Ky rezultat është i zakonshëm gjatë sezonit për shkak të temperaturës së lartë të ujit, por edhe në disa stacione, një burim i ndodjes së ujërave të detit janë edhe shkarkimet e ujërave të ndotura të patrajtuara në det.




Figura 23: Dinamikat e parametrave të cilësisë së ujit (koliformet dhe temperatura e ujit) gjatë periudhës mars – shtator 2015 (A. Bakai et al., 2017).

Të dhënat tregojnë se në përgjithësi numri i baktereve totale koliforme ishte më i ulët gjatë periudhës së hetimit prej 2016 krahasuar me vitin 2015, përveç gushtit. Ky muaj regjistron vlerat më të larta të baktereve totale koliforme për të dy vitet në shumicën e stacioneve të kampionimit. Kjo mund të ndodhë si pasojë e numrit të madh të njerëzve që vizitojnë plazhet në këtë vijë bregdetare gjatë periudhës së verës.

Përqendrimi i lartë i baktereve fekale lidhet me temperaturat e larta. Krahasimi i këtyre parametrave është shumë i rëndësishëm për përcaktimin e cilësisë së ujit (Fig. 23-24).

Të dhënat e paraqitura konfirmojnë fenomenet e njohura ekologjike që konsistojnë në bashkëpunimin e faktorëve biotikë dhe abiotikë të mjedisit që ndikojnë në jetën, dinamikën dhe shpërndarjen e mikroorganizmave në ujëra.




Figura 24: Dinamikat e parametrave të cilësisë së ujit (koliformet dhe temperatura e ujit) gjatë periudhës mars – shtator 2016 (A. Bakai et al., 2017).




Figura 25: Përqindja e stacioneve të kampionimit ku streptococci fekal ishte i pranishëm në vitet 2015 dhe 2016. (A. Bakai et al., 2017).

Prania **streptococci** fekal ishte një tjetër parametër për përcaktimin e ndotjes fekale të ujit të detit.

Prania e këtyre baktereve në ujë mund të jetë me origjinë njerëzore ose shtazore. Në studimin tonë, ne kemi bërë një vlerësim cilësor dhe jo sasior, për këto baktere në ujërat e detit.



Figura 26: Hartat e stacioneve të kampionimit në gjirin e Vlorës (S. Kane et al., 2016).

Gjatë vitit 2016 të periudhës së hetimit, është vërejtur një rritje e numrit të stacioneve të kampionimit ku streptococci fekal ka qenë i pranishëm.

Ky studim tregon se uji i detit përgjatë bregdetit të Vlorës është nën ndikim të lartë antropogjenik. Ujërat e ndotura nga vendbanimet që ndodhen në ujëndarëse, veçanërisht në breg, kanë të qartë ndikim njerëzor në cilësinë e ujit. Përveç kësaj, është vërejtur një përmirësim në cilësinë e ujërave të Vlorës. Nëse kjo është tendencë, është shumë e rëndësishme për njerëzit që e vizitojnë këtë zonë gjatë periudhës së verës. Megjithatë, ka ende shumë punë për t'i bërë të sigurt për t'u larë ujërat e kësaj zone.

3.7.2. UJI

Vlora, me rreth 100 000 banorë, ndodhet në Gjirin e Vlorës, i cili konsiderohet si kufiri ndërmjet detit Adriatik dhe Jon. Ishulli i Sazanit është pozicionuar në hyrje të Gjirit të Vlorës duke shkaktuar kushte të pafavorshme për qarkullimin e ujit ndërmjet gjirit dhe detit të hapur. Distanca e Gjirit të Vlorës nga Italia është 70 milje detare. Kodrat përreth qytetit janë kultivuar me ullishta. Gjiri i Vlorës paraqet kushte shumë të përshtatshme për të akomoduar anije të llojeve të ndryshme. Dy nga portet më të rëndësishme të qytetit të Vlorës janë Porti Tregtar dhe Porti i Peshkimit (Triport). Aktiviteti portual mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në cilësinë e ujit dhe rrjedhimisht në jetën detare dhe ekosistemet, si dhe në shëndetin e njeriut. Porti tregtar i Vlorës është porti i dytë për nga rëndësia (pas portit të Durrësit), për kapacitetin e rëndë dhe porti më i madh i Shqipërisë së Jugut që shërben për transportin e mallrave dhe të pasagjerëve. Madhësia e portit është shumë e vogël (me porta të llojit bregdetar) dhe madhësia maksimale e anijes arrin deri në 500m gjatësi. Thellësia e ujit varion nga 4,9 - 6,1 m në bankinën e ankorimit, 9,4 - 10 m në kanalën dhe terminalin e naftës dhe 17,1 - 18,2 m në vendin e lidhjes së spirancave. Për nga tiparet është një port i hapur që përbëhet nga dy mole kryesore, që pret mjete lundrimi të tilla si anijet e ngarkesave dhe tragetet. Kryma dhe luhajtje të forta, që mund të dëmtojë veglat e lundrimit nuk ka, kështu garantohet një ankorim i sigurt pranë tij pa qenë e nevojshme të përdoret sistemi i vinçave ngritës, si dhe është një vend që mbron anijet falë pozicionit gjeografik. Porti i peshkimit i njohur si “Triporti” ndodhet në veri-perëndim të Portit tregtar të Vlorës. Ky port përdoret kryesisht për ankorimin e anijeve të peshkimit.

Për të vlerësuar cilësinë e ujit të gjirit të Vlorës, kampionët e ujit u shqyrtuan në katërmbëdhjetë stacione kampionimi (duke përfshirë Portin tregtar dhe të peshkimit, gjirin e Vlorës dhe lagunën e Nartës dhe Orikumit) dhe u vendosën parametrat fiziko-kimikë të ujit, si p.sh. temperatura, pH-i, oksigjeni i tretur (DO), kërkesa biokimike e oksigjenit (BOD), lënda e grimtuar imët (TSS dhe TDS), lëndët ushqyese (N-NO₂ -, N-NO₃ -, N-NH₄ +, P-PO₄ 3-). **Në bazë të rezultateve të parametrave fiziko-kimikë dhe të përmbajtjes së lëndëve ushqyese në zonat e studiuara, u zbulua se përmbajtja e lëndëve ushqyese ishte në përqendrimet më të larta dy portet krahasuar me gjirin, por ato ishin në nivelet e lejuara të cilësisë së ujërave detare.**

Parametrat fiziko-kimikë të ujit të detit (përveç TSS-së) janë brenda niveleve të lejuara. Për shkak të motit me shi gjatë kohës së kampionimit, në Gjirin e Vlorës u gjet një përmbajtje shumë e lartë e TSS-së. Përmbajtja e lëndëve ushqyese ishte brenda kufijve të lejuar nga Direktiva e KE-së 78/659/KEE. U gjet përmbajtje e lartë ushqyese në stacionet e pozicionuara në portin tregtar dhe të peshkimit. Burimet mund të jenë mbetje urbane të shkarkuara nga zona përreth, ujëra të zeza të patrajtuara të shkarkuara nga anijet dhe vlera të larta të temperaturës. Bazuar në përmbajtjen e lëndëve ushqyese, uji i detit në të dy portet dhe në gjirin e Vlorës është oligotrofik. Aktiviteti i vogël portual, për shkak të madhësisë së vogël të të dy porteve ka pak ndikim në cilësinë e ujit. Përmbajtje relativisht e lartë e lëndëve ushqyese në porte është një tregues i faktorëve të ndotjes, që kanë nevojë për monitorim të vazhdueshëm të parametrave fizikë dhe kimikë për të mbajtur nën kontroll cilësinë e ujit të gjirit. Për shkak të veprimtarive të vazhdueshme antropogjenike rreth zonës dhe shkarkimeve të papërshtatshme të mbetjeve të naftës apo mbetjeve të tjera të ngurta dhe të lëngshme nga anijet e ankoruara në këto porte, situata paraqitet më e keqe veçanërisht gjatë periudhës së verës me temperaturë më të lartë dhe aktivitet të lartë turistik.

Diagramet në (Figura 27, 28) paraqesin parametrat fiziko-kimikë të ujërave në portet tregtare dhe të peshkimit dhe në zona të tjera të gjirit të Vlorës.




Figura 27: a) pH, temperatura, c) oksigjeni i tretur, përmbajtja e kërkesës së oksigjenit biologjik në ujin e portit tregtar dhe të Peshkimit, si dhe në zona të tjera të gjirit të Vlorës.




Figura 28: a) përcjellshmëria, b) kripësia, c) TSS, c) përmbajtja e TDS-së në ujërat e portit tregtar dhe të peshkimit dhe të zonave të tjera në gjirin e Vlorës.

pH

pH-i i ekosistemeve ujore varet nga aktiviteti kimik dhe biologjik i ujërave. Ndryshimet në pH mund të tregojnë praninë e ndotësve industrialë, fotosintezën ose frymëmarrjen e algave që po ushqehen me ndotësit. Pjesa më e madhe e ekosistemeve janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve në pH dhe monitorimi i tij është përfshirë në ligjet mjedisore të vendeve më të industrializuara. Siç mund të shohim (Figura 2/a), vlerat e pH-it luhatën midis 7,72 - 8,26 përkatësisht në stacionin St. 1

(laguna e Nartës) dhe në stacionin St. 14 (stacioni referencë, Orikum). Të gjithë kampionët e ujit rezultojnë me vlera të ulëta në pH krahasuar me kampionin referencë për shkak të mbetjeve urbane dhe qarkullimit të kufizuar të ujit.

Temperatura

Temperatura e ujit është treguesi më i mirë i luhatjeve sezonale. Ai ndikohet nga faktorë të ndryshëm, përfshirë kushtet e motit, heqjen e bimësisë në brigjet e rrjedhave dhe ujërat e shiut. Siç mund të pritej, temperatura në ujërat sipërfaqësore në dy portet dhe në zonat e tjera të studimit të gjirit të Vlorës pati luhatje midis 19,9 deri në 22,5°C me një vlerë mesatare prej 21,3°C, që është normale për periudhën e procesit të kampionimit (gjatë muajit maj).

Oksigjen i tretur

Oksigjeni i tretur (DO) është një parametër i rëndësishëm mjedisor i nevojshëm për një cilësi të mirë të ujërave sipërfaqësore. Në përgjithësi, ato disponohen si gjendje e tretur në trupat ujorë. Luhatjet në nivelet oksigjenit të tretur në ujë mund të shkaktohen nga bimësia ujore dhe statusi antropogjenik i ujit. Tashmë dihet se temperatura dhe kripësia ndikojnë në shpërbërjen e oksigjenit në ujë. DO-ja në ujë vjen nga shpërbërja e ajrit dhe nga procesi i fotosintezës që ndodh gjatë ditës. Në temperatura të larta, e cila zakonisht vëzhgohet në stinën e thatë, tretshmëria e oksigjenit zvogëlohet ndërsa në temperaturë të ulët (stina e lagësht), rritet.

Siç mund të shihet nga (Figura 2c), sasia e DO-së në ujërat e dy porteve dhe në zonat e tjera të rrethuara në gjirin e Vlorës varion nga 6,92-11,10 mg/L, me një vlerë mesatare 8,7 mg/L. Përmbajtja e DO-së në kampionët e ujit të mbledhur në dy portet rezultoi më ulët (veçanërisht në stacionin 6 në portin tregtar të Vlorës), krahasuar me përmbajtjen e DO-së në kampionët e mbledhur në vendet e tjera të gjirit të Vlorës ose në kampionin referencë të mbledhur në Orikum.

Kërkesa e oksigjenit biologjik

Përcaktimi i Kërkesës Biologjike për Oksigjen (BOD) tregoi se përqendrimi më i lartë (0,82 mg/l) është gjetur në stacionin 6 (Porti Tregtar) dhe vlera më e ulët ishte (0,11 mg/l) në stacionin 14 (stacioni referencë, Orikum) (Figura 2/d) me vlerë mesatare 0,48 mg/L. Nivelet e BOD-së shërbejnë si tregues të ndotjes organike të ujit; sa më e lartë BOD-ja, aq më e lartë sasia e ndotjes në kampionin e testit. Një mjedis detar që paraqet nivele të larta të BOD-së nuk është i përshtatshëm për jetën e specieve që kanë nevojë për oksigjen.

Potenciali Redoks

Potenciali Redoks është aktiviteti ose fortësia e proceseve të oksido/reduktimit në tretësirë dhe vlera e tij varion nga -82,4 mV në -37,2 mV (Tabela 1). Vlerat negative të potencialit redoks në të gjitha stacionet tregojnë vetitë e pakëta të ujërave të detit.

Përcjellshmëria, TDS-ja, TSS-ja dhe kripësia

Përcjellshmëria, TDS-ja dhe kripësia u gjetën në nivele më të larta në stacionin 1 (laguna e Nartës) dhe 14 (kampioni referencë, Orikum). Vlerat e ulëta të këtyre parametrave u gjetën në stacionin 13, i pozicionuar në pjesën juglindore të lagunës së Orikumit (pranë kishës së Marmiroit), fare pranë një burimi uji të ëmbël në fund të lagunës. Përzierja e ujit të lagunës me ujin e ëmbël në këtë stacion shkakton uljen e kripësisë, përcjellshmërisë elektrike dhe të parametrave të tjerë fiziko-kimikë. Përcjellshmëria varion nga 29,7 mS/cm (stacioni 13) në 69,3 mS/cm (stacioni 1). Luhatjet në përcjellshmërinë elektrike varen nga luhatjet e TDS-së. Përcjellshmëria në ujë ndikohet nga prania e lëndëve të ngurta inorganike të tretura, si kloruri, nitrati, sulfati dhe anionet e fosfatit (jone që kanë ngarkesë negative) ose natriumi, magnezi, kalciumi, hekuri dhe kationet e aluminit (jone që kanë ngarkesë pozitive). Teksa përqendrimi i kripërave në ujë rritet, rritet edhe përcjellshmëria elektrike.

Kripësia është matja e përbërjes jonike të ujit dhe ndryshon në varësi të përzierjes së ujërave tokësorë thuajse të pastra me ujërat e kripura detare. Në kampionët e ujit nga dy portet dhe nga zona të tjera të gjirit të Vlorës, vlerat e kripësisë luhaten në një shkallë ndërmjet 15,1-46,8% me një vlerë mesatare prej 37,54%. U konstatua që kripësia ishte më e ulët në stacionin 13 (pranë kishës së Marmiorit) për shkak të përzierjes së ujërave të ëmbla me ato të kripura.

Totali i mbetjeve të ngurta (TS) i referohet çdo lëndë të mbetur pezull ose të tretur në ujë. Përqendrimet e larta të TSS-ve kanë disa efekte negative, si p.sh. reduktimin e dritës që mund të depërtojë ujin, duke ngadalësuar kështu proceset fotosintetike, të cilat nga ana e tyre mund ta ulin prodhimin e oksigjenit të tretur; përthithjen e lartë të nxehtësisë nga drita e diellit, duke rritur kështu temperaturën që mund të rezultojë në nivel të ulët oksigjeni. Përmbajtja TSS luhaten nga një vlerë minimale prej 29,7 mg/L në stacionin 6 dhe një vlerë maksimale prej 41,6 mg/L në stacionin 1. Përmbajtja e TSS-së në ujërat portuale rezultoi pak më e ulët në krahasim me zonat e tjera në gjirin e Vlorës. Përqendrimi i TDS-së rezultoi në nivel më të ulët në stacion 13 (23,6 g/L) dhe në nivel më të lartë në stacionin 1 (55,04 g/L).

Përmbajtja e lëndëve ushqyese

Përshkrimi (Figura 4) i përmbajtjes së lëndëve ushqyese (nitrite, nitrate dhe fosfate) në gjirin e Vlorës dhe në dy laguna (Narta dhe Orikumi), si dhe në dy portet, porti tregtare dhe ai i peshkimit. Përqendrimet e *Nitrates (N-NO₃-)* në të gjitha kampionet e mbledhura nga dy portet dhe zonat e tjera të gjirit të Vlorës varionin nga 0,018 në 0,181 mg/l. Për shkak të mbetjeve urbane të patrajtuara të shkarkuara në det. (veçanërisht pranë portës ankoruese të portit Tregtar, kur mbetjet urbane të patrajtuara të zonës së Skelës shkarkohen nëpërmjet një grumbulluesi direkt në det), përmbajtja e nitrateve në të dy portet ishte më e lartë krahasuar me kampionet e ujit që u mblodhën në gjirin dhe në laguna. Përmbajtja e lartë e nitrateve në ujin e detit nuk është shqetësuese, pasi ato janë lëndët ushqyese kryesore për biotën ujore dhe zhvillimi i saj intensiv shkakton reduktim të shpejtë të nitrateve.

Nitritet (N-NO₂-) në ujërat detare gjenden si përbërës të ndërmjetëm që përftohen nga reduktimi mikrobial i nitrateve dhe/ose oksidimi i amonit. Një burim tjetër i mundshëm i nitriteve mund të jetë fitoplanktoni dhe shkarkimet e ujërave të ndotura. Niveli i përqendrimit të nitriteve varion nga 0,004 në 0,014 mg/l. Sipas Direktivës së KE-së “Për peshqit” 2006/44/KE, vlerat e rekomanduara për nitritet janë <0,03 mg/l (ujërat ciprinide) që janë më të larta se niveli maksimal i nitriteve të gjendura në Gjirin e Vlorës.

Amoni (N-NH₄⁺) mund të konsiderohet si një tregues i besueshëm i shkarkimeve të ujërave të zeza dhe mbetjeve të lëngshme të bagëtive. Përmbajtja e amonit u gjet në nivelet ndërmjet 0,019-0,132 mg/L. Nivele më të larta u gjetën në stacionin 10 (porti tregtar), duke qenë se pranë këtij stacioni, mbetjet urbane të patrajtuara shkarkohen përmes një grumbulluesi direkt në det.

Fosfatet (P-PO₄³⁻): Pothuajse i gjithë fosfori (P) i pranishëm në ujë është në formën e fosfatit (P-PO₄³⁻), i cili është një lëndë ushqyese kryesore për bimët dhe stimulon rritjen e tyre (algave). Është i ditur roli i tyre për rritjen e produktivitetit ujor. Nivelet e larta të fosfatit dhe nitratit mund të çojnë në eutrofikim, i cili përshpejton rritjen e algave dhe përfundimisht pakëson nivelet e oksigjenit të tretur në ujë. Fosfatet në të dy portet u gjetën me përmbajtje të lartë (0,010 deri në 0,016 mg/L) krahasuar me zonat e tjera rrethuese në gjirin e Vlorës. Vlera mesatare ishte 0,009 mg/L (Figura 4), më e ulët se udhëzuesi i KE-së (≤ 0.4 mg/L për ujërat e ciprinide).

Komente

Gjiri i Vlorës paraqet kushte shumë të përshtatshme për të akomoduar anije të llojeve të ndryshme. **Parametrat fiziko-kimikë të ujit të detit (përveç TSS-së) u gjetën brenda niveleve të lejuara.** Për shkak të motit me shi gjatë kohës së kampionimit, në Gjirin e Vlorës u gjet një përmbajtje shumë e lartë e TSS-së.

Përmbajtja e lëndëve ushqyese ishte brenda kufijve të lejuar nga Direktiva e KE-së 78/659/KEE. U gjet përmbajtje e lartë ushqyese në stacionet e pozicionuara në portin tregtar dhe të peshkimit. Burimet mund të jenë mbetje urbane të shkarkuara nga zona përreth, ujëra të zeza të patrajtuara të shkarkuara nga anijet dhe vlera të larta të temperaturës.


Bazuar në përmbajtjen e lëndëve ushqyese, uji i detit në të dy portet dhe në gjirin e Vlorës është oligotrofik. Aktiviteti i vogël portual, për shkak të madhësisë së vogël të të dy porteve ka pak ndikim në cilësinë e ujit.

Përmbajtje relativisht e lartë e lëndëve ushqyese në porte është një tregues i faktorëve të ndotjes, që kanë nevojë për monitorim të vazhdueshëm të parametrave fizikë dhe kimikë për të mbajtur nën kontroll cilësinë e ujit të gjirit. Për shkak të veprimtarive të vazhdueshme antropogjenike rreth zonës dhe shkarkimeve të papërshtatshme të mbetjeve të naftës apo mbetjeve të tjera të ngurta dhe të lëngshme nga anijet e ankoruara në këto porte, situata paraqitet më e keqe veçanërisht gjatë periudhës së verës me temperaturë më të lartë dhe aktivitet të lartë turistik.

	pH	E	T	TSS	TDS	DO	BOD	Cond.	Sal.	N-NO ₃ ⁻	N-NO ₂ ⁻	N-NH ₄ ⁺	P-PO ₄ ³⁻
Mean	8.07	-64.19	21.30	33.13	43.23	8.70	0.48	53.29	37.54	0.106	0.008	0.063	0.009
Median	8.09	-65.35	21.40	32.30	45.41	8.42	0.65	56.30	40.15	0.123	0.007	0.061	0.009
Standard Deviation	0.15	11.46	0.72	3.18	7.13	1.32	0.29	9.47	9.13	0.077	0.003	0.034	0.005
CV%	2	-18	3	10	16	15	60	18	24	73	38	54	52
Kurtosis	0.78	1.56	-0.18	2.99	4.37	-1.09	-2.09	2.70	3.41	-2.25	0.54	-0.50	-2.04
Skewness	-1.01	1.03	-0.36	1.63	-1.57	0.24	-0.27	-1.28	-2.09	-0.08	0.84	0.48	0.09
Range	0.54	45.20	2.60	11.90	31.44	4.18	0.71	39.60	31.70	0.163	0.010	0.113	0.011
Minimum	7.72	-82.40	19.90	29.70	23.60	6.92	0.11	29.70	15.10	0.018	0.004	0.019	0.004
Maximum	8.26	-37.20	22.50	41.60	55.04	11.10	0.82	69.30	46.80	0.181	0.014	0.132	0.015
Count	14	14	14	14	14	14	14	14	14	14	14	14	14

Tabela 8: Të dhënat statistikore të parametrave fiziko-kimike dhe lëndëve ushqyese.

Figura 29: Përmbajtja e lëndëve ushqyese në portin tregtar dhe të peshkimit dhe në zonat e tjera të gjirit të Vlorës.



3.7.3. EUTROFIKIMI

Njohja e karakteristikave strukturore dhe funksionale të komuniteteve të mikroalgave është thelbësore për vlerësimin e pasojave ekologjike të veprimtarive të njeriut për gjendjen trofike të ekosistemeve detare. Ndërmjet kushteve mjedisore dhe komuniteteve të planktoneve janë vërejtur marrëdhënie strikte; për shembull, komunitetet fitoplanktonike reagojnë ndaj ndryshimeve në karakteristikat fizike dhe kimike të mjedisit të tyre duke ndryshuar përbërjen taksonomike dhe strukturën e madhësisë (Platt et al., 2005). Në zonat bregdetare, këto lidhje janë edhe më të dukshme për shkak të ndryshueshmërisë ekstreme të parametrave fizikë dhe kimikë dhe ndikimeve të veprimtarive njerëzore, si urbanizimi dhe turizmi. Në zona, si rajonet bregdetare të Shqipërisë, të cilat u nënshtrohen ndryshimeve drastike social-ekonomike, dhe për pasojë, një shfrytëzimi në rritje dhe të pakontrolluar të ekosistemeve ujore (Munari et al., 2010), vlerësimi i strukturës dhe i produktivitetit të bashkësisë së fitoplanktoneve është një çështje thelbësore. Megjithatë, këto vlerësime në lidhje me ujërat bregdetare shqiptare janë relativisht të pamjaftueshme (Mangoni, Saggiomo dhe Santarpia, 2003; Rubino et al., 2009; Saracino dhe Rubino, 2006). Gjiri i Vlorës, në Shqipëri, është një vend i mirë për të kryer këto vlerësime sepse është një gji gjysmë i mbyllur me një qytet industrial me popullsi të dendur, Vlora (Cullaj, Lazo dhe Baraj, 2004; Cullaj et al., 2005). Gjiri është i lidhur me detin Adriatik nga një hyrje e cekët (thellësi 40-m) dhe është në jug të grykës së lumit të Vjosës, ujërat e të cilit kalojnë në Lagunen e Nartës për në Gji (Pano et al., 2006) (Figura 1). Përveç kësaj, gjiri ka interes të madh për industrinë e peshkimit në Shqipëri, duke qenë se ai shërben si një fidanishte natyrore për shumë specie peshqish që kanë rëndësi ekonomike. Nuk disponohen të dhëna për bashkësitë e fitoplanktoneve dhe prodhimtarinë në gjirin e Vlorës, kështu që ishte e nevojshme të zhvillohej ky studim, si pjesë e Projektit Evropian CISM (INTERREG IIIA Itali–Shqipëri), i cili ka si qëllim prodhimin e një përshkrimi të detajuar të ekosistemit të gjirit të Vlorës. Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i strukturës dhe prodhimtarisë së bashkësive të fitoplanktonit në gjirin e Vlorës për të vlerësuar karakteristikat trofike të gjirit në shkallë të vogla kohore dhe hapësinore. Në veçanti, biomasa e zvogëluar, përbërja kimiko-taksonomike, dhe prodhimi parësor i zvogëluar në përmasa po diskutohen në lidhje me kushtet mjedisore fizike dhe kimike të gjirit.




Figura 30: Stacionet e kampionimit, stacione biologjike ku janë kryer kampionime gjatë CISM_1 (pranverë 2007) dhe CISM_2 (dimër 2008); ciklet, stacionet biologjike ku janë kryer kampionime gjatë CISM_1 (pranverë 2007); profilet peskëndësh dhe CTD.

Gjiri i Vlorës, për shkak të pozicionit të tij juglindor në detin Adriatik, ndikohet nga grykëderdhja e lumit Vjosa dhe nga ujërat që vijnë nga Mesdheu lindor, një nga zonat më oligotrofike të oqeanëve të botës (Allen, Blackford dhe Radford, 1998; Relevante dhe Gilmartin, 1995). Temperaturat shumë të ndryshueshme dhe vlerat e kripësisë të vërejtura gjatë pranverës theksuan **kompleksitetin e hidrologjisë** së gjirit i cili vjen për shkak të **morfologjisë** së tabanit dhe të ndikimit të rrëshqitjeve të tokës. Thellësitë e cekëta në kanale që lidhin detin e hapur Adriatik me gjirin reduktojnë shkëmbimin e ujërave nënujore (<40 m) me pjesën jugore të detit Adriatik. Ky faktor ka një ndikim të madh në ekologjinë e ekosistemit bregdetar të gjirit. Ujërat e hapura të pjesës jugore të Adriatikut patën një rëndësi të lartë në shtresën sipërfaqësore të pjesës perëndimore të gjirit, ndërsa ndikimi i rrëshqitjes së tokës ishte i rëndësishëm në pjesën lindore. Si pasojë, është vënë re një gradient i kripës L-P në të dy sezonet. Kanë ndodhur gjatë dimrit, pavarësisht përzierjes vertikale të kolonës së ujit.

Gjatë pranverës, **biomasa e fitoplanktoneve** tregoi një vlerë mesatare me 0.25 mg m⁻³ (një shkallë që është tipike në zonat oligotrofike; p.sh., Li et al., 1983; Yacobi et al., 1995), dhe një DCM në fund të stacioneve më të thella (>40 m). Shpërndarja hapësinore sipërfaqësore e biomasës së fitoplanktoneve dhe e prodhimit parësor tregoi një gradient të qartë L-P, me përqendrime më të larta përgjatë bregdetit lindor, duke theksuar kështu rolin e prurjeve tokësore nga qyteti i Vlorës dhe nga laguna e Nartas. Këto shpërndarje ishin në përputhje me temperaturën dhe gradientin e kripës.

Gjithashtu, përqendrimet e ulëta të **PO₄** dhe **NO₃**, të cilat shpesh janë afër ose nën kufirin e zbulimit, treguan një gjendje shterimi të lëndëve ushqyese. Ky shterim i lëndëve ushqyese sugjeron se lundrimi ynë pranveror ndodhi pas lulëzimit të algave. Kjo hipotezë konfirmohet pjesërisht nga përqendrimet relativisht të larta të feopigmentit dhe **NH₄**-ës që janë tregues të plakjes dhe veprimtarisë së kullotjes. Megjithatë, nuk mund të përjashtohet se përqendrimet e **NH₄**-ës kanë ndodhur, të paktën pjesërisht, për shkak të prurjeve tokësore, siç sugjerohet nga përqendrimet relativisht të larta të **SiO₄**.

Në dimër, shpërndarja vertikale e **Chl_a** ka ndodhur kryesisht për shkak të dinamikave të kolonës së ujit.

Biomatat e fitoplanktoneve u shpërndanë në mënyrë të njëtrajtshme përgjatë kolonës së ujit, për shkak të karakteristikave izopiknale të kolonës. Kjo lloj shpërndarjeje është tipike për shpërndarjen e fitoplanktoneve të dimrit në det të hapur dhe me gjerësi gjeografike të moderuar. Është interesante të vihet re se norma e prodhimit parësor ishte më e ulët në dimër sesa në pranverë, edhe pse përqendrimi i klorofilit ishte më i lartë në dimër. Duhet përjashtuar fakti se këto norma të ulëta të prodhimit parësor ndodhën për shkak të kufizimit të lëndëve ushqyese, duke qenë se (a) përqendrimi mesatar i **NO₃**-it ishte më i lartë në dimër se në pranverë dhe (b) përqendrimet mesatare të **PO₄**-s dhe **SiO₄**-s ishin të njëjta në të dyja stinët. Mund të hamendësohet se normat e ulëta të prodhimit parësor gjatë dimrit ishin për shkak të ditëve më të shkurtra dhe për shkak të rrezatimit të pakët. Në fakt, në dimër, drita mesatare e disponueshme gjatë inkubimit ishte 300 mmol fotone m⁻² s⁻¹ në sipërfaqe dhe bie me shpejtësi në shtresat e thella (me 15 m thellësi, ajo tashmë ishte ulur në 50 mmol fotons m⁻² s⁻¹).

Të dhënat e këtij studimi janë të dhënat e para të disponueshme në lidhje me shkallën e prodhimit parësor në gjirin e Vlorës.

Në pranverë të vitit 2007 dhe në dimër të vitit 2008, gjiri i Vlorës karakterizohej nga kushte përgjithësisht oligotrofike dhe procese tejet të ndryshueshme të prodhimit parësor.

Ndikimi i ujërave të hapura të jugut të detit Adriatik në trofizimin e gjirit ishte i papërfillshëm, ndërsa ndikimi i prurjeve tokësore ishte shumë i theksuar. Shpërndarja e biomasës në sipërfaqe tregonte qartësisht rolin e shkarkimeve tokësore nga bregu lindor në nxitjen e proceseve të prodhimit parësor. Gjiri ishte ndarë në dy seksione përgjatë një drejtimi JG-VP: vlerat më të ulëta të biomasës së fitoplanktoneve dhe të prodhimit janë regjistruar në zonën e perëndimore.

Gjendja trofike u nxit nga kushte hidrodinamike lokale, prurje të lëndëve ushqyese tokësore dhe cikle biogjeokimike që ishin të gjitha të kufizuara kryesisht brenda gjirit.

Figura 31: profilet vertikale të temperaturës (a, c) dhe kripësisë (b, d) përkatësisht në pranverë dhe në dimër.

et

al., 2011).




Figura 32: Shpërndarja hapësinore e klorofilit a (mg m²³) në sipërfaqe dhe në shtresën e fundme në pranverë (a, b) dhe në dimër (c, d) (O. Mangoni viti? T al. 2011?)





Figura 33: Shpërndarje hapësinore e prodhimit parësor mesatar të integruar (mg C m²³ d²¹), (a) në burim dhe (b)



3.8. EKOTOKSIKOLOGJIA

Në gjirin e Vlorës janë kryer disa studime të integruara ekotoksikologjike, bazuar në bioakumulimin dhe reagimet e treguesve biologjikë tek iriqët e detit, molusqet dhe peshqit në gjirin e Vlorës. Pavarësisht disa veprimtarive industriale të mëparshme dhe rritjes aktuale të ndikimit antropogjenik që karakterizon Gjirin e Vlorës, **nuk janë publikuar të dhëna ekotoksikologjike** deri më tani, duke theksuar nevojën për studim të zonës dhe për të miratuar qasjen ekotoksikologjike.

Metalet e rënda, hidrokarburet aromatike policiklike (PAH-të), pesticidet organo-klorinë (OC), dhe bifenilet e poliklorinuara (PCB-të) janë matur nëpërmjet iriqit vendas të detit *Arbacia lixula*, Mediterranean mussel (*Mytilus galloprovincialis*), dhe qefullit të kuq (*Mullus barbatus*). U studiuan disa tregues biologjik, si aktivizimi i proteinave të tensionit (HSP-70) në iriqët e detit (PCR), veprimtaria e enzimave të detoksifikimit dhe apoptoza në molusqe dhe veprimtaria e enzimës acetilkolinesterase (AChE) tek molusqet dhe qefulli i kuq.

Në përgjithësi, të dhënat ekotoksikologjike sugjerojnë cilësi mjedisore në gjirin e Vlorës, që i ngjan një zonë të mbrojtur detare, me përjashtim të niveleve të Cd, Ni dhe Hg në midhjet dhe gonadet e qefullit të kuq; këto rezultate janë në dakordësi me veprimtaritë e mëparshme industriale. U konstatua se pesticidet OC ishin nën kufirin e zbulimit të iriqët e detit. Nivelet e PCB-ve ishin shumë të ulëta (4,13–13,87 ngg 21 peshë e lagur) si të midhjet, ashtu edhe të peshqit, ndërsa PAH-et ishin të ngjashme me ato të raportuara për zonat me ndikim mesatar.

Nuk u dallua ekspozim ndaj pesticideve neurotoksike (veprimtaritë psikologjike AChE) ose ndaj ndotësve citotoksikë (shpeshtësia e apoptozës e ulët: 1%) deduktohet si të midhjet, edhe të peshqit. Veprimtaritë e enzimave të detoksifikimit në midhje ishin shumë të ngjashme krahasuar me ato të raportuara në zonat me ndikim të ulët. **Rezultatet e studimeve ekotoksikologjike në gjirin e Vlorës mbështesin gjithashtu përshtatshmërinë e tij në vlerësimin e cilësisë së mjedisit të zonave bregdetare detare.**

Mungesa e niveleve të dallueshme të pesticideve OC të kampionët e iriqëve të detit nga gjiri i Vlorës mund të sugjerojë një nivel të ulët ndotjeje në ujërat bregdetare detare. Vlerat e PCB-ve të zbuluara të midhjet ishin të ngjashme me ato të raportuara për zonat me ndikim të ulët në një studim të mëparshëm përgjatë bregdetit Apulian të Adriatikut (diapazoni 2.5–15.8 ngg 21 w.w.) (Corsi et al., 2002). Në fakt, nivelet e larta të PCB-ve janë raportuar të midhjet e mbledhura përgjatë bregdeteve mesdhetare në zona më të ndotura, si portet dhe zonat bregdetare (Bodin et al., 2004; Porte dhe Albaigé's, 1993) Po ashtu, nivelet e PCB-ve në gonadet e kampionëve të qefullit të kuq ishin shumë më të ulëta sesa ato të raportuara për speciet e tjera të peshqve në zonat bregdetare mesdhetare (Mariottini, 2003).

Për sa i përket niveleve PAH të midhjet, nga krahasimi me zonat e tjera bregdetare mesdhetare, ato treguan vlera veçanërisht të ulëta, të ngjashme me ato të raportuara për zonat me ndotje të ulët. Vlerat nga studimet e mëparshme përfshijnë: zonat me ndikim të ulët ,0,5–148 ngg 21 w.w., sipas Iosifidou, Kililidis dhe Kamarianos (1982), Pancirov dhe Brown (1977),

Rainio, Linko, dhe Ruotsiia (1986), dhe Takatsuki et al. (1985); zona me ndotje të moderuara 295–580 ngg 21 w.w., nga Amodio-Cocchieri, Arnese dhe Minicucci (1990) dhe Amodio-Cocchieri et al. (1993); dhe zona shumë të ndikuara 534–2785 ngg 21 w.w., nga Bjorseth, Knutzen, and Skei (1979) dhe Kveseth, Sortland dhe Bokn (1982). Sërish, ato që u maten në gonadet e qefullit të kuq ishin shumë më të ulëta sesa ato të raportuara në indet me yndyrë të ulët, si p.sh. filetot e qefullit të kuq dhe specie të tjera peshku përgjatë detit Adriatik (Corsi et al., 2002; Perugini et al., 2007). Në

molusqet nga gjiri i Vlorës u vunë re nivele shumë më të larta të metaleve të rënda. Nivelet më të larta të metaleve të rënda të përzgjedhura në molusqet e V1 mund të lidhen me praninë e shkarkimeve me origjinë industriale dhe urbane ku qyteti i Vlorës dhe impianti i prodhimit të sodës ndodhen. Më pak i qartë është origjina e niveleve më të larta të As dhe Cd në molusqet nga V2: Një shpjegim i mundshëm mund të jetë prania e shkarkimeve bujqësore në lidhje me veprimtaritë e brendshme. Në përgjithësi, të dhënat për metalet e rënda duken të ngjashme me zonat e tjera me ndikim të ulët, duke përfshirë Detin Adriatik (Kljaković-Gaspic' et al., 2006; Lavilla et al., 2006; Martella, Nelli, and Bargagli, 1997; Orescanin et al., 2006), përveç Cr, Ni, dhe në veçanti Hg. Cr dhe Ni mund të lidhen me karakteristika të veçanta litologjike të brendshme, por edhe me aktivitetet minerare, rafinerinë dhe veprimtari të tjera industriale përgjatë bregdeteve të gjirit të Vlorës. Tashmë është raportuar ndotja e madhe me Hg në gjirin e Vlorës për shkak të pranisë së industrisë së prodhimit të sodës nga viti 1978 deri në vitin 1992: Për shkak të metodës elektrolitike me bazë Hg, në gji është shkarkuar një sasi e madhe Hg, e cila pasqyrohet nga nivelet e larta të zbuluara në sedimentet detare (Celo et al., 1999; MWH Consulting, 2003) Mungesa e ndryshimeve të konsiderueshme në nivelet e Cr, Ni dhe Hg te molusqet nga të dy zonat (V1 dhe V2) sugjeron një zgjerim të ndotjes në gji. Së fundmi, nivelet më të larta të metaleve të rënda të regjistruara në gonadet e qefullit të kuq në zonën A1m që ndodhet në gji, krahasuar me zonën A2 (Deti Adriatik) rezultuan në jenë në të njëjtën pikë me një ndotje të metaleve të rënda brenda gjirit nga e moderuar deri në të lartë.

Për këtë arsye, mungesa e brezave për gjenet e zgjedhura Hsp-1, Hsp-2, dhe Hsp-3 në kampionët e iriqëve të detit sugjeron se mund të mos jenë specifike për llojet dhe se nevojiten studime të mëtejshme. Që kur u vërtetua prezenca e HSP-70 në coelomocitë e iriqëve të detit, ndoshta përdorimi i të gjitha indeve të buta në këtë studim mund të ketë holluar RNA-në e disponueshme (Matranga et al., 2000), duke reduktuar kështu aftësinë e zbulimit të çdo gjeni.

Prania e veprimtarive fiziologjike AChE, si në verzat e molusqeve ashtu dhe te truri i qefullit të kuq (Mora, Fournier, and Narbonne, 1999; Mora, Michel, and Narbonne, 1999) sugjeron ekspozim të ulët ose zero ndaj ndotësve neurotoksikë të biotës ujore të gjirit të Vlorës. Në veçanti, aktivitetet AChE të matura në trurin e qefullit të kuq janë të ngjashme me ato të vëzhguara më parë për të njëjtat specie në zonat e mbrojtura detare në Detin Adriatik të Jugut (Corsi et al., 2002; Lionetto et al., 2003).

Për sa i përket kapacitetit detoksifikues të molusqeve në gjirin e Vlorës, rezultatet e veprimtarisë së fazës I dhe II ishin veçanërisht të ulëta krahasuar me ato të raportuara për zonat e tjera të gjireve atlantike dhe mesdhetare (Livingstone et al., 1995; livingstone and Farrar, 1984). Në veçanti, vetëm veprimtaritë GST ishin shumë të krahasueshme me ato të raportuara nga Bebianno et al. (2007) përgjatë bregdetit portugez dhe Argese et al. (2004) në lagunën e Venicias. Së fundmi, shpeshtësia e ulët e apoptozës së vërejtur te haemocitet e molusqeve sugjeron një gjendje përgjithësisht të mirë shëndetësore të qelizave dhe asnjë rrezik për shkak të ekspozimit ndaj përbërësve citotoksikë. Frekuenca të ngjashme janë raportuar për molusqet nga brigjet kroate (Bihari et al., 2003) dhe për organizmat e paekspozuar (Matozzo, Tomei dhe Marin, 2005).

Studimi ekotoksikologjik i kryer në biotën e gjirit të Vlorës tregoi se PAH-të, PCB-të dhe metalet e rënda janë grumbulluar në përqendrime të ulëta deri në mesatare te organizmat përgjatë gjirit, duke pasqyruar situatën e një zone me ndotje të ulët. Mungesa e efekteve të konsiderueshme biologjike (shënues biologjike) në tre llojet e treguesve biologjike konfirmon përgjithësisht një gjendje të mirë shëndetësore të biotës detare të gjirit të Vlorës. Kjo qasje e integruar duke kombinuar bioakumulimin dhe reagimet e shënuesve biologjike ka një potencial të mirë për vlerësimin e vlerësimit mendor të një zone bregdetare dhe duket se është qasja më e përshtatshme për ndotjen e

ardhshme dhe monitorimin e stresit mendor-mjedisor. Studimi i parë për gjirin e Vlorës prodhoi të dhëna të rëndësishme që mund të përdoren si bazë për programet e ardhshme të monitorimit që lidhen me akumulimin dhe efektet e ndotjes organike dhe inorganike përgjatë brigjeve kontinentale të Shqipërisë.

Studime të tjera ekotoksikologjike të kryera në biotën e gjirit të Vlorës tregojnë se PAH-të, PCB-të dhe metalet e rënda janë grumbulluar në përqendrimet e ulëta deri në mesatare të organizmat në të gjithë gjirin, duke pasqyruar situatën e një zone me ndotje të ulët. Mungesa e efekteve të konsiderueshme biologjike (shënues biologjikë) në tre speciet indikator biologjike konfirmon një gjendje përgjithësisht të mirë shëndetësore nga biota e Gjirit të Vlorës. Kjo qasje e integruar duke kombinuar bioakumulimin dhe reagimet e shënuesve biologjikë ka një potencial të mirë për vlerësimin mjedisor të një zone bregdetare detare dhe duket se është qasja më e përshtatshme për ndotjen e ardhshme dhe monitorimin e stresit mjedisor. Studimet e “Ecotox” në Gjirin e Vlorës gjeneruan të dhëna të rëndësishme që mund të përdoren si bazë për programet e ardhshme të monitorimit që lidhen me grumbullimin dhe efektet, si organike, ashtu edhe të atyre inorganike.

Në tabelat 9 (1, 2 dhe 3) paraqiten rezultatet e analizës së merkurit, plumbit dhe kadmiumit në organizmat që janë përdorur si bioindikatorë të ndotjes nga metalet e rënda, gjatë periudhës 1990-1993 dhe 2002-2007.

Table 1. Hg content at different zones expressed in µg/kg wet weight.

Kind of products	Durrës		Vlorë		Sarandë	
	1990-1993	2002-2007	1990-1993	2002-2007	1990-1993	2002-2007
<i>Mytilus galloprovincialis</i>	18.3±3.8	17.9±2.6	77.4±5.6	68.3±9.6	43.7±7.2	45.6±6.5
<i>Mullus barbatus</i>	88.8±7.1	86.2±4.2	172.3±4.8	125.2± 5.9	50.5±6.5	48.7±4.6
<i>Sardina pilcardus</i>	78.8±2.9	76.3±6.5	131.4±8.5	132.1±8.8	82.5±11.3	79.2±3.7
<i>Trachurus trachurus</i>	59.8±3.7	61.4±3.8	52.4±6.9	50.3±7.9	54.7±3.5	55.1±4.4

Table 2. Pb content at different zones expressed in µg/kg wet weight.

Kind of products	Vlorë		Sarandë	
	1990-1993	2002-2007	1990-1993	2002-2007
<i>Mytilus galloprovincialis</i>	502.1±20.3	493.2±16.1	424.8±26.9	454.4±75.6
<i>Mullus barbatus</i>	420±93.5	479±12.2	-	-
<i>Trachurus trachurus</i>	30.5±8.5	33.9±10.4	29.9±8.6	28.5±9.4

Table 3. Cd content at different zones expressed in µg/kg wet weight.

Kind of products	Vlorë		Sarandë	
	1990-1993	2002-2007	1990-1993	2002-2007
<i>Mytilus galloprovincialis</i>	531.2±20.6	489±18.5	420.4 ± 12.9	415.6 ± 20.8
<i>Mullus barbatus</i>	523.3±14.1	495.8±13.5	-	-
<i>Trachurus trachurus</i>	23.8-3.8	25.4±5.9	24.8 ± 7.5	22.5 ± 5.2

Ndotja e detit nga metalet është më pak e dukshme dhe e drejtpërdrejtë se llojet e tjera të ndotjes detare, por efektet e saj në ekosistemet detare dhe te njerëzit janë shumë të thella dhe shumë të

gjera. Efektet toksike të metaleve të rënda, në veçanti të arsenikut, merkurit, kadmiumit dhe plumbit, janë studiuar gjerësisht (Inskipand & Piotrowsiki, 1985; Kurieshy and D'siliva, 1993; Narvaes, 2002; Nishihara, Shimato, Wen & Kondo, 1985).

Tashmë është raportuar ndotja e rëndë prej metaleve në gjirin e Vlorës për shkak të pranisë së industrisë së prodhimit të sodës nga viti 1978 deri në vitin 1992: Për shkak të metodës elektrolitike me bazë Hg, në gji është shkarkuar një sasi e madhe Hg, e cila pasqyrohet nga nivelet e larta të zbuluara në sedimentet detare (Celo et al., 1999; MWH Consulting, 2003)

Ndotjet metalike në produkte ushqimore, veçanërisht në produktet detare, janë studiuar gjerësisht (Catsiki & Stroglyoudi, 1999; Enomoto & Uchida, 1973; Liang, Cheung, & Wong, 1999; Uysal, 1980; Uysal, 1990). Toni, si grabitqar, është në gjendje të përqendrojë sasi të mëdha metalesh të rënda. Disa prej tyre përdoren për monitorimin biologjik të ndotjes së mjedisit (Schmitt & Brumbaugh, 1990). Sipas rezultateve të përfuara, nivelet e merkurit në kampionët e peshqve dhe midhjeve nga të gjitha zonat e kampionimit janë gjetur nën nivelet e lejueshme (FAO, 1976; FDA, 2000; FDA, 2001)

Përqendrimet e merkurit, plumbit dhe kadmiumit në *Mytilus galloprovincialis* nga bregu i detit Adriatik dhe Jon janë të, 11,2 – 77,6, 380,4 – 545,1 dhe 434,8 – 560,9 µg/kg në peshë të lagur, përkatësisht, dhe janë të ngjashme me rezultatet e paraqitura në literaturë (Voegborlo, El-Methnani, & Abedin, 1999; Maanan 2007, appellat dhe Alakavuk 2011, YILMAZ 2003, Besada, 2002)

Në përgjithësi, të dhënat për metalet e rënda ngjasojnë me zonat e tjera me ndikim të ulët, duke përfshirë Detin Adriatik (Kljakovic - Gas'pic' et al., 2006; Lavilla et al., 2006; Martella, Nelli, and Bargagli, 1997; Orescanin et al., 2006)

Nivelet mesatare të përqendrimit të merkurit që gjenden në *Mytilus galloprovincialis* varionin nga 18,3 në mg/kg peshë e lagur në zonën e Durrësit në 77,4 në mg/kg peshë e lagur në Vlorë në periudhën 1990-1993, ndërsa për periudhën 2002-2007 nivelet lëviznin nga 17,9 µg/kg në 68.3 mg/kg. Në molusqet nga gjiri i Vlorës u vunë re nivele shumë më të larta të metaleve të rënda.

Shpërndarja e metaleve varion mes specieve të peshqve, në varësi të moshës, statusit të zhvillimit dhe faktorëve të tjerë fiziologjikë (Kagi & Schaffer, 1998). Peshqit akumulojnë përqendrime të konsiderueshme të merkurit në indet e tyre dhe kështu mund të përbëjnë një burim të madh dietik të këtij elementi për njerëzit. Peshqit janë burimet e vetme më të mëdha të merkurit dhe arsenikut për njeriun. Merkuri është një substancë e njohur toksike për njerëzit dhe burimet kryesore të ndotjes e njeriut nga merkuri janë përmes konsumimit të peshqve. Biotransformimi i merkurit dhe i formimi i metilit të merkurit përbën një problem serioz për shëndetin e njeriut (Inskip&Piotrowsiki, 1985).

Rezultatet e marra për peshkun *Mullus barbatus* dhe *Trachurus trachurus* kanë treguar se përqendrimi mesatar i merkurit varion nga 88,8 mg/kg në zonën e Durrësit në 172,3 mg/kg në zonën e Vlorës, ku ndodhej impianti sodës klorine. Gjatë periudhës kohore të viteve 2002- 2007 rezultatet e përfuara për *Mullus barbatus* lëviznin nga 86,2–125,2 µg/kg, ndërsa për *Trachurus trachurus* nivelet e merkurit lëviznin midis 50,3–61,4 mg/kg peshë e lagur. Analiza statistikore e rezultateve nga ANOVA nuk treguan dallime të rëndësishme në të gjithë kampionët dhe periudhat e mbledhjes së kampionëve. Përqendrimi i plumbit të regjistruar në të gjitha zonat varionte nga 360,6 deri në 550,2 mg/kg për *Mullus barbatus* dhe për *Trachurus trachurus* 19.3-45.2 µg/kg.

Nivelet e elementëve toksikë në krustacët lidhen me moshën, gjininë, sezonin dhe vendin (Kagi & Schaffer, 1998). Është raportuar gjithashtu se gatimi redukton sasinë e disa metaleve (Atta, El-Sebaie, Noaman & Kassab, 1997).

Ka disa të dhëna krahasuese nga të njëjtat fusha (Storelli, 2000; Orescanin 2006; por duket se rrugët ujore në Shqipëri janë më pak të ndotura sesa rrugët ujore të vendeve të industrializuara.


3.8.1. SEDIMENTE

Gjiri i Vlorës, i Nartës dhe i Orikumit, si dhe derdhja e lumit Vjosë janë zonat e zgjedhura për studimet e monitorimit ekotoksikologjik në sedimentet e tabanit.

Gjithashtu, disa nga metalet thelbësore ndahen me shpejtësi nga lënda grimcore në trupin ujqor, i cili rrjedhimisht vendoset si sediment në taban. Për rrjedhojë, përcaktimi i këtyre elementëve në sedimente mund të luajë një rol kyç në zbulimin e burimeve të ndotjes. Megjithëse analiza e sedimenteve nuk përfaqëson shkallën e ndotjes, ato mund të përdoren për studime krahasuese mbi baza gjysmë-sasiore për të gjurmuar burimet e ndotjes, si p.sh. shkarkimet e tepërta nga industritë në afërsi. Elementët e gjurmëve në ujërat e detit mund të jenë faktorë kufizues të prodhimit biologjik, gjurmues të qarkullimit oqeanik dhe të proceseve biogjeokimike, si dhe të materialeve gjurmuese për pale-oqeanografinë. Mbikëqyrja e zonës turistike bregdetare në qarkun e Vlorës, e mjedisit detar dhe e vlerësimit bazuar mbi studimin e mëparshëm, kanë dhënë informacione paraprake rreth vendndodhjes së materialit që do të analizohet në zonën bregdetare të Vlorës.

Kampionimi në gjirin e Vlorës, në hyrje të vijës bregdetare, 100, 300 dhe 700 m nga bregu. Kampionimi në lagunën e Nartës dhe Orikumit dhe në kanalet grumbullues midis lagunave dhe detit dhe në kanalet e shkarkimit, për të parë nivelin aktual të metaleve të rënda toksike dhe variacionit të niveleve të metaleve të rënda toksike në këto zona duke iu referuar studimit të mëparshëm. Kampionimi në grykëderdhjen e lumit Vjosë në 3 stacione, 1 tek grykëderdhja dhe 2 përgjatë lumit për të parë ndryshimet në praninë e metaleve të rënda në vende të ndryshme. Kampionët e sedimenteve detare janë mbledhur në dy stinë: në fund të stinës verore në zonën më të aksesueshme për publikun dhe në vjeshtën e vonë.

Figura 34: Harta e stacionit të kampionimit të sedimenteve (I. sino et al, 2011-2013, tezë doktrature).



3.8.2. PLANKTONI

Zooplanktonët e gjirit të Vlorës përfaqësohen nga 94 kategori (Tab. II). Ka qenë i dominuar nga kopepodët (43) dhe tintinidët (16) me speciet e Oitonës që përbëjnë 50% të numrit total. Meroplankton përfaqësohet nga 24 kategori. Të gjitha speciet nga kjo zonë raportohen për herë të parë dhe të gjitha raportohen në Jug të detit Adriatik, me përjashtimet e vetme të *Tintinnina Acanthostomella conicoides*. Kjo zonë rezultoi me shumë variacion, pasi vetëm 22 kategori (23%) ishin të kudondodhura (ato u gjetën në të 7 stacionet) Ky rezultat pak a shumë mbahet edhe nëse stacioni 7 (stacioni i vetëm i jashtëm në gji) nuk do të merrej në konsideratë (kategoritë e kudondodhura, duke konsideruar vetëm ato në gji, shkojnë në 30) Në këto kategori përfaqësuese ne gjetëm 5 specie Copepoda (sipas radhës së shpeshësisë: *Oithonana*, *Centropageskroyeri*, *Isiasclavipes*, *Euterpinaacutifrons*, *Temorastylifera*), 2 Cladocera (*Evadnespinifera*, *E. Nordmanni*), dhe 2 Tintinnina (*Eutintinnusfraknoi*, *Tintinnopsislindenii*). Kategoritë ekskluzive (zakonisht vetëm një stacion) ishin 27, ku 7 prej tyre ishin në stacionin 6, i cili rezultoi me më shumë karakteristika. Copepoda Acartiidae (6 kategori), *Euterpina acutifrons* (nauplii dhe copepodids) dhe *Paracalanus copepodids*, komponentët tipikë të mjedisve gjysmë të mbyllur bregdetare mungonin komplet në pjesën e jashtme të stacionit 7 (në kanalën e Otrantos) Vezët dhe larva e specieve të peshqve tregtarë ishin të përfaqësuara mirë, duke dëshmuar rolin e mundshëm të këtij gjiri si fidanishte. Njëkohësisht është konstatuar bashkëjetesa e *Centropages kroyeri* me peshkun *Engraulis encrasicolus* (vezë dhe larva), që mund të jenë shumë me interes: duket se në zonat mesdhetare, peshqit kërkojnë për prezencën e copepodëve, për të zgjedhur si vendin dhe kohën e hedhjes së vezëve, me shumë gjasë sepse copepodët janë baza fillestare ushqimore e fazave të para të zhvillimit të peshqve (MAHJOUR et al., 2005). Gjiri i Vlorës mund të jetë një vend ideal për studimin e këtyre ndërveprimeve ekologjike. Mes 94 kategorive të regjistruara, treguesit ekologjikë të izolimit para hedhjes së vezëve (speciet të cilat preferojnë zonat e mbyllura dhe/ose karakterizohen nga madhësia më e vogël dhe numrat e tyre të lartë) u konstatuan në stacionet 1, 2 dhe 6, të cilët gjithashtu shfaqën vlerat më të larta të densitetit të popullimit. Në veçanti, copepodët e specieve *Paracartia latisetosa* (zakonisht në ujërat e kufizuara) janë gjetur në sasi të mëdha në stacionin 6, për këtë arsye mund të konsiderohet zona më e kufizuar midis atyre që janë studiuar. Analiza statistikore tregoi stacionet e gjirit të grupuara së bashku dhe veçmas nga stacioni i vetëm i jashtëm (i 7-ti) (Fig. xx).

Në gji, zooplanktonet e stacioneve të studiuara treguan edhe tre situata të tjera që mund të interpretohen si:

- pozicione të kufizuara, me bregdet ranor (stacionet 1 2 3);
- pozicione të kufizuara, me bregdet me gurë (stacionet 4,6);
- pelagjike (stacioni 5).

Edhe nëse krahasimi statistikor nuk mbështetet nga një numër i mjaftueshëm përsëritjesh për zonë (si në hapësirë ashtu dhe në kohë), ne mund të konsiderojmë kampionët e zooplanktoneve të marrë nëpërmjet rrjetave tërheqëse si përfaqësues të sakta të situatës në çdo zonë. Për këtë arsye, ne jemi të sigurt që studimi na dha treguesit e saktë për të organizuar një plan kampionimi, për të ardhmen, i cili do të marrë në konsideratë diversitetin e mundshëm (dhe mbase evident) hapësinor-funksional të gjirit.

Lista e zooplanktoneve jepet në shtojca.




Figura 35:
Shpërndarja e stacioneve të kampionimit (treguar me numra nga 1 deri në 7) në zonën e studiuar (Moscatello dhe Belmonte, 2006).

3.9. CILËSIA E EKOSISTEMIT

Cilësia e ekosistemit i referohet specieve dhe ekosistemeve me rëndësi në detin Mesdhe, si dhe specieve jo vendase ose invazive.

Speciet e rralla, të rrezikuara dhe të kërcënuara

ZMD-K-V strehon një sërë speciesh të faunës të rralla, të rrezikuara ose kërcënuara në rang global, rajonal si dhe kombëtar. Të paktën 36 specie detare, të cilat përbëjnë një shqetësim ndërkombëtar dhe bëjnë pjesë në listën e specieve të rrezikuara ose/dhe të mbrojtura nga ana e disa konventave, janë të pranishme në zonën e Sazan-Karaburunit. Ato përfshijnë barin e detit, algat e detit, sfungjerët, knidarianët, molusqet, krustacët, ekinodermët, peshqit, reptilët, pinipedët dhe cetacetët.

Në shkallë kombëtare, rreth 75% e specieve të rrezikuara të kafshëve detare, sidomos makro-jovertebrorët bentikë, të cilët bëjnë pjesë në Librin e Kuq të Faunës Shqiptarë (2006) dhe Lista e Kuqe e Faunës Shqiptare (2007), janë regjistruar në zonën e Sazan-Karaburunit

Ruajtja e këtyre specieve të rrezikuara është një detyrim ndërkombëtar dhe një nga prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Biodiversitetin dhe të Planit të Veprimit. Speciet dhe biocenoza më e rëndësishme dhe më e ndjeshme në zonën Gadishullit Karaburun - Ishullit Sazan janë:

- foka mesdhetare (*Monachus monachus*),
- Delfini i shkurtër turishkurtër (*Delphinus delphis*),
- Breshka kokëtrashë (*Caretta caretta*),
- Korali i kuq (*Corallium rubrum*),
- Midhja hurmë (*Lithophaga lithophaga*),
- Kerni i Errët (*Epinephelus marginatus*),
- Ylli i detit (*Ophidiaster ophidianus*),
- Biocenoza koraligjene,
- Biocenoza e livadheve *Posidonia Oceanica*,
- Biocenoza që dominohet nga algat *Lithophyllum byssoides* (*Lithophyllum byssoides*),
- Biocenoza e algave infralitorale komunitet *Cystoseira*.

Foka mesdhetare (*Monachus monachus*) është një vizitor shumë i rrallë dhe rastësor në ujërat bregdetare të Shqipërisë.

Kanionet dhe shpellat e zonës, shpesh të paarrtshme, përfaqësojnë një habitat ideal për fokat mesdhetare, të cilat janë raportuar në gadishullin e Karaburunit në vitin 1982 dhe ishullin e Sazanit në vitin 1991 (Beudels dhe Vangeluwe, 1994).

Prova të qarta të pranisë së fokës mesdhetare janë gjetur në disa shpella, p.sh shenja mbi rërë që i korrespondojnë një trupi të madh, si dhe jashtëqitje (Antolović J. et al., 2005).

Mesa duket shpellat përgjatë vijës bregdetare në Shqipëri, veçanërisht ato të bregut perëndimor të Gadishullit Karaburun mund të shërbejnë si një urë për një ripopullim të mundshëm nga ana e fokave mesdhetare në të ardhmen në brigjet veriore dhe qendrore të Detit Adriatik, ose si streha të rëndësishme për shtimin e popullsisë “vendase” të fokave mesdhetare.

Speciet e huaja dhe invazive

Speciet e huaja invazive janë një nga problemet më të mëdha me të cilat përballet biodiversiteti sot në shkallë globale. Në sisteme të buta detare, speciet invazive janë shkaqe të mirë-dokumentuara të prishjes së komunitetit detar. Në Vlorë ekziston një liman i rëndësishëm në të cilin vijnë në mënyrë të rregullt anije nga ujërat rajonale dhe ndërkombëtarë. Speciet e huaja që vijnë në këtë port mund të shpërndahen në ujërat pranë tyre. Speciet e huaja të faunës detare gjithashtu përdoren në kulturën detare në pjesë të ndryshme të Mesdheut.

Një kërcënim i mundshëm për biodiversitetin detar është ai ispecieve invazive *Caulerpa racemosa* var. *cylindracea* që janë të shpërndara gjerësisht në basenin Mesdhetar, duke përfshirë bregun shqiptar të detit Jon. Vitet e fundit janë regjistruar edhe në gjirin e Vlorës dhe në pjesën lindore të gadishullit të Karaburunit (Kashta et al., 2005). Siç raportohet nga një sërë biologësh detarë, kjo specie invazive po ul vlerat e biodiversitetit të ujërave detare të pushtuara.

Kohët e fundit është parë gaforrja blu Amerikane (*Callinectes sapidus*) e cila është një specie e huaj e pangopur, pa grabitqarë të njohur dhe me ritme të larta riprodhimi dhe mbijetese, të cilat tashmë janë përhapur në Mesdhe.

4. SEKSIONI 4. Zonat e ruajtjes (natyrore dhe kulturore)

Zonat e ruajtjes në zonën e Vlorës përfshijnë kategoritë e mëposhtme: parqet kombëtare, rezervat natyrore, peizazhet e mbrojtura, ligatinat bregdetare dhe zonat e mbrojtura detare (ZMD).

Laguna e Nartës

Laguna e Nartës është një ligatinë me interes sipas Konventës “Ramsar” dhe është klasifikuar si një zonë e rëndësishme zogjsh (ZRZ) nga “Birdlife International” dhe si një zonë e rëndësishme bimore (ZRB) sipas BNRN. Zona është ligatina më e madhe e vendit, e cila mbulon më shumë se 4000 hektarë dhe një pjesë e saj përdoret ende për prodhimin e kripës. Ajo është pjesë e grykëderdhjes së lumit Vjosa dhe ndahet me detin nga një dunë e ngushtë bregdetare. Gjatë 15 viteve të fundit, grykëderdhja është gërryer nga deti dhe lokalisht vija e bregut ka lëvizuar prapa me një ritëm prej 10 m në vit, ka një rrezik të madh të hyrjes së ujit gjatë stuhive ose tsunamive të vogla, pasi është një zonë sizmike. Lumi i Vjosës dhe laguna e Nartës janë deklaruar si një peizazh i mbrojtur në nivel kombëtar.

Laguna përfshin dy ishuj, më i madhi që mbulohet nga një pyll pishe, ku ndodhet dhe manastiri i Zvërnecit (shekulli i 13-të), nga i cili ka marrë dhe emrin ishulli. Ishulli lidhet me tokën nëpërmjet një ure. Në atë zonë mund të ecet dhe të vëzhgohen zogj. Në dimër, në varësi të vitit, nga 40 deri në 50 000 zogj mund të shihen në zonë.

Laguna e Orikumit

Laguna e Orikumit është një ligatinë e ndarë nga deti me anë të një plazhi ranor me guralecë, 10 km në jug të Vlorës, në pjesën jugore të gjirit të Vlorës.

Parku Kombëtar i Llogarasë

Parku Kombëtar i Llogarasë ndodhet rreth 10 km larg fshatit Orikum, në një lartësi rreth 1000 m, me një jetë e egër të pasur, duke përfshirë specie me rëndësi, si p.sh. dreri, dhelpra, derri i egër.

Orikumi

Qyteti i lashtë i Orikumit është themeluar në shekullin e 7-të ose të 6-të para Krishtit dhe përfshin një qendër urbane, me amfiteatër me rreth 400 vende, por një pjesë e qytetit tashmë është nën sedimentin e lagunës së Orikumit.

Porti i Pasha Limanit

Baza ushtarake e Pasha Limanit ndodhet në perëndim të lagunës. Porti konsiderohet si porti më i vjetër shqiptar dhe vendndodhja e tij e bën atë një strehë shumë të mbrojtur, të padukshme nga Adriatiku.

Kisha Bizantine e Marmiroit

Kisha Bizantine e Marmiroit, e cila ndodhet 2 km në perëndim të Orikumit, besohet se është ndërtuar para shekullit të 8 pas Krishtit. Kisha akoma ka afreske interesante, murale, një narteks dhe shfaq një strukturë arkitekturore unike me 3 hyrje, një formë kryqi dhe një kube e ngritur mbi një çati të lartë cilindrike.

Parku Kombëtar i Sazan-Karaburunit

Parku Kombëtar i Sazan-Karaburunit dhe zona detare e mbrojtur, e përcaktuar në vitin 2010, mbulon 125 km², duke përfshirë Gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit, si dhe një pjesë të madhe të ujërave detare përreth. Parku kombëtar është një zonë e rëndësishme shpendësh dhe një

zonë e rëndësishme bimësh, dhe pas deklaramit të tij, është pranuar si një Zonë e Mbrojtur e Rëndësishë së Veçantë Mesdhetare nën autoritetin e Konventës së Barcelonës.

Gjiri i Gramës

Në anën perëndimore të Gadishullit, me një hyrje të vështirë nga toka, por të lehtë nga deti, Gjiri i Gramës dhe plazhi i tij me guralecë është pjesërisht i mbrojtur nga formacione masive gëlqerore të cilat shfrytëzohen për ndërtim që prej kohëve greke dhe romake. Anijet e shumta janë strehuar këtu gjatë stuhive jugore dhe nëpër shkëmbinj janë gdhendur mbishkrimi në disa gjuhë, duke përfshirë greqishten e lashtë dhe latinishten.

Karakteristikat natyrore në tokë (peizazhi tokësor) dhe në det (peizazhi detar): pyje, shkurre, shkëmbinj të lartë, shpella dhe kanione në tokë dhe nën ujë, janë të shumta në këtë zonë, duke përfshirë edhe anijet e mbytura në det.

Siç përcaktohet nga CBD-ja, zona e Vlorës në det përfshin Masa të tjera efektive të Ruajtjes (të bazuara në zona) (OECM), kur ofrohet mbrojtja de facto e mjedisit detar, me përjashtim të veprimtarive të njeriut, si p.sh. zonat ushtarake me akses të mbyllur në tokë dhe në det, legjislacioni i një zone peshkimi 2 km përreth grykës së lumit dhe hyrjet e lagunave ose zonat e ndaluara përreth zonave të akuakulturës.



Figura 36: Harta e Zonës së Ruajtjes së Gjirit në Vlorë.



Figura 37: Vendndodhja e propozuar për ankorimin e bovave në gjirin e Vlorës.

5. Seksioni 5 - Veprimtaritë njerëzore dhe rreziqet ose ndikimet e lidhura me to

Planifikimi sektorial përkatës dhe veprimtaritë përkatëse përfshijnë:

- Strategjinë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020; Dokumenti përcakton bazën e një planifikimi të integruar dhe synon zhvillimin e sektorit rural dhe bujqësor. Strategjia i konsideron partneritetet Urbane-Rurale si një qasje e integruar për të arritur një zhvillim të ekuilibruar. Zhvillimi i bujqësisë urbane përfshin zhvillimin e kësaj bujqësie në zona me urbanizim të moderuar dhe përgjithësisht të lokalizuara në periferi të zonave të banuara. Agroturizimi do të jetë një nga mjetet e promovimit të turizmit dhe zhvillimit ekonomik, por edhe i rritjes së qëndrueshmërisë së turizmit, si dhe i ruajtjes e i nxitjes së identitetit kulturor vendor.
- Strategjinë e Peshkimit 2016-2021 - Kjo strategji paraqet një vizion të përgjithshëm strategjik për zhvillimin afat-mesëm të sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës në Shqipëri. Ajo përcakton objektivat dhe prioritetet e Shqipërisë që janë në përputhje me ato të Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE-së. Strategjia përmban objektivat specifikë të zhvillimit (OSZH) dhe masat përkatëse të propozuara lidhur me peshkimin artizanal me mjete të lehta dhe monitorimin, kontrollin dhe vëzhgimin e veprimtarive të peshkimit (MKV); OSZH 6: Mjedis detar i mirëmenaxhuar që mbështet peshkimin e qëndrueshëm artizanal (Zhvillimi i planeve të menaxhimit bregdetar për peshkimin dhe mbrojtjen mjedisore; Ngritja e grupeve të menaxhimit bregdetar dhe e rrjeteve përfaqësuese për të zhvilluar dhe zbatuar planet e menaxhimit bregdetar; Identifikimi i zonat kritike të peshkimit dhe habitateve natyrore që kanë nevojë për mbrojtje shtesë) OSZH 9: Një regjim menaxhimi dhe zbatimi që kontrollon hyrjen në burimet e peshkimit në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme (Masat për zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të MKM-së për ujërat bregdetare/tokësorë, si pjesë e një qasjeje më të gjerë të bashkëmenaxhimit, kombinuar me ngritjen e kapaciteteve/trajnimin në teknikat e MKM-së;
- Strategjinë e menaxhimit të integruar të mbetjeve 2018-2033 - Qëllimi i kësaj strategjie është që të shërbejë si një udhërrëfyes për përafrimin e plotë të sektorit të menaxhimit të mbetjeve të acquis-it në Shqipëri dhe të mbështesë integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), vazhdimin e procesit të fuqizimit të institucioneve ekonomike dhe sigurisë rajonale, si dhe bashkëpunimi Euro-Atlantik në fushat ekonomike dhe të sigurisë.
Dominimi mbi diellin dhe plazhet, vizitat e paorganizuara, asnjë ofertë për zhytje, asnjë qasje në zonë etj. janë të gjitha veprimtari që lidhen me potencialin e papërdorur të turizmit. Nga ana tjetër, hedhja e mbetjeve, shkarkimet, ndotja, ndërtimi dhe mbipërdorimi (plazhet e mbipopulluara) lidhen me efektet negative të veprimtarisë turistike. Ndikimet që shoqërojnë veprimtaritë që turistët kryejnë gjatë një vizite, si p.sh. notimi, lundrimi, zhytjet në sipërfaqe të ujit dhe zhytjet e thella, mund të jenë një burim kronik shqetësimi për organizmat detare dhe mund të çojnë deri në shkatërrim fizik të lokalizuar të shtratit të detit, algave dhe formacioneve koraligjene, madje edhe në nivele të ulëta të përdorimit.

Mund të parashikohen një sërë veprimtarish turistike me bazë natyrën që mund të zhvillohen në ZMD, duke përfshirë vëzhgimin e jetës së egër, zhytje, zhytje në sipërfaqe të ujit ose udhëtimet detare, pasi kjo zonë ka potencial të madh për të kaluar kohën e lirë, argëtim, turizëm në plazh dhe turizëm në trashëgimitë kulturore. Administrata e parkut duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e planifikuar të turizmit në rajon, që pritet të rritet në mënyrë të konsiderueshme gjatë pesë viteve të ardhshme. Pritet që ZMD-të të kthehen në tërheqje kryesore për turizmin, ndërsa zona të bëhet më e njohur, kështu që është mjaft e rëndësishme që të garantohet një zhvillim i qëndrueshëm i turizmit, nga i cili përfitojnë komunitet vendase.

Ndarja e mbetjeve (kryesisht plastike, letra dhe organiket), nga pikëpamja ligjore, është bërë e detyrueshme në qytetet kryesore që nga viti 2016, në ato më të voglat në vitin 2018- ndërkohë që vetëm së fundmi kanë nisur të zbatohen në Tiranë. Megjithatë, ende nuk ekzistojnë instrumentet e duhura të zbatimit. Në nivel vendor, autoritetet janë përgjegjëse për kompetencat dhe kapacitetet që mundësojnë zhvillimin dhe zbatimin e masave vendore për menaxhimin e mbetjeve, ndarjen e mbetjeve të ngurta, riciklimin dhe mbështetjen e përmirësuar për të reduktuar ndikimet negative në mjedis dhe klimën, përfshirjen e popullsisë, përmirësimin e edukimit dhe njohurive mbi mjedisin duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të synuara të grave dhe të rinjve, fushata ndërgjegjësuere për mjedisin dhe fushata/aktivitete informuese

Studimi i fizibilitetit i KfW për sistemin e integruar të menaxhimit të mbetjeve për rajonin e Vlorës (2015-2016), në bazë të të dhënave të disponueshme statistikore, raporton se ka një rritje të parashikuar të gjenerimit të mbetjeve nga 54166 ton/a në 2017 në 71095 ton/a në vitin 2036, me më shumë se 90% të tërësisë të ardhura nga bashkia e Vlorës dhe veprimtaritë turistike dhe jashtë kësaj, sasia e riciklueshme (letër, plastikë, qelq dhe metal) përbën rreth 36%, ndërsa sasia e materialeve të riciklueshme (material i thatë) raportohet të jetë siç vijon: letër 19% (ose 1040 Mg/a) plastikë 11% (ose 602 Mg/a) metal 1% (ose 55 Mg/a) dhe qelq 5% (ose 274 Mg/a); Norma aktuale e mbledhjes së mbetjeve është 56% dhe si rrjedhojë, mbetjet e pambledhura dhe të shpërndara ndotin tokën dhe ujin dhe kanë një ndikim negativ në faktorin tërheqës të zonës, statusin e ZMD-së, turizmin dhe situatën e përgjithshme higjienike.

Figura 42: Vendbanimet, infrastrukturat, veçoritë historike dhe kulturore në zonën e Vlorës.

Ndërkohë, studimi vlerëson se mbetjet e rrezikshme të krijuara në rajonin e Vlorës (qarku) janë përafërsisht 350-400 ton/a (sipas një vlerësimi të përafërt 17233 ton/a të sasisë së përgjithshme të mbetjeve industriale); popullsia është parashikuar që të rritet nga 146686 në vitin 2017 në 163367 në vitin 2036 (kjo përfshin Vlorën, Selenicën dhe Orikumin) ndërsa pothuajse 60% e popullsisë jeton në qytetin e Vlorës.

Për sa i përket naftës së përdorur (si pjesë e sasisë së përgjithshme të mbetjeve të rrezikshme), raporti i monitorimit të mbetjeve të AKM-së (Agjencia Kombëtare e Mjedisit) 2015-2016 tregon një sasi prej 4000 litrash naftë të përdorur të gjeneruar gjatë vitit 2016 dhe pothuaj asnjë operator ose subjekt i licencuar për trajtimin e riciklimit të kësaj rryme mbetjesh.

Kur bëhet fjalë për vlerësimin e gjendjes së ujërave të zeza, në mënyrë të padiskutueshme, mungesa e infrastrukturës së duhur të kanalizimeve dhe trajtimit të duhur të ujërave të ndotura përgjatë vijës bregdetare është shqetësim kryesor, jo vetëm për qendrat urbane dhe rrethinat e rajonit të Vlorës, por edhe për zhvillimin e sektorëve të tjerë jetikë, si sektori i turizmit, ekonomik dhe të mbrojtjes së mjedisit. Si pasojë, çështja ka nevojë për



një përgjigje të shpejtë në drejtimin e ofrimit të zgjidhjeve të menjëhershme operacionale, efektive dhe teknike të qëndrueshme, të mbështetura nga urbanizimi gradual, i integruar dhe miqësor me mjedisin. Është e rëndësishme të theksohet se gjatë viteve të fundit, janë bërë përpjekje të konsiderueshme në projektimin, ndërtimin dhe funksionim të 2 Impiantet e Trajtimit të Ujërave të Zeza (më pas ITUZ) me rëndësi thelbësore për të gjithë Gjirin e Vlorës: ITUZ për bashkinë e Vlorës dhe ITUZ për njësinë administrative të Orikumit; Edhe pse të dy ITUZ-të e sipërpërmendura janë ndërtuar në 2016, vetëm ai në Vlorë është operacional, deri në një farë pike (trajtimit parësor dhe dytësor), ndërsa ai në Orikum, qendër urbane me ndikim madhor në zonën e synuar, e studiuar në këtë raport, është plotësisht jashtë funksionit.

5.9. Trafiku detar

5.9.1. Informacione të përgjithshme mbi navigimin në Gjirin e Vlorës

Gjiri i Vlorës është më i madhi, më i thelli dhe më i mbrojturi në rajon nga kanali i Korfuzit deri në Gjirin e Drinit. Ai ndodhet midis Gadishullit të Karaburunit dhe Kepit të Treporteve. Para hyrjes së tij, e cila është 5.3 milje e gjerë, gjendet ishulli i Sazanit, midis Kepit të Gallovecit dhe Treporteve. Gjiri hyn në tokë për të nisur rreth 5 milje në juglindje, më pas kthehet në jug dhe mbaron në pjesën e poshtme të bregut të Dukatit. Bregu perëndimor i gjirit dhe pjesa jugore e bregdetit lindor janë të larta dhe malore.

Vija bregdetare e Gjirit të Vlorës është shkëmbore dhe pak e thyer, duke krijuar disa kepe dhe gryka. Gjiri i Kongjorufës ose Shën Gjoni ndodhet midis kepit të Shën Gjonit në lindje dhe bregut që formon zgjerimin juglindor të kepit të Gallovecit. Bregu i këtij gjiri është shkëmbor, veçanërisht në anën perëndimore, e cila zbret në det ndërkohë që ana lindore është shkëmbore e ulët. Në pjesën e poshtme (jug), bregdeti ka një sektor që zbret butë poshtë në det, të ngjashëm me një plazh. Ky sektor është zhvilluar së fundmi si një destinacion turistik dhe pasagjerët e përditshëm (anijet e vogla për pasagjerët) e vizitojnë këtë gjatë verës. Në pjesën jugore të gjirit ekziston baza detare e Pasha-Limanit. Afrimi, veprimtaritë turistike dhe të peshkimit janë të ndaluara në zonën e kufizuar nga linja që bashkohet me kepin e Pasha Limanit dhe fillimin e plazhit të Orikumit (pika e kontrollit e bazës detare të Pasha Limanit), për të gjitha anijet e peshkimit dhe tregtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe të huajat. Nga Pashalimani në kepin e Ramicit (3.4 milje lindje-verilindje të Kepit të Pashalimanit)

Porti i Vlorës ndodhet në jug të qytetit të Vlorës, 2 milje në veri të fortesës së Kepit. Ajo përbëhet nga dy mole: ai lindor dhe ai perëndimor (moli zero). Moli lindor është 362 m e gjatë, por 225 m janë të përdorshme. Gjerësia e këtij moli nis nga 16 m dhe zmadhohet deri në 90 nga fillimi. Duke nisur nga 90 m deri në fund në vijën bregdetare, gjerësia është 10-12 m. Thellësitë në krye të molit janë: 7,3 m, midis 6 m dhe aty ku mbaron pjesa e përdorshme 225 m, thellësia është 2 m. Moli është i përdorshëm nga të dyja anët. Moli perëndimor ka formën e një valëpritëseje dhe përdoret vetëm në pjesën e brendshme, 110 m në gjatësi. Thellësitë janë: në majë 8 m, midis 6.4 m dhe në fundin e pjesës së përdorshme 5.3 m. Porti i Vlorës është i hapur për të gjitha llojet e erërave dhe deteve. Me ndërtimin e molit perëndimor në formën e një udhëzuesi valësh, mund të qëndrojnë në port për ta mbrojtur nga drejtimet e izoluara veriore dhe veriperëndimore, si dhe pjesërisht nga ajo perëndimore. Drejtimi jugor është plotësisht i hapur dhe kur era është shumë e fortë, bëhet e pamundur që anijet të rrinë në port. Të dy molet mund të furnizohen me ujë të pijshëm dhe me energji elektrike, sipas nevojës.

Terminali i ri i benzinës PIA është ndërtuar 2,3 milje VP të portit të Vlorës. Porti Petrolifera është i pajisur me dy valëpritëse dhe një mol qendror. Valëpritësja veriore është 1080 m e gjatë në një formë harku. Valëpritësja jugore është 750 m e gjatë. Moli i mesëm 190 m i gjatë, 10 m i thellë, shërben për të ngarkuar dhe shkarkuar karburant. Si fillim, në veri ka një bankinë 110 m të gjatë, e cila përdoret për anijet e vogla.

Shenjta orientuese në fanarin e hyrjes së majtë në port, i cili, (gjerësia 40 ° 29 '01' V, gjatësia 19 ° 26 '00' L) është një plintë e kuqe plastike 1 m mbi një kullë betoni të rrumbullakët 6 m të lartë. Lartësia e dritës mbi nivelin e detit është 8 m dhe distanca nominale e shikimit është 6 milje. Hyrja e djathtë e fanarit (gjerësia 40 ° 28 '56 .3 'V, gjatësia 19 ° 26 '00 .8' L) është një plintë plastike jeshile 1 m mbi një kullë betoni të rrumbullakët 6 m të lartë. Lartësia e dritës mbi nivelin e detit është 8 m dhe distanca nominale e shikimit është 6 milje.

Kontrolli i **trafikut detar në** Vlorë mbikëqyret nga zyra kryesore e portit si dhe nga Qendra Operacionale ndërinstucionale (QNO) Të gjitha anijet dhe varkat që hyjnë/largohen nga porti i Vlorës dhe nisen për udhëtime ndërkombëtare janë të detyruara të përmbushin procedurat e praktikës së lirë në portin e Vlorës. Praktika e lirë kryhet nga agjencitë qeveritare, si p.sh. inspektori Kryesor i Portit, policia kufitare, zyra doganore dhe inspektori Sanitar. Të gjitha anijet janë të detyruara të komunikojnë me zyrën kryesore të Portit me qëllim që të komunikojnë për arsye të sigurisë së trafikut detar. Anijet e peshkimit informojnë zyrat kryesore dhe kontrollet kufitare për lëvizjet e tyre. Anijet me një tonazh më të madh se 300GT duhet të pajisen me SAI (Sistemi Automatik Identifikimi), i cili u ofron autoriteteve dhe anijeve të tjera që lundrojnë pranë informacion të detajuar mbi anijen.

Nga ana tjetër, policia kufitare monitoron të gjitha lundrimet e varkave të vogla. Përpara lundrimit të tyre, ata duhet të informojnë policinë kufitare për udhëtimet dhe destinacionet e synuara.

QNOD, e cila është një qendër shtetërore ndërinstucionale, është përgjegjëse për mbikëqyrjen bregdetare. Ka kapacitetin monitorues të radarit për të kontrolluar të gjitha operacionet në hapësirën detare shqiptare. QNOD monitoron trafikun, operacionet e shpëtimit dhe operacionet për parandalimin dhe reagimin ndaj ndotjes. Çdo njësi e lundrueshme monitorohet nga kjo qendër.

Gjiri i Vlorës është një gji i ngarkuar për sa i përket trafikut detar. Kategoritë kryesore të trafikut të identifikuar në këtë gjire janë:

- a. Trafiku i traqeteve
- b. Anijet e transportit të mallrave
- c. Anijet cisternë
- d. Anijet/kroçierat turistike
- e. varkat e peshkimit
- f. varkat për argëtim

Të dhënat e përdorura në këtë raport janë mbledhur kryesisht nga Zyra Qendrore e portit të Vlorës, Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe nga Instituti i Transportit.



Figura 43: Trafiku detar në gjirin e Vlorës në vitin 2019.

a. Trafiku i trageteve

Tabela 12, më poshtë, tregon numrin e ndalesave të anijeve Ro/Ro që lundrojnë midis Vlorës dhe Brindisit, Itali. Siç mund të vëzhgohet lehtë nga tabela, ky është një shërbim i rregullt gjatë gjithë vitit.

Tabela 12. Trafiku i trageteve në portin e Vlorës për periudhën 2014-2019.

Ndal ohet	Muaj	Viti					
		2014	2015	2016	2017	2018	2019
1	Janar	21	20	23	47	24	26
2	Shkurt	19	19	20	35	21	19
3	Mars	19	22	23	22	22	26
4	Prill	20	22	24	22	24	22
5	Maj	16	33	25	10	27	24
6	Qershor	21	27	23	21	37	
7	Korrik	26	59	31	32	36	
8	Gusht	33	77	36	49	53	
9	Shtator	24	51	42	28	32	
10	Tetor	19	49	58	25	23	
11	Nëntor	20	24	53	24	23	
12	Dhjetor	22	26	59	27	27	

Grafiku i mëposhtëm tregon shpërndarjen e trafikut përgjatë vitit. Gjatë periudhës së verës dhe dhjetorit ka një rritje të konsiderueshme të trafikut krahasuar me muajt e tjerë të vitit. Gushti mbetet më e mbingarkuari ndërsa numri i ndalesave të trageteve për muaj është më i lartë, me rekordin në vitin 2015, kur numri i ndalesave ishte 77.

b. Anijet e transportit të mallrave

Porti i Vlorës është i përbërë nga dy mole dhe infrastruktura e tyre për trajtimin e anijeve të transportit të mallrave është shumë e kufizuar. Nuk ka zonë ankorimi dhe thellësia e ujit nuk i lejon anijet e mëdha të ndalojnë në këto mole. Një faktor tjetër që ka ndikuar në trajtimin e ngarkesave, përveç kushteve të këqija të moleve të ngarkesës, kanë qenë ndërtimet që nuk ndalojnë asnjë herë, të cilat kanë qenë të pranishme prej më shumë se dy dekadash dhe ende nuk kanë përfunduar. Për këto arsye, Porti i Vlorës sot përfaqëson rreth 2% të ngarkesave të transportuara në rrugë detare në sektorin e porteve në Shqipëri. Numri i ndalesave të anijeve të ngarkesës është reduktuar ndjeshëm gjatë dy viteve të fundit. Në tabelën e mëposhtme 2 jepet numri i anijeve të transportit të mallrave që kanë ndaluar në portin e Vlorës në periudhën 2014-2018.

c. Anijet cisternë

Porti i ri i quajtur "Vlora-1 ose "Petrolifera" ndodhet 2.5 milje në veri të portit ekzistues. Ky port i është dedikuar naftës me shumicë dhe naftës së papërpunuar nga fushat e naftës së Fierit. Ky terminal u ndërtua fillimisht në vitin 2009 dhe gjatë veprimtarisë së tij dhjetëvjeçare në ngarkimin dhe shkarkimin e naftës dhe naftës së papërpunuar, ky port ka rritur veprimtarinë e tij. Trafiku i anijeve cisternë të naftës që ndalojnë këtë port tregohet në tabelën 13 më poshtë:

Tabela 13: Trafiku i anijeve cisternë të naftës në portin e Vlorës-1, për periudhën 2014-2019.

Ndalo het	muaj	Viti					
		2014	2015	2016	2017	2018	2019
1	Janar	7	5	4	6	3	11
2	Shkurt	4	7	5	4	8	7
3	Mars	6	4	7	8	9	5
4	Prill	7	6	6	5	4	4
5	Maj	4	3	4	4	9	5
6	Qershor	3	7	3	5	4	
7	Korrik	4	5	5	4	7	
8	Gusht	5	4	5	6	6	
9	Shtator	7	5	7	3	5	
10	Tetor	6	5	5	4	7	
11	Nëntor	3	4	3	2	5	
12	Dhjetor	6	6	5	9	4	
	Totali	62	61	59	60	71	32

Për sa i përket shpërndarjes së shpeshmërisë së ndalesave gjatë vitit, nuk ka kuptim statistikor. Kjo do të thotë se vëllimi i ngarkesës së trajtuar dhe numri i ndalesave nxitet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kërkesa e tregut.

d. Anijet/kroçierat turistike

Trafiku turistik është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit në gjirin e Vlorës. Për shkak të mungesës së të dhënave, ne mund të mbledhim të dhëna vetëm për vitet 2017 dhe 2018 dhe pesë muajt e parë të vitit 2019. Të dhënat tregojnë se rritja e trafikut turistik në vitin 2018 në krahasim me 2017 ishte rreth 52% dhe në muajt e pikut si korriku, gushti dhe shtatori, kjo rritje ishte shumë e konsiderueshme. Tabela e mëposhtme 14 tregon trafikun turistik për periudhën 2017-2019.

Tabela 14: Trafiku i anijeve dhe jahteve turistike në gjirin e Vlorës për periudhën 2017-2019.

Ndaloh et	muaj	Viti					
		2014	2015	2016	2017	2018	2019
1	Janar				2	2	1
2	Shkurt				3		2
3	Mars				5	10	9
4	Prill				18	12	17
5	Maj				63	48	41
6	Qershor				94	125	
7	Korrik				145	224	
8	Gusht				183	317	
9	Shtator				40	110	
10	Tetor				10	10	
11	Nëntor				2	1	
12	Dhjetor				5	5	
	Totali	0	0	0	570	864	70

Ky trafik shfaq anijet turistike dhe jahtet që vijnë në gjirin e Vlorës, si dhe kroçierat e përditshme që nisen nga porti i Vlorës drejt destinacioneve të gadishullit të Karaburunit si Shën Vasili, Shën

Gjoni, Ishullit të Sazanit etj. Ky trafik përfaqëson më shumë se 50% të lëvizjeve të kësaj kategorie trafiku. Kroçierat e mëdha vizitojnë portin e Vlorës në mënyrë sporadike.

Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e trafikut gjatë gjithë vitit dhe është shumë e qartë që trafiku gjatë muajve qershor - shtator shënon një rritje të konsiderueshme. Gushti mbetet muaji më i ngarkuar dhe përfaqëson pothuajse 32% të trafikut vjetor në vitin 2017 dhe 37% të trafikut vjetor në vitin 2018.

Grafiku 3: trafiku vjetor i anijeve turistike në Gjirin e Vlorës.

e) varkat e peshkimit

Ka një flotë peshkimi në Gjirin e Vlorës dhe kjo flotë ndodhet në portin e peshkimit (Tre Port), VVP të portit tregtar ekzistues. Ka rreth 100 anije peshkimi dhe udhëtimet vjetore të kësaj flote tregohem në tabelën e mëposhtme. Qarkullimi kryesor i trafikut nga ky port peshkimi është drejt pjesës veriore ose jugore të ishullit të Sazanit në Detin Adriatik ku shkojnë për peshkim. Nuk kishte të dhëna zyrtare për këtë trafik nga zyra kryesore e portit, por të dhënat janë marrë përmes intervistave me pronarët e anijeve. Shpërndarja e trafikut përgjatë vitit nuk kuptim statistikor. Numri i lundrimeve për peshkimit ishte në varësi të motit dhe sipas sezoneve të peshkimit.

Tabela 15: Trafiku i anijeve të peshkimit për periudhën 2014-2018.

Ndalohet	Muaj	Viti					
		2014	2015	2016	2017	2018	2019
1	Janar	65	34	90	60	35	40
2	Shkurt	74	60	33	54	60	37
3	Mars	70	66	65	71	55	51
4	Prill	97	75	86	90	74	62
5	Maj	55	90	96	104	90	66
6	Qershor	80	87	70	111	120	
7	Korrik	90	69	87	101	95	
8	Gusht	63	85	79	92	97	
9	Shtator	85	96	115	98	140	
10	Tetor	114	99	120	110	137	
11	Nëntor	67	84	70	100	91	
12	Dhjetor	70	79	68	81	62	
	Totali	930	924	979	1072	1056	256

f. Trafiku i varkave për argëtim

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, ekzistojnë më shumë se 400 varka të vogla argëtimi të regjistruara në zyrën e regjistrimit të DPD që u përkasin pronarëve të rajonit të Vlorës. Këto varka përfaqësojnë shumicën e veprimtarisë së lundrimit bregdetar dhe distanca e tyre e lundrimit zakonisht nuk është më shumë se 2-3 milje nga bregdeti. Nuk ka të dhëna për këtë trafik.

g. Përmbledhja e trafikut

Tabela e mëposhtme shfaq një përmbledhje të trafikut të përgjithshëm në Gjirin e Vlorës, bazuar në informacionin e mësipërm. Trafiku është rritur ndjeshëm gjatë vitit 2014 (nga 1251 ndalesa në 2356 ndalesa). Kjo rritje ndodh për shkak të rritjes së ndalesave nga varkat turistike dhe jahtet, veçanërisht gjatë viteve 2017 dhe 2018. Numri i anijeve tregtare është reduktuar për shkak të arsyeve të përmendura në këtë raport.


Tabela 16: përmbledhja e trafikut në Gjirin e Vlorës në muaj për vitet 2014-2018.

Ndalohet	muaj	Viti				
		2014	2015	2016	2017	2018
1	Janar	93	59	117	115	67
2	Shkurt	97	86	60	97	90
3	Mars	95	92	97	107	97
4	Prill	124	103	117	138	116
5	Maj	75	126	129	183	178
6	Qershor	104	121	101	232	286
7	Korrik	120	133	126	284	363
8	Gusht	101	166	124	331	474
9	Shtator	116	152	166	169	287
10	Tetor	139	153	184	150	178
11	Nëntor	90	112	127	130	121
12	Dhjetor	98	111	133	124	99
	Totali i ndalesave	1252	1414	1481	2060	2356

Për sa i përket shpërndarjes së trafikut, sërish periudha më e mbingarkuar mbetet ajo gjatë verës, në të cilën numri i ndalesave turistike rritet ndjeshëm. Gushti mbetet muaji më i ngarkuar i vitit për trafikun detar.

Grafiku 4, më poshtë, tregon shpërndarjen e trafikut të përgjithshëm në Gjirin e Vlorës dhe nga ky diagram mund të vëmë re se gjatë viteve 2017 dhe 2018 kemi një rritje të konsiderueshme të trafikut. Kjo rritje e konsiderueshme është e dukshme për dy vitet e fundit, sepse na mungonin të dhënat për periudhën e mëparshme.

Grafiku i shpërndarjes së përgjithshme të trafikut (gjatë gjithë vitit) për periudhën 2014-2018 në Gjirin e Vlorës.



Për sa i përket shpërndarjes së trafikut, sërish periudha më e mbingarkuar mbetet ajo gjatë verës, në të cilën numri i ndalesave turistike rritet ndjeshëm. Gushti mbetet muaji më i ngarkuar i vitit për trafikun detar.

Grafiku 16, më poshtë, tregon shpërndarjen e trafikut të përgjithshëm në Gjirin e Vlorës dhe nga ky diagram mund të vëmë re se gjatë viteve 2017 dhe 2018 kemi një rritje të konsiderueshme të trafikut. Kjo rritje e konsiderueshme është e dukshme për dy vitet e fundit, sepse na mungonin të dhënat për periudhën e mëparshme.

5.10. Instalimet dhe veprimtaritë ushtarake

Në tokë

Informacionet janë të kufizuara mbi këtë temë. Dy portet e Pasha Limanit afër Orikumit dhe Ishullit të Sazanit janë nën mbikëqyrjen e Marinës. Duke marrë parasysh pozicionin e ishullit të Sazanit, ai ka qenë gjithmonë një pikë strategjike dhe ushtria ka qenë e pranishme atje prej një kohe shume të gjatë. Si gadishulli i Karaburunit edhe Ishulli i Sazanit kanë baza ushtarake dhe një numër të madh bunkerësh, tunelesh dhe llogoresh. Kjo vlerë ka të bëjë me bunkerët ushtarakë që janë ndërtuar gjerësisht në Gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit. Edhe pse janë të pranishëm në të gjithë Shqipërinë, ato mund të përfshihen në udhëtime me guida mbi vlerat kulturore dhe historike të zonës.

Në det

Ministria e Mbrojtjes përdor një pjesë të zonës si bazë ushtarake (baza e Pasha Limanit dhe baza e Sazanit) dhe po kështu përdor ujërat detare të Karaburunit dhe Sazanit për operacionet ushtarake. Përmes rrethit Detar të Vlorës ata kanë të drejtë të japin leje për të lejuar çdo veprimtari brenda ose pranë zonave ushtarake, si dhe për të lejuar barinjte ose palë të tjera të interesuara për të kryer ndonjë punë mirëmbajtjeje.

5.11. Veprimtari të tjera detare

Gjiri i Vlorës është një zonë ujore pothuajse e mbyllur që grumbullon ndotësit me origjinë nga deti i hapur. Erërat e moderuara nga perëndimi dhe veri-perëndimi çojnë faktorët e ndotjes në fund të gjirit që shërben si vend hedhjeje mbeturinash. Përveç kësaj, gjiret e vogla përgjatë vijës bregdetare shërbejnë si grumbullues ndotjeje për arsyet e sipërpërmendura. Për këtë arsye, ngritja e një rrjeti vëzhgimi dhe monitorimi është shumë e dobishme për parandalimin e ndotjes, veçanërisht të depërtimit të rrjedhjeve të naftës brenda gjirit. Thellësia në gjiri arrin deri në 54 metra në juglindje të gjirit të Raguzës. Vija izobatika prej 50 m arrin deri në 0,5 kabllo gjatësi afër kepit të Kalasë dhe nis të drejtohet për nga deti duke arritur deri në 6,5 kabllo gjatësi në molin e portit të Vlorës.

Që prej Luftës së Dytë Botërore e në vazhdim, janë gjetur rreth 7 rrënoja anijesh të cilat përbëjnë site historike me biodiversitet. Ato janë: “Rosandra3”, “Regina Margherita”, “Interpido”, “Rovigno”, “Lucian”, “Stampella”, “Andromeda”, “Po”; Gjithashtu, këto relikte historike në mënyrë të vazhdueshme grabiten dhe plaçkiten nga gjahtarët e thesareve dhe metaleve, të cilët, gjatë veprimtarive të tyre shkaktojnë ndotje në të njëjtën kohë. Është e rëndësishme të theksohet se këto trashëgimi kulturore dhe turistike duhet të ruhen dhe/ose të mbrohen për të lejuar një përdorim më të ndërgjegjshëm të vlerave të tyre turistike dhe historike.

Duhet vënë në dukje fakti se gjiri i Vlorës dhe të gjitha ekosistemet e pacenuara që ndodhen në atë zonë, po u kushtohen vëmendje nga shumë palë të interesuara, opinioni publik, media, ambientalistët si dhe pushteti lokal dhe qendror. Bukuritë natyrore, ekosistemet dhe investimet për turizmin si dhe kultivimi i peshkut e bëjnë këtë zonë më të ndjeshme kundrejt ndotjes dhe veprimtarisë njerëzore.

Por një pjesë e saj, e pozicionuar në hyrje të ngushticës të Otrantos, pasi kalon të gjithë trafikun në Adriatik, ku vetëm në një vit, kalojnë mbi 6 000 anije mbi nivelin 300 të tonazhit të lartë dhe anijeve cisternë me tonazh mbi nivelin 150, pa përmendur anijet e tjera që nuk e kanë të detyrueshëm raportimin. Përveç kësaj, ndërtimi i disa objekteve dhe terminaleve të naftës, porteve dhe kantierëve detare ndikojnë në mënyrë të dukshme të aktivitetet blu dhe të gjelbra. Kjo situatë kërkon shumë më tepër ndërgjegjësim, informacion dhe përpjekje për edukim mbi temat përkatëse, konkretisht për ndotjen detare nga trafiku detar dhe derdhjet e naftës.

Veprimtari detare (lundrim, notim, zhytje, peshkim sportiv, i ligjshëm dhe i paligjshëm)

Dominimi mbi diellin dhe plazhet, vizitat e paorganizuar, asnjë ofertë për zhytje, asnjë qasje në zonë etj. janë të gjitha veprimtari që lidhen me potencialin e papërdorur të turizmit. Nga ana tjetër, hedhja e mbetjeve, shkarkimet, ndotja, ndërtimi dhe mbipërdorimi (plazhet e mbipopulluara) lidhen me efektet negative të veprimtarisë turistike. Ndikimet që shoqërojnë veprimtaritë që turistët kryejnë gjatë një vizite, si p.sh. notimi, lundrimi, zhytjet në sipërfaqe të ujit dhe zhytjet e thella, mund të jenë një burim kronik shqetësimi për organizmat detare dhe mund të çojnë deri në shkatërrim fizik të lokalizuar të shtratit të detit, algave dhe formacioneve koraligjene, madje edhe në nivele të ulëta të përdorimit.

Mund të parashikohen një sërë veprimtarish turistike me bazë natyrën që mund të zhvillohen në ZMD, duke përfshirë vëzhgimin e jetës së egër, zhytje, zhytje në sipërfaqe të ujit ose udhëtimet detare, pasi kjo zonë ka potencial të madh për të kaluar kohën e lirë, argëtim, turizëm në plazh dhe turizëm në trashëgimitë kulturore. Administrata e parkut duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e planifikuar të turizmit në rajon, që pritet të rritet në mënyrë të konsiderueshme gjatë pesë viteve të ardhshme. Pritet që ZMD-të të kthehen në tërheqje kryesore për turizmin, ndërsa zona të bëhet më e njohur, kështu që është mjaft e rëndësishme që të garantohet një zhvillim i qëndrueshëm i turizmit, nga i cili përfitojnë komunitet vendase.

5.12. Veprimtari të tjera, si nxjerrja e rërës (bregdeti dhe deti), mbushja e detit, hedhjet e mbeturinave në det, prodhimi i energjisë, mullinjtë e erës, tubacionet dhe kabllot, etj.)

Ose nuk ka të dhëna mbi këto tema ose janë të kufizuara, nën studim.

6. Seksioni 6 – Shënime paraprake mbi ndryshimet, ndikimet dhe rreziqet

Për të kuptuar më mirë nevojën për planifikimin e hapësirës detare, është e rëndësishme të identifikohen si tendencat aktuale, si edhe të parashikohen si mund të jenë tendencat e ardhshme në fusha si:

- Rritja e kërkesës për ujë të pastër për popullsinë lokale, turizmin, bujqësinë, industrinë, etj.
- Rritja e kërkesave për energji në Shqipëri, Adriatik dhe globalisht, dhe tendencat për burime të rinovueshme (zhvillimi i naftës dhe gazit) dhe burime të rinovueshme energjie që gjenden në mjedisin detar (era në det të hapur, dallgët ose energjia e rrymës)
- Rritja e transportit detar dhe lundrimit në Adriatik, duke rritur si transportin detar dhe madhësinë e anijeve
- Rritja e kërkesës për zhvillimin e turizmit dhe për përdorime për arsye argëtimi pasi Shqipëria njihet si një destinacion turistik në zhvillim për shkak të mjedisit të tij të pacenuar dhe tërheqjeve kulturore
- Rritja e kërkesës për peshk dhe ushqim deti, me rritjen mesatare të konsumit për frymë të parashikuar në mbarë botën, një trend i ngjashëm ka gjasa të ndodhë në Adriatik
- Rritja e kërkesës për bujqësi, që po zgjerohet dhe po përqendrohet gjithnjë e më shumë tek efikasiteti dhe prodhimi duke çuar në shkarkime fosfori, nitrogjeni dhe të tjera ndotës që shkaktojnë eutrofikimin e ekosistemeve detare
- Rritja e kërkesës për zhvillimin e infrastrukturës, duke përfshirë ndërtimin e porteve dhe limaneve, urave dhe rrugëve, sistemi ujore menaxhimi për mbetjet e ngurta dhe llojet e tjera të mbetjeve, si për vendasit ashtu dhe për turistët – të gjitha për të arritur rritjen e fluksit dhe përdorimeve të mjedisit detar dhe bregdetar.

Lëvizja e popullsisë (emigrimi dhe migrimi i brendshëm) është një fenomen shumëdimensional. Ajo manifestohet me braktisjen e zonave për shkak të emigrimit jashtë vendit (zona e Orikutit), zaptimin e tokave, përhapjen e çorganizuar dhe ndërtimin abuziv për shkak të migrimit të brendshëm dhe mungesës së kontrollit (*komuna e Noveselës*); rritjen e ndotjes dhe mbetjeve njerëzore, etj.

Këtu është e rëndësishme të prezantohen disa perceptime kontradiktore ndërmjet nivelit qendror dhe vendor, të cilat bien në kundërshtim me veprimtaritë dhe perceptimet ndërmjet institucioneve në të njëjtin nivel, dhe veprimtaritë kontradiktore ndërmjet grupeve të përdoruesve vendorë të popullsisë. Në veçanti:

- Konflikti i interesit ndërmjet nivelit qendror dhe vendor për përdorimin e burimeve, i shprehur në shqetësimet e popullsisë vendase, lidhet me të drejtat e tyre të pronësisë dhe ngurrimin në lidhje me vendimin e qeverisë për të përfshirë zonat e projektit nën statusin e zonave të veçanta të mbrojtura.
- Konflikti i interesit ndërmjet biznesit/industrisë dhe popullsisë vendase: fabrika e kripës dhe peshkatarët, peshkatarët e organizuar në shoqata dhe peshkatarët individualë, peshkatarët që përdorin ish-kënetat dhe fermerët.
- Konflikti i interesit ndërmjet biznesit dhe degëve qendrore ose vendore të qeverisë: keqfunksionimi i kanaleve të komunikimit midis ujit të detit dhe lagunës,

ndryshimi i ciklit hidrogjik të lagunës, reduktimi i kapacitetit të kullimit dhe fluksi i ujërave të ëmbla në lagunë.

- Konflikti i interesit ndërmjet individëve të ndryshëm ose grupeve të përdoruesve: peshkatarët dhe gjahtarët, reduktimi i ekosistemeve të drurit dhe ligatinore për të pasur më shumë tokë të punueshme, përdorimi i pesticideve dhe fertilizuesëve kundrejt bujqësisë organike, shkarkimet e mbetjeve urbane në lagunë, fluksi i turistëve etj. Konflikti i interesave ndërmjet veprimtarive të paligjshme: prenja e pemëve, zjarret në pyje, peshkimi me eksplozivë,

Përveç ndryshimeve natyrore, duhet të merren parasysh edhe ndryshimet e shkaktuara nga njeriu, duke filluar shpesh nga reagimi ndaj ndikimit të të fundit, duke qenë se janë të ndërlidhura.

Është e mundur të identifikohen ndikimet apo rreziqet që vijnë nga një sektor i veprimtarisë, por shumë i vështirë për të arritur një konsensus për ndikimet e mbledhura të të gjithë sektorëve së bashku. Megjithatë, duke marrë në konsideratë mjedisin detar dhe vijën bregdetare, ekziston mundësia e identifikimit, për çdo veprimtari, të shumicës së ndikimeve dhe rreziqeve përkatëse, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 17: Veprimtaritë që lidhen me mjedisin detar dhe rreziqet përkatëse për mjedisin detar dhe bregdetar.

Aktiviteti	Rreziqet dhe ndikimet e lidhura me to
Veprimtaritë e peshkimit industrial dhe Veprimtaritë e peshkimit artizanal	Mungesa e kontrollit Mbipeshkimi Ndotje, naftë, plastikë, rrjeta të humbura dhe të hedhura Ndikimi i rrjetave në shtratin e detit ndaj ekosistemeve dhe specieve
Mbledhja e midhjeve hurmë	Mungesa e kontrollit dhe e kuotave, shkatërrimi i habitateve
Aktivitetet e akuakulturës	Ndikimi i ngarkesës organike në mjedis, sedimentet Futja e patogjenëve dhe viruseve; Futja e mundshme e specieve jovendase; Ndikimi në cilësinë e ujit dhe sedimenteve pa programe monitorimi.
Peshkimi sportiv	Mungesa e kontrollit, peshkimi i paligjshëm
Peshkimi për arsye argëtimi dhe peshkimi për jetesë	Mungesa e kontrollit, asnjë e dhënë
Skema e lundrimit, trafiku detar	Rreziqet e përplasjeve dhe ndotjes aksidentale Ndotja ditore nga navigimi, materialet plastike, dhe të tjera
Parku kombëtar Karaburun-Sazan (zonë e mbrojtur detare dhe bregdetare)	Rreziqet nga aksidentet dhe ndotja e anijeve, burimet e vjetra dhe të fundit Mbetjet detare Frekuentimi nga toka dhe deti të kontrollohet (mbeturinat, shkatërrimi i habitateve, çrregullim për kafshët, peshkimi i jashtëligjshëm...)
Zona e zhvillimit për turizëm në jug të Vlorës.	Rritje e kërkesës për ujë Ndotja bregdetare Erozioni bregdetar Tërmet/tsunami
Veprimtari ushtarake	Ndotja, nafta, zhurma Përplasje Rreziqe nga materiale ushtarake të hedhura në tokë dhe në det
Kriporet e Nartës	Kërkesa për ujë për kripë Erozioni bregdetar Ndryshimet e përdorimit të tokës

<p>Portet dhe bankinat Bankinat e peshkimit, e naftës, për varkat e vogla dhe pasagjerë, për arsye ushtarake dhe turizmi.</p>	<p>Ndotja aksidentale nga nafta dhe lëndët kimike, në lidhje me transportin detar dhe tokësor, përpunimin dhe shpërndarjen e produkteve të naftës. Ndikimi nga porti ekskluziv dhe nga trafiku i mjeteve lundruese tregtare dhe private. Ndikim i mundshëm nga doket në port në qarkullimin e rrymave në gjë. Ndikimi i ankorimeve të portit në procesin e ndotjes përgjatë gjirit (dhe humbje në bimë detare) Ndotja nga materialet plastike dhe nafta ...</p>
<p><i>Të tjerat që do të studiohen, si nxjerrja e rërës (bregdeti, lumi dhe deti), mbushja e detit, hedhja në det, prodhimi i energjisë, mulliri i erës, tubacionet dhe kabllot, etj.)</i></p>	

Fokusi i procesit PHD

Në fazën aktuale, me një grup të pakompletuar të dhënash, për të vlerësuar në mënyrë të saktë gjendjen e zonës së Vlorës, dhe informacionin e limituar mbi vizionin dhe orientimin në të ardhmen e vendit dhe të rajonit jugor, është e mundur të jepen vetëm orientime mbi planifikim dhe menaxhimin e mjedisit detar. Takimi i parë i procesit të PHD-së do t'i kushtohet përkufizimit të vizionit dhe qasjes strategjike për zonën e Vlorës.

Duke marrë në konsideratë presionet dhe kërkesat ekzistuese për këtë rajon bregdetar, zhvillimi i tij do të rrisë këto presione dhe në veçanti ato që lidhen me nevojat për ujë të pastër, energji, infrastrukturë (në veçanti për transportin, industrinë dhe turizmin) dhe furnizimin me ushqim (nga bujqësia, peshkimi dhe akuakultura).

Në anën detare, procesi PHD do të duhet të përqendrohet veçanërisht në pesë fusha kryesore të veprimtarive që mund të gjenerojnë ndikim, rreziqe ose ulje të barazisë së mjedisit detar:

- Peshkimi
- Akuakultura
- Transporti detar dhe portet
- Turizmi dhe argëtimi
- Zonat e ruajtjes, sitet kulturore dhe historike

Për peshkimin është e nevojshme që të përcaktohet një ndarje fizike e llojeve të ndryshme të peshkimit : industrial ose gjysmë-industrial, artizanal dhe argëtues, duke marrë në konsideratë të gjithë legjislacionin ekzistues, kufizimi i peshkimit në zona specifike (zona ushtarake, porte, kanale lundrimi, pranë grykës së lumenjve të lagunave, zona të caktuara për veprimtari specifike si ato të akuakulturave, kulturore dhe të mbetjeve historike nën ujë, në zona të bllokuara, zona hedhjeje etj.) dhe ndarjen e zonave të mbetura për veprimtari të dakordësuara (planet e menaxhimit të peshkimit), me legjislacionin e ri nëse është e nevojshme dhe gjobat e përshtatshme dhe zbatimin rigoroz.

Për akuakulturën, zonat ekzistuese që i caktohen kësaj veprimtarie në pjesën jugore të gjirit të Vlorës duhet të vlerësohen si dhe të hartohet një plan i përshtatshëm për menaxhimin e akuakulturës me një profesionist dhe të aprovohet, duke përcaktuar në mënyrë specifike zonën, rregullat e procedurës, speciet, cilësinë e ushqimit, niveli i prodhimit dhe masat e emergjencës në rastin i një sëmundjeje, vdekshmërie aksidentale ose masive, dhe një program i pavarur monitorimi i financuar nga të gjitha kompanitë e akuakulturës që operojnë në zonë. Mund të miratohet një legjislacion i ri

për peshkimin, me gjobot e duhura dhe zbatimin rigoroz, duke marrë në konsideratë mbylljen e operacionit në rast shkeljeje të rregullave të miratuara të procedurave.

Për sa i përket transportit detar dhe porteve, nevojitet një plan specifik menaxhimi, pasi porti i naftës, porti i peshkimit, i trageteve, ai ushtarak dhe bankinat e shumta para hoteleve dhe restoranteve për transport turistik operojnë të gjithë në një zonë shumë të vogël, ku aksidentet mund të ndodhin, duke rrezikuar cilësinë e gjirit dhe tërheqjen e zonës për turizëm. Në këtë fazë, rekomandohet të kërkohet që të gjitha varkat që lidhen me produktet e naftës, transportin e mallrave dhe pasagjerëve, dhe peshkimin industrial, të përdorin hyrjen veriore të gjirit, e cila është më e gjerë dhe me më pak rrezik sesa kanali midis Karaburunit dhe Sazanit. Ky kanal i Karaburun-Sazanit do të përdoret vetëm për turizmin detar dhe veprimtaritë argëtuese si dhe nga varkat e kontrollit të marinës dhe shërbimeve të tjera.

Për veprimtaritë e turizmit dhe argëtimit në det, është gjithashtu e nevojshme të përgatitet një plan menaxhimi, me zona të përzgjedhura për notim (zakonisht zonë bregdetare), për zhytje (zonat specifike) për varkat e vogla të lundrimit (shkollat e lundrimit në zonën bregdetare) dhe që të gjitha veprimtaritë e mbrojtura të përjashtohen nga gjiri dhe të propozohen në një zonë në det të hapur. Për transportin e turistëve për veprimtaritë argëtuese me varka të motorizuara për veprimtari të ndryshme (udhëtime, transport në zonën e mbrojtur detare, turizmi peshkatar, etj.) rekomandohet që të përqendrohen nisjet në dy ose tre pika përgjatë bregdetit me qëllim që të mund të kontrollohet lëvizja dhe të garantohet siguria e pasagjerëve. Në këto zona, nisja mund të jetë në portin e peshkimit, në portin e trageteve dhe një tjetër përgjatë bregut jugor të Vlorës. Duke ulur numrin e operatorëve dhe duke vendosur një numër të kufizuar transporti për në gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit, do të lejohet reduktimi i presionit në parkun kombëtar dhe reduktimi i i rrezikut të zjarrit, të sasisë së mbeturinave dhe të gjithë dëmit në mjedisin tokësor. Duhet ngritur një sistem për hyrjen e varkave private në zonat e mbrojtura, të instalohet një sistem ankorimi dhe rezervimi, për gjysme dite ose ditë të plote, me ndalim të qëndrimit gjatë natës dhe që përfshin një tarifë për mirëmbajtjeje e molit.

Hapat e mëtejshëm për PHD-në

Gjatë procesit janë identifikuar disa elemente që mungojnë ose që kanë nevojë për më shumë të dhëna ose informacione. Do të jetë e nevojshme të kryhet një studim dhe të mblidhet informacion për këto elemente ose të zhvillohet plani i kërkimit dhe monitorimit për t'i ndjekur ato ose treguesit e përzgjedhur për cilësinë mjedisore, sociale dhe ekonomike të zonës.

Në mënyrë të veçantë, janë identifikuar nevojat dhe boshllëqet e mëposhtme:

- Zhvillimi i një plani kërkimi për mangësitë e identifikuar në njohuri
- Zhvillimi i një plani monitorimi për ndjekjen e ndryshimeve në ekosisteme dhe specie (të tanishme dhe të pritshme), në mjedis
- Identifikimi i treguesve të përshtatshëm (në përputhje me MSFD dhe UNEP MAP – IMAP-ECAP për aspektet mjedisore, sociale dhe ekonomike
- Kryerja e një përmbledhjeje e të gjitha burimeve të ndotjes dhe rreziqet përkatëse, masat parandaluese dhe planet e emergjencës
- Vlerësimi i ndikimeve të mundshme në ndryshimet klimatike në nivel lokal
- Lista e të gjitha zonave të grumbullimit të ujërave të zeza, zonat e grumbullimit në det, derdhjet e ujërave të shiut/stuhive

7. Seksioni 7 - STATUSI i EO të Konventës së Barcelonës

7.1. Habitati detar EO1

Sistemi i përbërë mjedisor i bregdetit Shqiptar është ruajtur përgjithësisht në gjendjen e tij natyrale dhe të pacenuar deri para disa vitesh, dhe mund të përfaqësojë një nga pikat e fundit të nxehta të biodiversiteti në ekosistemet detare në Mesdhe. (Anonim, 2002). Gjatë viteve të fundit, janë kryer procese natyrore komplekse dhe veprimtari të pakontrolluara njerëzore në këtë fushë (kryesisht në lidhje me zhvillimet urbane dhe të turizmit) dhe janë duke ekspozuar bregdetin shqiptar, dhe në veçanti gjirin e Vlorës, ndaj një ndikimi të fuqishëm në rritje, siç u përmbodh më lart dhe është raportuar në shumë studime të mëparshme specifike. Mbi këtë bazë, pritet një humbje e habitateve përkatëse bregdetare dhe një ulje e ndjeshme e vlerës ekologjike të zonës bregdetare dhe habitateve detare. Kjo humbje e është veçanërisht e rëndë në ekosistemet detare bregdetare, ku veprimtaritë e njeriut kanë qenë historikisht të përqendruara (Airoidi dhe Beck, 2007; Martin et al., 2005). Këto procese janë duke vepruar në disa zona, siç përshkruhet në raportet e pakta për bregdetin shqiptar (Anonim, 2002) dhe janë të mirë dokumentuara përgjatë vijave të tjera bregdetare evropiane (Airoidi dhe Beck, 2007), megjithëse ka ende mangësi të mëdha në njohuritë tona për humbjen e habitatit në vijat bregdetare të buta. Kjo është veçanërisht shqetësuese, pasi këto zona bregdetare përmbajnë disa nga ekosistemet më produktive dhe të larmishme, por edhe më të degraduara në botë (Edgar et al., 2000; Suchanek, 1994).

Për këtë arsye, njohuritë mbi habitatet bregdetare dhe informacionet e detajuara mbi strukturën e komuniteteve bentike janë pika thelbësore për përcaktimin e një baze referimi për kërkimet e ardhshme dhe për të drejtuar një ruajtje dhe menaxhim të brigjeve Shqiptare.

Parku Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan” I shpallur si Zonë e Mbrojtur Detare në vitin 2010, aktualisht është i vetmi Park Detar Kombëtar në Shqipëri. Parku mbulon një zonë detare që shtrihet 1,9 km përgjatë vijës bregdetare të Gadishullit Karaburun dhe ishullit Sazan, pranë Gjirit të Vlorës. Parku detar është shumë 16 kilometra i gjatë, me gjerësi që varion nga 3 deri në 4,5 kilometra dhe mbulon në total 12,428 ha sipërfaqe. Vetë Gadishulli Karaburun është një Rezervë Natyrore e Menaxhuar ndërsa Ishulli Sazan është zonë ushtarake shqiptare.

Zona e gjirit të Vlorës strehon një sërë habitatesh natyrore dhe shfaq një biodiversitet veçanërisht të pasur në shkallë vendi.

Në zonën e mbrojtur janë identifikuar të paktën 36 specie detare që bëjnë pjesë në listën ndërkombëtare të specieve të rrezikuara ose të mbrojtura. Për shembull, Ishulli i Sazanit është ishulli më i madh dhe strehon një pasuri të madhe ekologjike në termat e florës dhe faunës dhe një larmi peizazhesh. Midis 8% deri në 12% e florës së Shqipërisë mund të gjendet në ishull (Plani për Menaxhimin e Ishullit të Sazanit, Shqipëri, janar 2015, CdL). Ai ka gjithashtu një histori të madhe dhe trashëgimi kulturore, e cila e bën atë një aset të madh për zhvillimin e veprimtarive të turizmit të qëndrueshëm. Zona bregdetare e ZMD-së Karaburun-Sazan, në përgjithësi, më shumë shkëmbore, ndërsa ligatinat dhe dunat bregdetare janë të mbuluara kryesisht nga halofite dhe grupe vegjetale të ujërave të ëmbla. Plani i menaxhimit të ZMD Karaburun-Sazan identifikon zonat vijuese bregdetare, të përcaktuara nga thellësia e tyre dhe distanca e tyre nga bregu, të cilat strehojnë lloje të ndryshme të habitateve. Shpellat, kanionet dhe gjiret e vogla mund t'i gjeni në ato zona bregdetare.

Tabela 18: Llojet e habitateve detare të identifikuar në PKD-në Karaburun-Sazan

Zonat litorale bregdetare	Nënndarja e zonave	Biocenoza
Mediolitoral	Shtretër dhe gurë të fortë mediolitoralë	Biocenoza e formacioneve më të ulëta mediolitorale
		Biocenoza e shpellave mediolitorale
Infralitorale	Livadhet <i>Posidonia oceanica</i>	Biocenoza e livadheve <i>Posidonia oceanica</i> (grumbuj me <i>Posidonia oceanica</i>)
	Shtretër dhe gurë të fortë infralitoralë	Biocenoza e algave infralitorale
Circalitorale	Shtretër dhe gurë të fortë circalitoralë	Biocenoza koraligjene
		Biocenoza e shpellave gjysmë të errëta

▪ Livadhet *Posidonia oceanica*

Kjo specie endemike e Detit Mesdhe ndodhet në listën e specieve të rrezikuara ose të cenuara të Shtojcës II të Konventës së Barcelonës. Livadhet *Posidonia oceanica* strehojnë një biodiversitet të madh të makro-faunës bentike (sfungjerë, molusqe ose krustace) dhe ka një rol të rëndësishëm për ciklin e jetës së shumë specieve detare. Livadhet *Posidonia* janë gjithashtu një strehë për peshqit, duke siguruar ushqim dhe mbrojtje nga grabitqarët e tyre. Po ashtu, gjethet e vdekura të tyre parandalojnë fenomenin e erozionit në plazhe duke krijuar gropa të mëdha ku futet rëra. Për këtë arsye, shtretërit *Posidonia* garantojnë funksione të shumta ekologjike dhe mund të kualifikohen si habitate shumë produktive për sa i përket shërbimeve të ekosistemit. Livadhet *Posidonia* ndodhen kryesisht në lindje të Gadishullit, brenda gjirit, ku janë më të mbrojtura nga dallgët. Në Gjirin i Vlorës, ato mund të vuajnë nga presionet antropogjene të shumta të shkaktuara nga zhvillimi i qytetit, ndotja dhe erozioni bregdetar për shkak të ndërtimit dhe depozitimeve të sedimenteve në ujë. Speciet invazive, si p.sh *Halophila stipulacea* kontribuojnë gjithashtu në degradimin e shtretërve *Posidonia* Hartat tregojnë se një pjesë e madhe e këtyre livadheve ndodhen jashtë perimetrit të ZMD-së. Për këtë arsye, do të ishte thelbësore që për ZMD-të të kishte një zonë veprimi më të gjerë sesa kufizimet strikte të zonës së mbrojtur, sidomos nëpërmjet edukimit, për të marrë pjesë edhe në ruajtjen e ekosistemeve të jashtme.

▪ Formacione koralogjene dhe para-koralogjene

Formacionet koralogjene dhe para-koralogjene janë gjithashtu një ekosistem i rëndësishëm i ZMD-së. Ato janë kryesisht të pranishme përgjatë vijës bregdetare të Ishullit të Sazanit dhe veçanërisht në zonën circalitorale, e cila përkon me zonën e pllakës kontinentale që shtrihet nën ekspozimin e herëpashershëm të baticës së zonës. Ajo mund të zhvillohet edhe në zonën infralitorale nëse drita është e mjaftueshme për të lejuar rritjen e algave coralline. Koralogjene dhe para-koralogjene mund të konsiderohen si “fundi i fortë me origjinë biogjenike, që kryesisht prodhohen nga akumulimi i algave gëlqerore të korëzuara” (RAC/SPA, 2003). Ky lloj habitati shfaq biodiversitet të madh dhe përfaqëson mjedise mjaft tërheqëse për zhytjet me maska. Zhytësit mund të admirojnë një shumëllojshmëri vërtet të madhe të llojeve të peshqve, molusqeve, krustaceve dhe sfungjerëve. Formacionet koraligjene dhe para-koraligjene mund të ofrojnë shërbime të rëndësishme për shërbimet kulturore. Ato ofrojnë edhe shërbime ndihmëse duke dhënë përkujdesje dhe vend për lëshimin e vezëve për peshqit, nga të cilat mund të përfitojnë palët e interesuara të peshkimit. Megjithatë, këtyre habitateve i duhet të përballen me lloje të ndryshme presionesh: veprimtari njerëzor si mbipeshkim ose ndotje, specie invazive dhe ndryshime klimatike.

▪ Shkëmbinjtë nënujorë dhe ujërat e hapura

Peizazhi nënujor është gjithashtu i një cilësie të veçantë me shkëmbinj, shpella nënujore me florën e faunën përkatëse, dhe në disa vende, mbetje arkeologjike dhe anije të mbytura. Këto ekosisteme janë thelbësore për zhvillimin e biomasës së peshqve dhe biodiversitetit detar. Habitatet bregdetare shqiptare, për shembull, vizitohen shpesh nga gjitarët e rrallë detarë si foka mesdhetare, për të cilat shpellat e zonës përbëjnë një habitat ideal (Plani i menaxhimit për Parkun Kombëtar Karaburun-Sazan, dhjetor 2014, UNDP/WWF). Delfini i zakonshëm dhe delfini turishkurtër janë vërejtur gjithashtu në këtë zonë

Përmbledhje: Për rrjedhojë, sipërfaqet e paraqitura më poshtë do të konsiderohen:

Zona e ekosistemeve	(ha)
Posidonia	194.03
Formacione koraligjene	276.18
Shkëmbinj nënujorë	498.88
Zona e ujërave të hapura	11601.73

Totali i zonës 12 570.82 ha

7.1.1. KOMUNITETET BENTIKE të sedimenteve të buta

